


PLANI OPERACIONAL

I ZHVILLIMIT VENDOR

BASHKIA BELSH



Empowered lives.
Resilient nations.

Mars, 2016

Titulli: Plani Operacional pës Zhvillimin Lokal të Bashkisë Belsh

Autorësia dhe kontributet:

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Belsh dhe Universiteti POLIS me mbështetjen e Projektit STAR (Support to Territorial and Administrative Reform) dhe Ministrinë të Shtetit për Çështjet Vendore.

Grupi i punës: Drejtues (Eranda Janku, Ledio Allkja, Besnik Aliaj, Sotir Dharmo, Elona Karafili, Dea Buza, Elvan Dajko, Endrit Marku); Të tjerë (Sindi Haxhia, Ledio Capo, Era Buza, Fatbardha Hyseni, Aldo Sulaj, Pegi Shima, Megi Ylli).

Konsulencë: Aurela Bozo (eksperte e jashtme për çështjet gjinore)

Realizimi grafik dhe përmbajtja fotografike : Eranda Janku, Dea Buza



PROFIL, BASHKIA BELSH

Bashkia e Belshit, me një sipërfaqe prej 196.44 km², me qendër qytezën e Belshit kufizohet në veri nga bashkia e Peqinit, në lindje me bashkinë e Cerrikut, në perëndim me bashkinë e Lushnjes dhe në jug me bashkinë Kuçovë. Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Belsh, Grekan, Kajan, Fierzë dhe Rrasë. Pjese e bashkisë Belsh janë edhe 30 fshatrat si Kajan, Dëshiran, Grekan, Fierzë, Dragot, Kosovë, Rrasë etj.

Njësia e Belshit, në bazë të statistikave të vitit 2011 sipas Censurit regjistronte 19,503 banorë dhe densitet prej 99.28 b/km², ndërsa sipas Regjistrimit Civil 32,389 banorë dhe densitet 168.88b/km². Në bashkinë Belsh kemi të bëjmë me një zonë pothuajse të plotë rurale, bazuar në të dhënat e Censurit (100% rurale). Popullsia në bashkinë Belsh është e përbërë nga 69.8% popullsi në moshën 15-65 vjeç, 10.6% popullsi në moshën mbi 65 vjeç dhe 19.6% popullsi në moshën nën 15 vjeç. Ndërkohë përta i përket raportit gjinor, 50.4 % e popullsisë është e përbërë nga gjinia femërore dhe 49.6 % nga gjinia mashkullore. Përta i përket shpërndarjes së popullsisë në territor, 45.06% e popullsisë është e vendosur në njësinë administrative Belsh, 20.11% në Kajan, 16.08% në Grekan, 10.58 % në Fierzë dhe 8.17% në Rrasë.

Bashkia Belsh, ka një pozitë të favorshme gjeografike. Ajo ndodhet në një distancë të afërt (45 min) nga dy qendra të mëdha urbane rajonale si Elbasani dhe Lushnja. Gjithashtu, me përmirësimin e rrugës së Elbasan-Tiranë është shkurtuar dhe distanca kohore nga Tiranë. Njëkohësisht, Belshi gjithashtu ka një distancë të favorshme edhe me qendrën Kulturore të Beratit.

Bazuar në të dhënat e INSTAT sektorët kryesorë të ekonomisë në Bashkinë Belsh janë, bujqësia ku punësohet rreth 66.8% e forcës punëtore, industria me 12.5% dhe shërbimet me 20.7%. Zhvillimi ekonomik në Bashkinë Belsh është në nivele shumë të ulëta.

Në zonë kultivohen kultura të ndryshme bujqësore si grurë, misër, duhan, perime, vreshtari e frutikulture pasi zona e Dumresa ka kushte të favorshme klimatiko-tokësore për kultivimin e tyre. Gjithashtu mbarshtron edhe bagëti të trasha dhe të imta, derra, shpend dhe bletë për të siguruar produkte për nevojat e veta dhe një pjesë për shitje. Bashkia Belsh zotëron edhe një sërë rezervash me lëndë të parë siç janë Rezerva të gurit të Mermerit të Kuq në fshatin Kosovë: Këto rezerva janë të studiuara dhe janë

marrë gurë mermeri në fshatin Kosovë. Aktualisht këto burime nuk shfrytëzohen por mund të kenë potencial për zhvillimin e mëtejshëm. Rezervat e naftës dhe gazit: sot funksionojnë puse në Pekisht, Xibrakë dhe Rrasë ku vazhdohet që të nxirret naftë.

Zona e Belshit si rrjedhojë e peizazhit dhe burimeve të saj ujore (liqeneve) ka një potencial të madh për të zhvilluar turizmin natyror, liqenor dhe agro-turizmin. Por për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme rrugore si dhe mungesës së promovimit nga autoritetet lokale e kombëtare ky lloj aktiviteti ekonomik është ende i pa-zhvilluar dhe i paeksploruar.

Bazuar në profilin, potencialet dhe problematikat e Bashkisë Belsh, është ngritur vizioni i mëposhtëm:

“Belshi një qendër e zhvillimit të bujqësisë dhe turizmit agrikorikulturor e peisazhistik, përmes transformimit të tij në një hapësirë të qëndrueshme për zhvillimin e produkteve bujqësore e blegtorale. Një bashki, e cila bazon zhvillimin në respektin e ambientit natyror e peizazhistik, të vetmit të llojit të tij me 84 liqene”





TABELA E PËRMBAJTJES

6	PËRSE DUHET NJË PLAN OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL
8	PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL DHE PROCESET E PLANIFIKIMIT
10	METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PLANIT OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL
14	DIAGNOZA PËR BASHKINË BELSH
34	PROBLEMATIKAT DHE PRIORITETET
39	PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL NË BASHKINË BELSH
68	PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIM DHE PLANIFIKIMIN E TERRITORIT
70	ANEKS 1 – PROJEKT FISHAT
118	ANEKS 2 – IMAZHE DHE DIAGRAMA PLOTËSUESE

PËRSE DUHET NJË PLAN OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL?

Në kuadër të reformës administrative territoriale, ndarja administrative e Shqipërisë ka kaluar nga një sistem prej 371 njësi të qeverisjes vendore (65 Bashki + 306 Komuna) në një sistem me 61 Bashki. Në këtë kontekst, Bashkitë e reja tashmë mbulojnë territore shumë herë më të mëdha dhe të shumëllojshme si nga pikëpamja topografike, përdorimi dhe shfrytëzimi i territorit, dhe karakteristikat social-ekonomike.

Kjo gjë përbën një sfidë jo vetëm për zbatimin e reformës administrative por edhe për vetë kryetarët e Bashkive të cilët duhet të administrojnë e menaxhojnë një territor shumë më të madh, dinamik e kompleks. Një ndër sfidat më të mëdha të Bashkisë është dhe zhvillimi ekonomik lokal. Në këtë kuadër, Bashkitë duhet të shfrytëzojnë më mirë mundësitë për akses në financim për projekte strategjike të cilat shërbejnë si shtytës për zhvillimin ekonomik-social të Bashkisë.

Për këtë arsye, hartimi i Planit Operacional për Zhvillimin Lokal, vjen në ndihmë të Bashkisë duke ofruar projekte konkrete dhe prioritare, të cilat japin zgjidhje disa prej problematikave më të rëndësishme për një periudhë prej 1-3 vjetësh. Projekt fishat më pas mund të përdoren e realizohen duke u financuar nga buxheti i Bashkisë, ose duke aplikuar për projekte tek Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, donatorë të ndryshëm si USAID, UNDP, SIDA, ADA, ADF, IADSA apo edhe tek ministritë respektive, duke lobuar dhe kërkuar implementimin dhe bashkëpunimin e tyre në implementimin e projekteve.

Duke marrë në konsideratë historikun e buxhetit të Bashkisë Blesh dhe situatën aktuale, fondet janë të limituara. Kryesisht ato shërbejnë për mbulimin e kostove operacionale, pagave dhe investimeve të vogla në territor. Ndërkohë, mungojnë financat për të zhvilluar projekte, të cilat kanë kosto të larta dhe impakte të mëdha në territor. Për këtë arsye një burim i mirë për financim është aplikimi tek Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, në të cilin janë në dispozicion disa grante si:

- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore;
- Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar;
- Granti konkurrues për shëndetësinë;
- Granti konkurrues për objektet kulturore dhe te trashëgimise kulturore;
- Granti konkurrues për ujësjellës-kanalizime;
- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore

dhe thertoresh;

- Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin;
- Granti konkurrues për pyllëzimin.

Gjithsesi për të aksesuar këto fonde, Bashkitë duhet të konkurojnë me njëra tjetrën dhe për këtë arsye është e nevojshme që të kenë projekte të elaboruara. Në këtë kontekst, Planit Operacional për Zhvillimin Lokal i vjen në ndihmë Bashkisë Belsh për të aplikuar për financim dhe projekte tek FZHR. Lista e projekteve të elaboruara në Shtojcën e Projekt Fishave, plotëson një gamë të gjerë të problematikave. Si rrjedhojë, këto projekte mund të përdoren për aplikim në më shumë se një grant konkurrues tek FZHR. Gjithashtu, pro-jektet janë formuluar në një mënyrë të tillë që ndërtojnë mbi njëra-tjetrën, kështu rrisin dhe qëndrueshmërinë dhe impaktin e projekteve në territor dhe në zhvillimin e qëndrueshëm vendor.

Bazuar në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, njësitë e qeverisjes vendore duhet të hartojnë Planet e Përgjithshme Vendore brenda një afati kohor prej 2 vjetësh. Në këtë kontekst, Planit Operacional për Zhvillimin Lokal, shërben si një hap fillestar në proceset e planifikimit por që në asnjë mënyrë nuk zëvendëson Planin e Përgjithshëm Vendor. Në të identifikohen problematikat kryesore dhe parashtrihen disa prioritete zhvillimi të cilat më pas duhet të mbështeten me politika të qarta lokale (strategjia e zhvillimit) si dhe të përkthehen në përdorime të përshtatshme të tokës (plani i përdorimit të tokës) të shoqëruara me rregullat përkatëse të zhvillimit (rregullore e planit të përgjithshëm vendor).

PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL DHE PROÇESET E PLANIFIKIMIT

Bazuar në ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Bashkitë, brenda një afati kohor prej dy vjetësh nga miratimi i ligjit duhet të hartojnë planet e përgjithshme vendore. Ky instrument planifikimi, përtej aspektit të lidhur me ndërtimin dhe lejet ndërtimore, do të shërbejë si dokument udhërrëfyes për zhvillimin e qëndrueshëm territorial të bashkisë.

Në këtë moment, Bashkia Belsh nuk zotëron ndonjë plan të zhvillimit të territorit, dhe njëkohësisht nuk ka filluar proceset e hartimit të planit të përgjithshëm vendor, apo të strategjisë së zhvillimit të territorit. Mungesa e kapaciteteve njerëzore për hartimin e PPV, si dhe mungesa e financave të nevojshme për hartimin e planit me anë të kontraktimit të subjekteve private për këtë gjë është një sfidë shumë e madhe për kryetarin e bashkisë. Si rrjedhojë, hartimi i një plani operacional për zhvillimin lokal shërben bashkisë në tre mënyra:

- E para, ndihmon në evidentimin e problematikave kryesore për territorin e ri dhe të zgjeruar të Bashkisë si dhe në ofrimin e zgjidhjeve konkrete me anë të projekteve strategjike të cilat shërbejnë si shtytës për zhvillimin ekonomik.

- E dyta, ndihmon Bashkinë në prioritazimin e projekteve dhe në hartimin e planit buxhetor për 1-3 vitet e ardhshme. Gjithashtu, orienton dhe ndihmon Bashkinë për përthithjen e fondeve dhe investimeve nga jashtë (donator) si dhe për të konkuruar me anë të projekteve për të aksesuar dhe tërhequr investime nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

- E treta, hartimi i Planit Operacional për Zhvillimin Lokal shërben si iniciativë për fillimin e proceseve të planifikimit të territorit. Në këtë kuadër, grupi i konsulentëve është treguar i kujdesshëm në mënyrë që ky dokument të përdoret më pas me hapat përkatës për hartimin e strategjisë dhe dokumentit të politikave si dhe më tej hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Gjithashtu, në mungesë të instrumentave vendore të planifikimit të territorit, ky dokument i shërben edhe si orientim për iniciativat private apo për politikat e Bashkisë në lidhje me prioritetet për investim.

Në kontekstin e planifikimit të territorit, plani operacional për zhvillimin lokal nuk zëvendëson Planin e Përgjithshëm Vendor, por ndihmon në procesin e hartimit të tij. Në këtë kuadër, grupi i konsulentëve është treguar i

kujdesshëm që të shfrytëzojë procesin e hartimit të Planit Operacional për Zhvillimin Lokal edhe si pjesë e procesit të vizionimit. Bashkia, tashmë ka të identifikuar disa prej problematikave më kryesore si dhe disa prioritetet zhvillimi. Edhe pse vizioni është ende në fillesat e hartimit të tij, përbën një bazë të mirë për të filluar hartimin e strategjisë së zhvillimit të territorit. Për të arritur në formulimin e strategjisë është e nevojshme që bazuar në prioritetet e përcaktuara në këtë dokument të elaborohen më tej politikat përkatëse sektoriale në mbështetje të vizionit dhe qëllimeve të zhvillimit.

Gjithashtu, janë përcaktuar edhe projektet prioritare për periudhën afat shkurtër të cilat mund të shërbejnë si shtytës të zhvillimit lokal. Bashkia, mund të ndërtojë në këto projekte dhe të zhvillojë më tej listën e projekteve strategjike e prioritare për një periudhë afat-gjatë 10 vjeçare. Si rrjedhojë, procesi i hartimit të strategjisë territoriale, mund të fillojë brenda një harku kohor shumë të shkurtër, dhe duke përdorur si bazë planin operacional të zhvillimit lokal.

METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PLANIT OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL

Bazuar në sa më sipër, grupi i konsulencës është munduar që të përshtasë metodologjinë e hartimit të POZHL në mënyrë të tillë që të shërbejë edhe për proceset e mëvonshme të planifikimit. Pra, procesi i hartimit të këtij plani të shërbejë edhe për ngritjen e kapaciteteve në planifikim si dhe si hap fillestar për hartimin e strategjisë së zhvillimit të territorit.

Metodologjia e hartimit të POZHL është bazuar kryesisht në metodën e 'planifikimit strategjik', duke e ndërthurr atë dhe duke i kushtuar një vëmendje të veçantë edhe çështjeve të lidhura me raportin gjinor dhe pabarazitë gjinore. Janë përcaktuar një sërë indikatorësh për të kryer skanimin dhe diagnostikimin e problematikave kryesore të cilat has Bashkia Blesh në aspektin administrativ, social, ekonomik dhe mjedisor. Gjithashtu, për të plotëuar mangësitë në të dhëna në indikatorë janë përdorur intervista gjysëm të strukturuar me grupe të ndryshme si dhe fokus grupe në kuadër të forumeve të zhvilluara në Bashki.

Për sa i përket përfshirjes së çështjeve të pabarazisë dhe raportit gjinor është përdorur metoda e '4 R'. Respektivisht, R1 lidhet kryesisht me indikatorët e përfaqësimit të grave në aspekte të ndryshme të jetës sociale, institucionale, ekonomike e kulturore në Belsh. R2 lidhet me shpërndarjen e burimeve të përbashkëta paratë, koha etj., midis grave dhe burrave. R3 Lidhet me analizimin e kushteve mbi të cilat ngrihen çështjet e pabarazive gjinore. Ndërkohë R4 lidhet me realizimin dhe formulimin e objektivave e masave për ndërhyrjet dhe përmirësimin e situatës. Në këtë kontekst, të dhënat dhe diagnostikimi i problematikave gjinore janë integruar në diagnozën e Bashkisë Belsh sipas tematikave përkatëse. Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave kemi përdorur treguesit gjinore, të cilët kanë orientuar edhe diskutimet në forume, përcaktimin e prioritetëve, përgatitjen e fishave të projekteve dhe përgatitjen e planeve operacionale për zhvillimin lokal, të ndjeshme nga perspektiva gjinore.

Fillimisht, grupi i punës, ka filluar me grumbullimin e informacionit bazë në lidhje me bashkinë Belsh. Kjo gjë është kryer duke mbledhur të dhëna nga burime të tjera të tilla si INSTAT, të dhëna të ministrive apo edhe raporte të mëparshme mbi bashkinë Belsh. Pas krijimit të inventarit të të dhënave dhe njohjes së përgjithshme të Bashkisë, grupi i punës ka zhvilluar vizitën e parë në terren.

Gjatë vizitës së parë, grupi është takuar me përfaqësues

të Bashkisë dhe me kryetarin e bashkisë në mënyrë që të diskutoheshin dhe prioritetet e saj në lidhje me zhvillimin e territorit. Gjithashtu, në këtë kuadër është kontaktuar me bashkinë në lidhje me plotësimin e të dhënave të cilat mungojnë. Për të krijuar një ide më të mirë mbi zhvillimin janë kryer dhe disa intervista gjysëm të strukturuar me banorë dhe aktorë të ndryshëm të bashkisë. Më konkretisht, në bashkinë Belsh, gjatë vizitës së parë u zhvilluan 20 intervista me banorët dhe grupet e interesit. Në këtë kontekst u intervistuan 20 banorë, nga të cilët 3 anëtarë të stafit të Bashkisë (të tre të gjinisë mashkullore), 3 drejtues automjetesh të transportit publik (të gjinisë mashkullore), 4 fermerë (1 mashkull dhe 3 femra), 5 drejtues të biznesit të vogël që operojnë në territorin e Bashkisë (3 meshkuj dhe 2 femra), dhe 5 të rinj (4 meshkuj dhe 1 femër). Siç mund të vihet re, prezenca e gjinisë femërore për Bashkinë e Belshit ishte shumë e vogël. Kjo u vu re qoftë në administratën e Bashkisë, po ashtu edhe në rrugët e zonave të banuara, në drejtimin e bizneseve të ndryshme, dhe aktiviteteve të tjera ekonomike. Një prezencë më e madhe e gjinisë femërore u konstatua në zonat rurale të Bashkisë, ku ishte gjinia femërore ajo që merej me punimin e tokave bujqësore, ndërsa meshkujt mereshin më tepër me blegtori.

Grupi i punës vijoi me hartimin e raportit të parë në lidhje me zonën, përcaktimin e problematikave dhe disa prej prioritetëve. Në këtë kontekst, si metodologji u përdor analiza S.W.O.T. Pas kësaj, u zhvillua forumi vendor. Ky u konceptua nga grupi i punës në kuadër të planifikimit strategjik, përcaktimit të prioritetëve dhe në fund projekteve kryesore. Për këtë gjë, në takimin me forumin vendor u krye prezantimi i të dhënave dhe i analizës S.W.O.T. Në takim morën pjesë 45 veta, nga të cilët 34 meshkuj dhe 11 femra. Pas prezantimit nga grupi i konsulencës, takimi vijoi më tej me diskutime në fokus grupe për përcaktimin e problematikave, prioritarizimin, vizionin dhe në fund projektet e nevojshme.

Duke qënë se Bashkia nuk ka iniciuar procese të tjera të planifikimit strategjik në forum u diskutua edhe për rëndësinë e një plani strategjik të hartuar në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse i cili i përgjigjet nevojave të zhvillimit të Bashkisë. Në vijim, grupi i punës vazhdoi me plotësimin e raportit dhe të dhënave, prioritetëve e projekteve. Kjo gjë është bërë në diskutim të vazhdueshëm me përfaqësuesin e bashkisë. Në fund, u zhvillua dhe forumi i dytë, final, ku u prezantua raporti përfundimtar dhe u morën komentet e rekomandimet e fundit.





DIAGNOZA PËR BASHKINË BELSH



4.1 Të dhëna kryesore për Bashkinë Belsh

Bashkia e Belshit, me një sipërfaqe prej 196.44 km², me qendër qytezën e Belshit kufizohet në veri nga bashkia e Peqinit, në lindje me bashkinë e Cerrikut, në perëndim me bashkinë e Lushnjes dhe në jug me bashkinë Kuçovë. Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Belsh, Grekan, Kajan, Fierzë dhe Rrasë. Pjese e bashkisë Belsh janë edhe 30 fshatrat si Kajan, Dëshiran, Grekan, Fierzë, Dragot, Kosovë, Rrasë etj.

Njësia e Belshit, në bazë të statistikave të vitit 2011 sipas Censurit regjistronte 19,503 banorë dhe densitet prej 99.28 b/km², ndërsa sipas Regjistrimit Civil 32,389 banorë dhe densitet 168.88b/km². Në bashkinë Belsh kemi të bëjmë me një zonë pothuajse të plotë rurale, bazuar në të dhënat e Censurit (100% rurale). Popullsia në bashkinë Belsh është e përbërë nga 69.8% popullsi në moshën 15-65 vjeç, 10.6% popullsi në moshën mbi 65 vjeç dhe 19.6% popullsi në moshën nën 15 vjeç. Ndërkohë përsa i përket raportit gjinor, 50.4 % e popullsisë është e përbërë nga gjinia femërore dhe 49.6 % nga gjinia mashkullore. Por ndonëse në raport gjinia femërore dominon, në jetën sociale dhe aktivitetet e ndryshme ekonomike prezencja e saj është shumë e vogël. Kjo mund të lidhet me një sërë faktorësh, të cilët do të trajtohet edhe më poshtë. Për-

sa i përket shpërndarjes së popullsisë në territor, 45.06% e popullsisë është e vendosur në njësinë administrative Belsh, 20.11% në Kajan, 16.08% në Grekan, 10.58 % në Fierzë dhe 8.17% në Rrasë.

Bashkia Belsh nuk ka nisur procesin e hartimit të planeve vendore. Ka disa projekte, dhe plane pjesore të hartuara në vite, por mungon një dokument i cili do të orientojë zhvillimin territorial dhe të integruar të të gjithë Bashkisë. Nga diskutimet me stafin e Bashkisë përtej mungesës së instrumentave vendore të planifikimit të territorit, një tjetër problematikë është edhe mungesa e kapaciteteve njerëzore në planifikimin e territorit. Bazuar në strukturën organizative të sapo-miruar, Bashkia ka në organikën e saj planifikues, arkitektë dhe inxhinierë, të cilët do të mund të kontribuojnë në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe dokumentave të tjerë për planifikimin dhe menaxhimin e territorit. Mungesa e planeve vendore, përtej aspektit të drejtimit të zhvillimit, ka krijuar probleme edhe në lidhje me dhënien e lejeve të ndërtimit dhe kufizimin e mundësive për zhvillim.

Mungesa ndër vite e kapaciteteve në Bashki, vërehet jo vetëm në kuadër të planifikimit të territorit por edhe në aspekte të tjera të lidhura me çështjet sociale. Mungesa e sociologëve, ekspertëve në çështje të lidhura me zhvillimin e turizmit dhe promovimin e Bashkisë dhe produkteve/potencialeve të saj, në menaxhimin e mjedisit dhe veçanërisht në menaxhimin e mbetjeve, ka krijuar një situatë problematike dhe me mjaft pasoja në ditët e sotme në Bashkinë e Belshit. Një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm, dhe sfidë për Bashkinë është dhe mirë-koordinimi me Njësitë Administrative në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike dhe funksioneve të tyre në këtë aspekt.

Pozita Strategjike

Bashkia Belsh, ka një pozitë të favorshme gjeografike. Ajo ndodhet në një distancë të afërt (45 min) nga dy qendra të mëdha urbane e rajonale, si Elbasani dhe Lushnja. Gjithashtu, me përmirësimin e rrugës së Elbasan-Tiranë është shkurtuar dhe distanca kohore nga Tiranë. Belshi ka një distancë të favorshme edhe me qendrën Kulturore të Beratit. Kjo gjithë ofron një pozitë gjeografike të favorshme për aksesin në tregje më të mëdha si dhe në marrjen e shërbimeve më cilësore. Mungesa e aksesit të mirë, dhe cilësisë së rrugëve e ka lënë Belshin disi të izoluar ndër vite, ndërkohë me përmirësimin e disa prej akseve kryesore rritet ndjeshëm potenciali për të shfrytëzuar këto qendra urbane si tregje kryesore.





Figura 1 (në të majtë): Lidhjet Strategjike të Bashkisë Belsh në Rajon

Analizat dhe Vizionimi në shkallë Rajonale - Bashkia e Belshit në Rajon


1. Orbitalet e Zhvillimit Territorial - Ndërthurja e Infrastrukturrës kryesore rrugore me qendrat e banuara dhe asetet natyrore

- Legjenda
- Zonat Urbane
 - Dytësore
 - Kryesore
 - ⊙ Në studim
 - Orbitalet
 - Rrjeti i zonave të mbrojtura dhe emerald
 - Rrugë kryesore
 - Rrugë të propozuara
 - Rrugë dytësore
 - Rrugë rajonale
 - Hekurudha
 - Ujëra Sipërfaqësore




2. Potencialet Rajonale - Potencialet e ndryshme për zhvillimin e territorit, në përballje me rreziqet kryesore natyrore.

- Legjenda
- Zonat Urbane
 - Dytësore
 - Kryesore
 - ⊙ Në studim
 - Zonë me potencial turizmi malor
 - Turizëm historik kulturor & qytetës
 - Zonë me potencial turistik natyror & ekologjik
 - Zonë me potencial turizmi rural & bujqësor
 - Zonë Naftëmbajtëse
 - Zona e ndotjes
 - Ndarja e zonave
 - Zonë me ndotje të lartë
 - Zona me presion të lartë ndotjeje (Strategji për ruajtje)
 - Rrjeti i zonave të mbrojtura dhe emerald
 - Rrugë kryesore
 - Rrugë dytësore
 - Hekurudha
 - Baseni Shkumbin
 - Baseni Seman
 - Ujëra Sipërfaqësore




3. Karakteri i Zhvillimit- Ndërthyrja e aseteve të ndryshme natyrore me zonat ekonomike, krijimi i poleve të zhvillimit dhe i fashave territoriale. Sistemi kompleks, brenda së cilit Bashkia e Belshit bën pjesë si një qendër e rëndësishme me karakter zhvillimi rural dhe profil tërësisht bujqësor, ka edhe potenciale pejzazhstike me mjaft rëndësi për zhvillimin e turizmit.

- Legjenda**
- Zonat Urbane**
- Multifunkionale
 - Turizëm bregdetar
 - Industri- Turizëm- Bujqësi
 - Turizëm- Bujqësi
 - Bujqësi
 - Shërbime
- Propozim për zona të mbrojtura
 - Zonë Bujqësore
 - Zonë Industriale
 - Zonë Bujqësore- Peisazhstike- Zhvillim rural
 - Rrjeti i zonave të mbrojtura dhe emerald
 - Akse Lidhëse
 - Ujëra Sipërfaqësore



4. Dinamikat e Zhvillimit Rajonal - Performanca e Rajonit

- Legjenda**
- Shpërndarja e e bujqësisë dhe hidrografisë**
- e ulët
 - e lartë
- Rrjeti i zonave emerald dhe të mbrojtura
 - Zona industriale dhe Naftë
 - Ujëra Sipërfaqësore, lumenj dhe liqene
 - Kufinj Administrativë bashkiakë
 - Kufinj Administrativë qarku
 - Zona me PIA më të lartë
 - ▨ Plani Kombëtar_Rajon Ekonomik
 - Rrugë kryesore
 - Rrugë dytësore
 - Rrugë rajonale
 - Rrugë të propozuara
 - Kalimi i TAP
 - Hekurudha



Financat e Bashkisë

Në projekt ligjin për buxhetin për vitin 2016, Bashkisë Belsh i janë parashikuar në total 130,635,000 lekë si transferta nga qeveria qendrore. Në këtë kuadër, 100,625,000 lekë janë parashikuar si transferta të pakushtëzuara në funksion të investimeve.

Pjesa tjetër është e ndarë për funksionet e reja të parashikuara në bazë të ligjit të ri për "Funksionimin dhe Organizimin e Qeverisjes Vendore", ku 20,945,000 lekë janë parashikuar për arsimin parashkollor, 929,000 lekë për arsimin parauniversitar, 613,000 për administrimin e pyjeve dhe 7,523,000 janë parashikuar për rrugët.

Gjithashtu, përsa i përket burimeve të të ardhurave për vitin 2015 dhe aplikimeve tek Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, Bashkia Belsh ka arritur të marrë vetëm një investim në lidhje me rikonstruksionin e shkollës së mesme "Halit Uruçi". Kjo gjë tregon për një nivel të vogël aplikimesh të sukseshme duke qënë se edhe në vitet e mëparshme ka pasur vështirësi të mëdha në aksesimin e fondeve të granteve konkurruese.

4.2 Zhvillimi Ekonomik

Bazuar në të dhënat e INSTAT sektorët kryesorë të ekonomisë në Bashkinë Belsh janë, bujqësia ku punësohet rreth 66.8% e forcës punëtore, industria me 12.5% dhe shërbimet me 20.7%. Zhvillimi ekonomik në Bashkinë Belsh është në nivele shumë të ulëta. Bizneset që operojnë në zonë janë të vogla dhe kryesisht ofrojnë shërbime të tilla si lokale, dyqane, shërbime transporti apo dhe tregëtimin e disa produkteve apo materialeve mbështetëse për bujqësinë. Më poshtë është një përshkrim i shkurtër i sektorëve:




Figura 2: Punësimi në Bashkinë Belsh sipas Sektorëve

Bujqësia dhe Blegtoria

Në zonë kultivohen kultura të ndryshme bujqësore si grurë, misër, duhan, perime, vreshtari e frutikulture pasi zona e Dumresa ka kushte të favorshme klimatiko-tokësore për kultivimin e tyre. Gjithashtu mbarshtron edhe bagëti të trasha dhe të imta, derra, shpend dhe bletë për të siguruar produkte për nevojat e veta dhe një pjesë për shitje.

Bujqësia është zhvilluar kryesisht në zonat përreth liqeneve të Dumresë. Për të rritur prodhimin bujqësor, në shumicën e rasteve tokat bujqësore plehërohen me plehëra kimike me përmbajtje nitratesh dhe fosfatesh, pa asnjë konsideratë për efektet e tyre në mjedis.

Si rrjedhojë e kushteve klimatike dhe atyre të përbërjes së tokës, zona e Dumresë është konkurruese kryesisht në prodhimin e ullinjve, duhanit dhe vreshtarisë. Por, mungon zhvillimi i mëtejshëm i ciklit të produkteve pasi ato janë të limituara vetëm në prodhimin e produkteve bazë duke mos kaluar në përpunimin e mëtejshëm të tyre. Përsa i përket problematikave të lidhura me zhvillimin e bujqësisë, ato mund të ndahen në disa aspekte:

- Infrastruktura mbështetëse (kanalizimet e kullimit dhe të ujitjes) janë të dëmtuara në disa raste dhe nuk lejojnë në shfrytëzimin e plotë të tokave bujqësore. Dëmtimi vjen si rezultat i investimeve të pakëta në mirëmbajtje si dhe si rrjedhojë i ndërtimeve në toka bujqësore. Si rrjedhojë e dëmtimit të sistemit të vaditjes, shumë fermerë kanë përzgjedhur opsionin e puseve i cili është edhe më i kushtueshëm dhe jo eficient;

- Madhësia e fermave është e vogël;

- Aksesimi në tregje më të mëdha i produkteve është i limituar, çka krijon probleme në lidhje me të ardhurat e fermerëve. Kjo gjë vjen edhe si rezultat i mungesës së qendrave të grumbullimit dhe të tregjeve rajonale;

- Mungesa e përdorimit të teknologjisë në prodhim. Kjo gjë sjell në zvogëlimin e aftësisë konkurruese të produkteve bujqësore në raport me zona të tilla si Lushnja, fusha e Myzeqesë;

- Mungesa e investimeve në agro-përpunim dhe ndërlidhja më e mirë e prodhimit me tregun;

- Mungesa e promovimit të produkteve bujqësore;

- Mungon ofrimi i këshillimit për fermerët e rinj si dhe trajnimet për ngritjen e kapaciteteve.




Figura 3: Kulturat Kryesore Bujqësore në Bashkinë Belsh

Peshkimi

Bashkia Belsh ka 85 liqene dhe rezerva të mëdha ujore prej 640 ha ku kultivohet peshku, nga shoqatat e peshkimit, të cilat shtojnë te ardhurat për ekonominë e zonës si dhe rrisin numrin e të punësuarve.

Fauna e liqeneve është e pasur me peshq të llojeve të ndryshme, siç janë krapi, karasi, ballgjëri, amuri, etj. Në disa liqene ka dhe ngjala, të cilat janë specie endogjene. Gjithsesi, peshkimi është ende në fazat fillestare dhe nuk shfrytëzohet në potencialin e plotë të tij, si rrjedhojë edhe e mungesës së aksesit në treg.

Përdorimi i Fondit Pyjor

Zona e Dumrese ka pyje dushku, drize, shkoze, frashër dhe pemë frutore të cilët i japin asaj një bukuri të rrallë. Pas formimit të Kooperativave Bujqësore në vitin 1956-57 kjo zonë iu nënshtua shpyllëzimeve pa kriter, të prerjes masive të pemëve për t'i kthyer ato në tokë buke.

Pas shembjes së sistemit komunist e deri më sot po rigjenerohen mjaft pyje dushku, si dhe po gjelbërohet e gjithë zona për ta kthyer atë siç ka qenë, gjithashtu fermerët kanë mbjellë masivë me vreshta, ullishtë e pemë të ndryshme frutore. Gjithsesi, duke qenë se pyjet menaxhohen nga Bashkitë, është e rëndësishme që ato të përdoren edhe si burim ekonomik duke u shfrytëzuar në mënyrë eficiente dhe pa dëmtuar mjedisin.

Industritë Nxjerrëse të Mineraleve

Industria Nxjerrëse e Mineraleve luan një rol shumë të vogël në ekonominë lokale të Bashkisë Belsh. Vlen të përmendim një sërë rezervash me lënde të parë siç janë:

- Rezerva të gurit të Mermerit të Kuq në fshatin Kosovë: Këto rezerva janë të studiuara dhe janë marrë gurë mermeri në fshatin Kosovë. Aktualisht këto burime nuk shfrytëzohen por mund të kenë potencial për zhvillimin e mëtejshëm.
- Rezervat e naftës dhe gazit: sot funksionojnë puse në Pekisht, Xibrakë dhe Rrasë ku vazhdohet që të nxirret naftë.

Sektori i Shërbimeve

Ky sektor është i përqëndruar kryesisht në qendrën e qytetës së Belshit. Përbëhet kryesisht nga biznese të vogla të fokusuara në lokale, bar, restorante përgjatë vijës së liqenit të Belshit. Gjithashtu, për shkak edhe të emigracionit vërehet që në zonë operojnë edhe disa kompani të cilat merren me transportin e udhëtarëve Shqipëri-Greqi. Përtej qytetës së Belshit, vërehet prezenca e disa bizneseve të vogla edhe në qendrat e ish-komunave, si dhe në brigjet e disa prej liqeneve ku janë vendosur lokale dhe restorante.

Në përgjithësi, mund të thuhet se zhvillimi ekonomik në Belsh është i limituar. Për këtë arsye është e rëndësishme që të shihen dhe potenciale të reja për diversifikimin e ekonomisë si dhe për sofistikimin dhe fuqizimin e sektorëve ekzistues. Në Bashkinë Belsh ka potenciale për zhvillimin e turizmit liqenor dhe natyror, potencial për zhvillimin e agro-përpunimit veçanërisht për ullinj të dhe vreshtat, si dhe për rritjen e aksesit në treg të produkteve bujqësore. Mundësi të tjera ofrohen dhe në prodhimet artizanale apo dhe në përfshirjen më të madhe të grave në ekonomi. Është e nevojshme që të krijohen mundësitë për mbështetjen dhe hapjen e sipërmarrjeve të reja.

Turizmi

Zona e Belshit si rrjedhojë e peizazhit dhe burimeve të saj ujore (liqeneve) ka një potencial të madh për të zhvilluar turizmin natyror, liqenor dhe agro-turizmin. Por për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme rrugore si dhe mungesës së promovimit nga autoritetet lokale e kombëtare ky lloj aktiviteti ekonomik është ende i pazhvilluar dhe i paeksploruar.

LEGJENDA

- ITENERARE PËRGJATË LIQENEVE
- BUJTINA NË SHTËPITË KARAKTERISTIKA TË ZONËS
- EVENTE SOCIAL-KULTURORE
- VEND-KAMPING PRANË LIQENEVE




Figura 4: Potencialët Kryesorë Turistike në Bashkinë Belsh

4.3 Mirëqenia Sociale dhe Ekonomike

Papunësia

Bashkia Belsh, ka një përqindje të lartë të papunësisë, ku në total papunësia sipas të dhënave të instat është 16.6%. Niveli më i lartë i papunësisë raportohet në Belsh qquadër (njësia administrative e Belshit) me 24.4% dhe në njësinë administrative Rrasë me 25.2%. Kjo gjë është e lidhur dhe me faktin se pjesa më e madhe e popullsisë është e punësuar në bujqësi, ndërkohë që sektorët e tjerë janë shumë të dobët nga pikëpamja ekonomike.

Papunësia tek të rinjtë është mjaft problematike me 33.3% (INSTAT). Kjo tregon për mungesën e diversifikimit të ekonomisë si dhe varësinë shumë të madhe në bujqësi. Si rezultat, dëshira e ulët e të rinjve për tu përfshirë në sektorin bujqësor sjell dhe një përqindje kaq të lartë të papunësisë për këtë grup shoqëror.

Gjithashtu, problematike është dhe papunësia tek gjinia femërore me 17%. Sërish, ky rezultat lidhet me varësinë e madhe nga bujqësia dhe me mungesën e mundësive për punësim në sektorët e tjerë ekonomik. Gjithsesi vihet re që kryesisht në zonat më të mëdha bujqësore është popullsia e gjinisë femërore ajo që meret më së shumti me punimin e tokës dhe grumbullimin e produkteve. Kjo lë hapësirë për të menduar për forma të ndryshme të punësimit më të madh të kësaj gjinie në këtë sektor të ekonomisë, duke e diversifikuar më tej atë dhe duke shtuar ciklet e këtij sektori, me procese si përpunimi dhe tregëtimi, të cilët mund të përbëjnë një burim shumë të mirë punësimi, sidomos për të rinjtë dhe gratë.




Figura 5: Niveli i Papunësisë në Bashkinë Belsh

Në të dyja rastet, niveli i lartë i papunësisë tek të rinjtë dhe femrat krijojnë jo vetëm probleme ekonomike por edhe probleme të mëdha sociale. Të rinjtë drejtohen kryesisht në emigrim në gjetje të mundësive për punësim ose duke ndenjur pa punë mund të rrezikojnë angazhimin në aktivitete jo produktive dhe të dëmshme nga pikëpamja

sociale si lojrat e fatit apo dhe konsumi i alkoolit. Një situatë analoge parashtrahet edhe tek femrat të cilat në shumicën e rasteve janë të detyruara të qëndrojnë në shtëpi duke u izoluar nga jeta sociale dhe ekonomike. Në Bashkinë Belsh, mungojnë zyrat e punës dhe për më shumë mungojnë edhe zyrat e trajnimit apo të këshillimit për karrierën të cilat mund të ndihmojnë pozitivisht në ngritjen e kapaciteteve lokale.

Ndihma Ekonomike

Përsa i përket ndihmës ekonomike të plotë dhe të pjesshme në Bashkinë Belsh janë të regjistruara si përfitues të ndihmës ekonomike të plotë 129 familje, nga të cilat 2 familje janë pjesë e komunitetit Egjiptian. Si pjesë e ndihmës ekonomike të plotë përfitohet një shumë prej 3,299 lek/muaj. Ndërsa përfitues të ndihmës ekonomike të pjesshme janë 85 familje, të cilat përfitojnë shumën 2,565 lekë/muaj.

PAK (Personat me Aftësi të Kufizuar)

Përsa i përket Personave me Aftësi të Kufizuar në Bashkinë Belsh, 264 rezultojnë me aftësi të kufizuar, ndërsa invalidë pune janë 199 ku nga këto 92 janë femra, duke çuar totalin e personave të paaftë për punë në 463 të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike. Përsa i përket popullsisë me aftësi të kufizuara, të dhëna të marra nga Unicef, figuron 1.1% e fëmijëve nga 0-18 vjeç, dhe nuk ka ndonjë ndihmë të veçantë për kushtet që atyre i nevojiten.

Arsimimi

Bazuar në të dhënat e INSTAT, 12.8% e popullsisë janë me arsim të lartë, 20.7% janë me arsim të mesëm dhe 66.8% e popullsisë janë me arsim 8/9 vjeçar. Këto statistika tregojnë për një nivel të ulët arsimimi si dhe për një forcë punëtore e cila me kualifikime jo shumë të larta. Mungesa e arsimit profesional si dhe mos vazhdimi i studimeve të mëtejshme kanë çuar në një nivel të lartë të papunësisë tek të rinjtë. Nga intervistat e kryera në terren, një ndër arsyes kryesore të mos vazhdimit të shkollimit është e lidhur dhe me prindërit, të cilët i orientojnë fëmijët e tyre drejt punës në bujqësi, por pa i dhënë atyre kualifikimet e nevojshme.

Sipas një raporti informativ për sistemin e grumbullimit të të dhënave të përgatitur në kontekstin e projektit të përbashkët të ILO-s dhe UNDP-së "Trajtimi i përfshirjes sociale përmes arsimit dhe formimit profesional SIVET",

u siguruan të dhëna përse i përket numrit të nxënësve të arsimuar dhe niveli të arsimit. Nxënës me një arsim bazë, nga totali që është 1,320, 634 janë vajza dhe 0 nxënës nga komuniteti Rom. Nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm të përgjithshëm në total janë 493, ku nga këto 339 janë vajza, dhe nxënës nga komuniteti Rom.

Aktivite Social-Kulturore

Aktivitetet sociale në Bashkië Belsh janë të limituara. Kjo gjë vërehet edhe nga mungesa e institucioneve, të cilat ofrojnë këto shërbime. Në Belsh ekziston një Qendër Kulturore, por është në gjendje kritike. Ndërtesa është në kushte shumë të dobëta, ka një mungesë të theksuar të infrastrukturës mbështetëse dhe aktivitetet që zhvillohen janë shumë të pakta. Njëkohësisht edhe në Dëshiran ekziston një Qendër Kulturore, por ndërtesa është tërësisht e rrënuar dhe nuk kryen asnjë lloj aktiviteti.

Gjithashtu, aktivitetet për të rinjtë janë të pakëta. Mungojnë terrene sportive dhe Qendra Kulturore/Multifunktionale. Kjo gjë shkakton probleme shoqërore, të cilat lidhen me jetesën sedimentale që shumë të rinj kryejnë, apo dhe me aftësi profesionale e shoqërore, të cilat nuk zhvillohen më tej. Rezultati i mos vazhdimit të shkollimit të mëtejshëm mund vijë edhe si rrjedhojë e mungesë së qendrave të edukimit apo trajnimit pas shkollor.

Përse i përket aktiviteteve kulturore ato lidhen kryesisht me vallet dhe muzikën folklorike. Por edhe në këtë kuadër interesimi i të rinjve, nga intervistat në terren është gjithnjë në rënie. Kjo gjë vjen edhe si rrjedhojë e mungesës së faciliteteve dhe shërbimeve të specializuara në këtë fushë.

Edhe përse i përket çështjeve gjinore vërehet e njëjta situatë. Mentaliteti i zonës si dhe mungesa e mundësi-ve për të zhvilluar aktivitete social-kulturore, të cilat përfshijnë dhe gjininë femër janë të pakta në zonë. Nga intervistat në terren, dallohet qartë mungesa e shërbimeve dhe aktiviteteve mbi këtë gjë. Po ashtu, mungesa e shoqërisë civile, OJQ të cilat operojnë në zonë, dhe roli që ato mund të kenë në zhvillimin social është një çështje, e cila duhet parë më me vëmendje.

Një ndër aktivitetet tradicionale në zonë është edhe "Dita e Pazarit" që zhvillohet një herë në javë. Përtej shkëmbimit ekonomik që ndodh në këtë ditë, i gjithë qyteti përfiton në gjallëri dhe shkëmbim social. Gjithsesi, problema-

tikë është vendi në të cilën zhvillohet aktiviteti i pazarit. Ai kryhet në një nga rrugët e qytetit, ku mungojnë stendat dhe kushtet minimale higjienike.

Integrimi i të rinjve dhe roli i femrës në shoqëri

Ndonëse me strukturën e re të administratës së Bashkisë shtohet një specialist, i cili do të meret me çështjet e barazisë gjinore, deri në këtë moment pranë Bashkisë Belsh nuk ka pasur të tillë specialitet. Kjo ka kushtëzuar edhe situatën kritike në vend, përpos edhe mungesës së prezencës së shoqatave të ndryshme, të cilat trajtojnë mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave, apo nevojat e grupeve të ndryshme në nevojë dhe ato minoritare.

Me shtimin e këtij specialisti pranë stafit të Bashkisë pritet të ketë më tepër vëmendje përse i përket trajtimit dhe nevojave të këtyre grupeve. Rritja e numrit të shoqatave me këtë karakter është gjithashtu një synim i Bashkisë Belsh, dhe kohët e fundit edhe në këtë Bashki është diskutuar gjatë për realizimin e këtij objektiv. Vetë Bashkia kërkon të luajë një rol të madh duke u bërë pjesë aktive në këtë fushë, dhe kjo çështje është diskutuar dhe marrë në konsideratë edhe gjatë miratimit të buxhetit për vitin 2016.

Një formë e mirë për të integruar të rinjtë dhe sidomos gjininë femërore, është edhe diversifikimi i mundësive për punësim. Por nëse i referohemi të dhënave të mësipërme për punësimin, vihet re një mungesë diversifikimi e këtij sektori, si dhe integrim shumë i vogël i gjinisë femërore dhe të rinjve në strukturat e ndryshme të punësimit dhe aktivitetet që organizohen. Numrin më të lartë të grave dhe vajzave të punësuar në administratën shtetërore, e kanë sektorë si edukimi dhe shëndetësia. Sektorë të tjerë si shërbimet apo industria, krijojnë më pak mundësi për përfshirjen e kësaj kategorie, duke qenë se shpesh kërkojnë më tepër angazhim kohor, apo edhe forcë fizike. Në sektorin e bujqësisë vihet re një aktivizim disi më i madh i gjinisë femërore, dhe ky fakt mund të jetë premtues nëse mendojmë për mënyra të ndryshme diversifikimi për këtë sektor të ekonomisë, për të rritur më tej numrin e të rinjve dhe grave, të punësuar në këtë aktivitet ekonomik.

Me një total prej 33.3% të rinjtë në Bashkinë Belsh përfaqësojnë një përqindje të madhe përse i përket papunësisë. Duke mos gjetur hapësirat e nevojshme për t'u integruar, shumica e tyre detyrohet të emigrojë jashtë vendit, ose të bëhet pjesë e lëvizjeve migratore. Në këtë formë

ndodh popullimi i atyre krahinave apo zonave qendrore që duket të ofrojnë më shumë mundësi, duke lënë pas vende si Belshi, apo bashki të tjera të ngjashme, që sot janë duke vuajtur tkurrjen e popullsisë dhe stanjacionin ekonomik. Këto dukuri impaktojnë zhvillimin jo vetëm të këtyre bashkive përkatëse, por të të gjithë vendit, duke krijuar pabarazi të thella në nivel rajonal dhe lokal e duke lënë në harresë vende me potenciale shumë të mëdha, të cilat shpesh nuk arrijnë të përceptohen dhe vihen në përdorim nga autoritetet lokale.

Në këto kushte duke përdorur potencialet natyrore, sociale dhe ekonomike që Bashkia e Belshit ka, është e nevojshme të vendosen balanca të reja, në mënyrë që këto potenciale së pari të njihen, dhe më pas të vihen në përdorim në dobi të vetë Bashkisë dhe popullsisë së saj.

Veçanërisht për të rinjtë dhe gjininë femërore ka shumë mënyra dhe forma për të rritur integrimin e tyre në shoqëri, duke promovuar në të njëjtën kohë diversifikimin e ekonomisë dhe të aktiviteteve të ndryshme, të cilat momentalisht mungojnë. Ndërhyrje të tilla mund të konsistojnë në:

- Zhvillimin e Bujqësisë dhe Blegtorisë si degë të ekonomisë, ku veçanërisht femrat mund të kenë një rol shumë të madh. Kur themi zhvillimin e tyre nënkuptojmë jo vetëm vënien në përdorim të tokave bujqësore dhe mbarështrimin e dheneve, por edhe diversifikimin dhe zgjerimin e ciklit të produkteve. Këto produkte dhe nënprodukte mund të futen më pas në tregun lokal e rajonal, duke rritur të ardhurat që ky sektor mund të sjellë, si dhe duke integruar në proces një grup të popullsisë që momentalisht nuk është vlerësuar sa dhe siç duhet;

- Zhvillimin e Turizmit si një tjetër degë e rëndësishme që mund të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të Bashkisë Belsh. Sidomos në këtë Bashki, turizmi mund të shihet gjithashtu si një fushë e përshtatshme për të rritur pjesëmarrjen dhe integrimin e të rinjve dhe femrave. Krijimi i itinerareve turistike përgjatë liqeneve të Bashkisë, ngritja e bujtinave pritëse, qendrave agrikulturore, guidave dhe tureve turistike, qendrave të turizmit lokal etj., mund të jenë forma zhvillimi, ku ky grup mund të luajë një rol të rëndësishëm në organizimin dhe manaxhimin e tyre;

- Rritjen e aktiviteteve Social-Kulturore në institucione të tilla si Qendrat Kulturore, apo njësi të tjera me karakter social që mund të funksionojnë brenda Bashkisë. Këto njësi duhet të shihen jo vetëm si faktorë promovues të kulturës dhe historisë së pasur që Belshi ka, por mbi të gjitha si vatra që sigurojnë hapësirë dhe mundësi për gjithëpërfshirjen e të gjitha grupmoshave;

- Përkrahjen e punimeve artizanale, kryesisht bazuar në produktet bazë bujqësore dhe blogtorale. Të rinjtë dhe femrat sidomos mund të shihen si motorët kryesorë për të aktivizuar këtë sektor dhe promovuar produktet vendase në të gjithë zonën;

- Dizenjimin e hapësirave publike të përshtatshme për çdo lloj aktiviteti, dhe për të gjitha grupmoshat. Kjo jo vetëm mund të rrisë pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen e këtyre individëve, por mund të ndikojë gjithashtu në rritjen e sigurisë dhe ndjenjën e përkatësisë, që janë dhe disa nga faktorët kryesorë në përmirësimin e mirëqenies sociale.



4.4 Burimet Natyrore dhe Qëndrueshmëria e Mjedisit

Sipërfaqja e Bashkisë së re është 196.44 km². Mbulesa e tokës në Bashkinë Belsh përbëhet nga katër komponentë kryesorë. Komponenti më karakteristik dhe identitet formues i ekosistemit natyror janë burimet ujore. Me një sipërfaqe prej 14.2 km² përfaqësohet rrjeti hidrik ku kontribues kryesor janë 85 liqenet karstike.

Burimet Ujore

Krahina e Dumresë numëron 84 liqene. Liqenet e Belshit, me një bukuri të rrallë si, ai i Seferanit, Merhoxës, Cestijes, Degës, me një florë të pasur si, zambaku i bardhë, zambaku i verdhë etj, kanë tërhequr vëmendjen e vizitorëve vendas dhe të huaj. Sipërfaqja e përgjithshme e liqeneve është rreth 640 ha, ndërsa aftësia ujëmbajtëse 26 milion m³ ujë.

Ata kanë madhësi dhe thellësi të ndryshme. Liqenet e pafund të Dumresë, kodrat e buta e të valëzuara mund të jenë një shpresë reale për zhvillimin e zonës, si dhe favorizojnë zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Furnizimi me ujë i liqeneve të Dumresë bëhet kryesisht nga rreshjet. Përbërja gjeologjike e formacioneve të pellgut ujëmbledhës është kryesisht gëlqerorë, gipse, dolomite.

Në liqenet e Belshit burimet kryesore të ndotësve janë rrjedhjet nga tokat bujqësore dhe derdhja e mbeturinave ujore të patrajtuara në to. Të gjithë liqenet e marrë në studim kanë premisa për eutrofikim.

Gjithashtu, amoniaku përbën problem për sistemet biologjike në këto liqene. Monitorimi i vazhdueshëm i parametrave kimikë të këtyre liqeneve, duke krijuar edhe lidhje me sistemet biologjike, krijon një bazë të dhënash për hartimin e strategjive të përmirësimit dhe restaurimit të tyre.

Këtu mund të përmendet, trajtimi i mbeturinave ujore urbane, zhvillimi i teknikave bujqësore me impakt sa më të vogël në ekosistemet ujore, hartimi i programeve për rritjen e ndërgjegjes publike, etj. Dy ndër liqenet me problematikën më të madhe mjedisore janë ato të Liqenit të "Gjolit të Gjatë" dhe Liqeni i Belshit i cili ndodhet në qytezën e Belshit.

- **Liqeni 'Gjoli i Gjatë'** ndodhet në hyrje të qytezës së Belshit. Është një liqen me sipërfaqe më të vogël në krahasim me liqenet e tjerë të marrë në studim. Ai ndodhet rreth 135.6 m mbi nivelin e detit. Në matjet e kryera, ky

liqen ka thellësi të vogël, prej disa centimetrash. Megjithatë, thellësia e tij ndryshon në varësi të reshjeve. Ky liqen është i rrethuar nga shtëpi banimi, të cilat shkarkojnë mbeturinat e tyre ujore në të, dhe nga toka bujqësore, rrjedhjet e të cilave të pasura me nutrientë, përfundojnë përsëri në liqen.

- **Liqeni i Belshit** ndodhet në anën Lindore dhe Jugore të qytezës së Belshit. Ndodhet në lartësi rreth 148.6 m mbi nivelin e detit. Thellësia e tij në matjet e kryera është rreth 3 m. Megjithatë ai mund të arrijë një thellësi maksimale prej 15 m. Sipërfaqja e tij është rreth 30 ha. Liqeni i Belshit rrethohet nga zona të banuara, të cilat derdhin mbeturinat e tyre ujore në liqen pa asnjë trajtim paraprak. Shfrytëzohet për peshkim dhe ujitje.

Bujqësia

Komponenti i dytë i rëndësishëm i mbulesës së tokës janë sipërfaqet e tokave bujqësore të cilat krijojnë një peizazh të veçantë në zonën e Belshit dhe të Dumresë. Nga vetë përbërja e relievit kryesisht kodrinoro-fushor si dhe klima tipike mesdhetare me diellzim të lartë bën që tokat bujqësore të kenë një zë të rëndësishëm në përdorimin e tokës dhe në ekonominë e njësisë vendore, potencial ky i cili mund të ndikojë në ekzistencën e agroturizmit të munguar në këtë vend. Kryesisht mbulesa e tokës është e përqëndruar në tre kultura kryesore si duhani, vreshtaria dhe ullinjë.

Në vitet e fundit, shtimi i përdorimit të pesticideve në bujqësi, por edhe ndërtimet e pakontrolluara në tokë bujqësore kanë pasur impakte negative. Ndotja e tokës bujqësore me nitrate dhe përdorimi i ujërave të ndotur të liqeneve për vaditje ka krijuar një rreth vicioz të qarkullimit të ndotjes i cili është një kërcënim i madh për cilësinë e produkteve dhe shëndetin.

Pyjet

Kodrat e Dumresë qenë në përgjithësi të mbuluara me pyje dushku, por pjesa më e madhe e pyjeve u prenë gjatë kohës së diktaturës për të krijuar hapësirë për toka buke. Për shkak të terrenit kodrinor, cilësia e tokës dhe aksesit në ujitje është i variueshëm, gjë që ka sjellë edhe parcelizim tepër të lartë të tokës që iu shpërnda familjeve fermere në vitin 1991. Shumë nga kodrat e Belshit kanë filluar të mbillen me plantacione me ullinj dhe me vreshta. Janë kryesisht emigrantët nga Belshi, të cilët janë

kthyer dhe po investojnë në zonë.

Gjithashtu në kodrat e Belshit, ekzistojnë pyje të mbuluara kryesisht me pemë ahu, lisi, dushku ndër të tjera. Fondi, pyjor në Bashkinë Belsh ka një potencial të madh për të kontribuar në ekonomi por që për momentin është i pashfrytëzuar. Gjatë vizitave në terren nuk vërehen problematika të shpyllëzimit pa kriter, kryesisht ato përdoren për ngrohje nga banorët e zonës. Gjithsesi është e nevojshme, që të ketë disa plane menaxhimi për pyjet të cilat do të garantojnë mbrojtjen e faunës dhe florës por njëkohësisht të mundësojnë aktivizimin e tyre në ekonomi për qëllime të lidhura me turizmin apo dhe përpunimin e drurit.

Mjedisi i Ndërtuar

Bazuar në të dhënat e INSTAT rreth 38.1% e banesave në Belsh janë ndërtuar përpara vitit 1991. Kjo gjë tregon për impaktin që urbanizimi ka pasur në këtë zonë thellësisht bujqësore dhe rurale në dy dekadat e fundit. Më konkretisht, 19.8% e ndërtesave janë zhvilluar në periudhën 1991-2001 dhe rreth 20.11% janë ndërtuar në periudhën 2001-2011. Pjesa tjetër e ndërtimeve të cilat nuk i është identifikuar viti i ndërtimit është rreth 30%. Këto statistika tregojnë për një zhvillim të rëndësishëm në ndërtime, të cilat kanë qënë kryesisht në zona bujqësore si përreth qytezës së Belshit.

Një numër i konsiderueshëm i ndërtesave të pas-vitit 1991 janë ndërtuar gjithashtu në mënyrë informale, të pashoqëruara me infrastrukturën bazë apo me shtimin e kapacitetit të infrastrukturës ekzistuese. Kjo gjë ka rritur presionin dhe njëkohësisht ka sjellë dhe ndotje të konsiderueshme mjedisore, veçanërisht si rrjedhojë e derdhjes së ujërave të zeza në liqene. Kryesisht ndërtesat në zonën e Belshit janë të tipit shtëpi një-familjare çka lidhet me karakterin rural të zonës. Në këtë kontekst, janë identifikuar tre sfida kryesore për Bashkinë Belsh në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore të zonave të ndërtuara:

- Kanalizimet e ujërave të zeza

Bazuar në të dhënat e mësipërme një numër i konsiderueshëm banesash janë ndërtuar në mënyrë informale dhe të paplanifikuara. Mospërputhja e kërkesës me ofertën në këtë rast ka çuar në një dështim të sistemit të kanalizimeve. Si rrjedhojë, shumë ndërtesa të cilat ndodhen përfaqëson liqenin të Belshit (përreth qytezës), apo në

fshatra të tjera të cilat janë pranë liqeneve, derdhen ujërat e tyre urbane në liqene. Kjo gjë ka një impakt tejet negativ jo vetëm në ekosistemin e liqeneve, duke dëmtuar dhe speciet endemike, pjesë e të cilave janë në zhdukje, por edhe në tokën bujqësore. Si rrjedhojë është në rrezik edhe kontaminimi i produkteve bujqësore dhe vetë shëndeti i banorëve dhe konsumatorëve direkt të këtyre produkteve.

- Menaxhimi i Mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve ofrohet kryesisht për qytezën e Belshit e cila është dhe gjeneruesja më e madhe e mbetjeve të ngurta. Ndërkohë në vendbanimet e tjera kryesisht gjenerohen mbetje organike. Bashkia Belsh ka një “vend-depozitim” i cili është rreth 1.5 km nga qendra e qytetit në veri të tij. Ky venddepozitim është jo sanitar dhe jashtë standarteve optimale të funksionimit të një ‘vend-depozitimi’ normal. Fakti që ai gjendet vetëm 1km larg burimit ujor më të afërt shton rrezikshmërinë e tij në kontaminimin e burimeve ujore.

Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Zhvillimit Urban në Belsh gjenerohen rreth 6 ton mbetje në ditë. Edhe pse një sasi e vogël në krahasim me qytete të tjera sërish përbën një rrezik ndotjeje për zonën. Një sasi e konsiderueshme e këtyre mbetjeve, bazuar edhe nga diskutimet në terren, janë mbetje organike të cilat nuk ndahen por depozitohen të gjitha në të njëjtin vend. Gjithashtu mungojnë masat për riciklim apo kompostim të këtyre mbetjeve. Në lidhje me kompostimin, ai është shumë sporadik dhe ndodh në bazë individuale në disa fermerë.

- Cilësia e Ndërtimit

Ndërtimet në Bashkinë Belsh mund të klasifikohen në tre tipe. Ndërtime të para viteve 90-të të tipit shtëpi, kryesisht në fshatra, ndërtime të para viteve 90-të të tipit apartamente të përqëndruara kryesisht në qendrën e Belshit, dhe në disa fshatra si për shembull Dragoti, të zhvilluara në funksion të punëtorëve të kooperativave. Ndërkohë, tipi i tretë përfaqësohet nga ndërtime në formë shtëpi, të zhvilluara pas viteve 90-të të cilat janë të shpërhapura në të gjithë territorin.

Nga pikëpamja mjedisore, mungesa e infrastrukturës i shndërron këto ndërtime si rrjedhojë e mungesës së infrastrukturës, në burime pikësore të ndotjes. Aspekt tjetër i ndërtimit të paplanifikuar dhe mungesës së investimeve



lidhjet dhe me humbjen e karakterit të qytetës së Belshit të cilës i mungon një qendër identifikuese e qytetit.

Një aspekt tjetër tejet i rëndësishëm është i lidhur me efikasitetin energjitik. Veçanërisht ndërtesat e zhvilluara përpara viteve 90-të janë në kushte të dobëta, me

fasada të degraduara dhe me probleme të tilla si ndotja dhe mungesa e efikasitetit. Gjithashtu, edhe pse zona një mbulesë të mirë të orëve me diell, përdorimi i energjisë së decentralizuar diellore në banesa apo edhe në bujqësi është i vogël. Ai vërehet kryesisht në formën e paneleve diellore në disa banesa të reja.



4.5 Shërbimet dhe Infrastruktura

Shërbimet e ofruara në Bashki:

- Edukimi

Në Bashkinë e Belshit gjenden 17 shkolla 9-vjecare dhe 3 shkolla të mesme të cilat janë pjesë e DAR Elbasan (Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan). Gjithashtu ndodhen dhe 19 kopshte/çerdhe të administruara nga Bashkia Belsh. Sipas të dhënave kemi 6190 nxënës që frekuentojnë shkollën 9-vjeçare dhe 1075 nxënës që ndjekin shkollën e mesme.

Shkollat janë të shpërndara në të gjithë territorin e bashkisë dhe të përqendruara në qytetin e Belshit dhe në qendrat e ish-komunave Shalës, Grekan, Kajan, Fierzë, Rrasë. Gjendja ekzistuese e disa shkollave nuk është shumë e përshtatshme për zhvillimin e mësimin dhe nevojitet ndërrhyrja për përmirësimin e kushteve mësimore.

- Shëndetësia

Shëndetësia në Bashkinë e Belshit është përbërë nga qendrat shëndetësore dhe ambulancat. Bashkia e Belshit ka 4 qendra shëndetësore dhe 15 ambulanca. Qendrat shëndetësore janë në Belsh-Qendër, Kajan, Kosovë, Grekan ndërsa ambulancat janë të shpërndara dhe në fshatra të tjerë duke sjellë një mbulim të mirë të territorit të Bashkisë për ofrimin e ndihmës mjekësore. Gjithsesi, në disa qendra është e nevojshme përmirësimi i kushteve të ndërtesave dhe aparaturave, si dhe rritja e kapaciteteve njerëzore si doktor dhe infermier.

- Furnizimi me ujë

Ujësjellësi i Dumrese dhe i Belshit është krijuar në vitin 1987. Ky shërbim shtrihet në të gjithë zonën e Dumresë. Uji për zonën sigurohet nga tre burime:

- Në lumin Devoll. 60-100 l/sek merret me ngritje mekanike dhe shpërndahet në fshatrat e Bashkisë Belsh, njësisë administrative Rrasë, Grekan, Fierzë dhe Kajan;
- Në lumin Shkumbin 15 l/sek dhe furnizon me ujë fshatrat e Komunes Shalës;
- Në Cërragë, 12 l/sek dhe furnizon fshatrat Cërragë, Kosovë dhe Dëshiran.

Rrjeti i tubacioneve kryesore ka një gjatësi prej 7 km. Gjithsesi ai është i amortizuar, dhe nuk mbulon të gjithë territorin e Bashkisë. Furnizimi me ujë, nga të dhënat e mbledhura në terren, është problematik dhe në disa ras-

te ka ndërprerje të vazhdueshme të ujit dhe furnizimi me uji kryhet vetëm në orare të caktuara të ditës. Bashkia Belsh ka një projekt për rinovimin dhe përmirësimin e rrjetit ujqor hartuar me një vlerë prej 20 milion dollarë por që është ende i pa implementuar.

- Infrastruktura Rrugore

Infrastruktura rrugore brenda territorit të Bashkisë Belsh, si rezultat i investimeve në rrugët rurale është përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit. Në këtë kontekst mbetet problematik aksi Belsh-Kajan-Dragot. Ky aks ka filluar të ndërtohet në kuadër të projektit të "Boshtit Qëndror", i cili parashikonte të kthente këtë rrugë në një aks të rëndësishëm kombëtar. Investimet janë ndërprerë dhe rruga tashmë ka mbetur në një situatë të vështirë, ku si rrjedhojë edhe e mosmirëmbajtjes dhe vazhdimin të punimeve, investimi i kryer më parë është duke u prishur.

Ndërkohë, lidhja e Belshit me qendrat kryesore rajonale si Belshi dhe Lushnja ka qënë problematike. Veçanërisht lidhja Belsh-Cërrik-Elbasan ka qënë tejet e amortizuar. Nga vëzhgimet në terren dallohet që ka filluar projekti për rregullimin e rrugës Elbasan-Cërrik si dhe aksi tjetër i rëndësishëm Papër-Cërrik-Gramsh. Për këtë arsye tashmë është e nevojshme që të merren edhe masat për rregullimin e aksit Belsh-Cërrik i cili do të rriste ndjeshëm aksesueshmërinë e Bashkisë. Një tjetër aks i rëndësishëm i zhvilluar rishtazi është edhe Belsh-Fierzë-Fier Shegan i cili ka përmirësuar ndjeshëm aksesin drejt një prej qendrave më të rëndësishme bujqësore në Shqipëri si Lushnja. Përsa i përket rrugëve "urbane", ose më saktë brenda qendrave të banuara ato janë në gjendje të dobët. Shumica e tyre janë ose të paasfaltuara ose në degraduara. Kjo gjë ndikon ndjeshëm në cilësinë e jetesës së banorëve.

Në fund, mungon një sistem i mirëorganizuar transporti ndërurban. Ky organizohet në mënyrë private, ku lëvizjet janë sipas rastit dhe kërkesës. Fakti që mungon një pikë ndalimi e mirëpërcaktuar dhe me infrastrukturë të përshtatshme bën që shpesh, në Belsh të krijohet edhe trafik i panevojshëm.

Figura 6: Harta e Institucioneve Arsimore
Figura 7: Harta e Institucioneve Shëndetësore
Figura 8: Harta e Furnizimit me Ujë të Pijshëm
Figura 9: Harta e Kanalizimeve të Ujërave të Zeza
Figura 10: Harta e Furnizimit me Energji Elektrike
Figura 11: Harta e Infrastrukturës Kryesore Rrugore (të bashkangjitura në Aneks-in 2)

4.6 Konkluzione

Pas diagnostikimit të disa prej çështjeve më kryesore të Bashkisë Belsh, grupi i punës ka zhvilluar analizën S.W.O.T dhe më pas ka gjeneruar 'pemën e problemeve' për bashkinë. Në analizën S.W.O.T janë përfshirë dhe elementët e

barazisë dhe çështjeve gjinore në mënyrë që të ketë një përfaqje sa më të integruar të të gjithë komponentëve. Të dyja këto aspekte janë përdorur për të ofruar propozime konkrete dhe projekte për zhvillimin e mëtejshëm.

SWOT| Bashkia Belsh

1 STRENGTHS (PIKAT E FORTA)	2 WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA)	3 OPPORTUNITIES (MUNDËSITË)	4 THREATS (RREZIQET)
<ul style="list-style-type: none">-- Reforma territoriale, Bashki më e madhe;- Vazhdimësi institucionale dhe eksperiencia ndër vite;- Diversiteti i elementeve natyror;- Vendodhja e përshtatshme gjeografike (pllaja e Dumresë).	<ul style="list-style-type: none">-- Mungesa e kapaciteteve njerëzore në stafin e Bashkisë;- Mungesa e dokumentave të planifikimit strategjik, të përdorimit të tokës;- Financat e bashkisë janë të ulëta;- Marketim jo i mirë i Bashkisë në nivel kombëtar;- Mungesa e pronave publike nga ana e Bashkisë.	<ul style="list-style-type: none">-- Bashkëpunim i dyanshëm me qeverinë qendrore për zhvillimin e zonës;- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve;- Përpilimi i planeve të përgjithshme dhe planeve të veprimit për një zhvillim më efikas të bashkisë në të ardhmen;- Planifikim i Integruar dhe Gjithëpërfshirës.	<ul style="list-style-type: none">-- Bashkëpunimi midis Bashkisë dhe Njësive Administrative;- Financat e Bashkisë;- Kriza Ekonomike;- Konkurrueshmëria e Lartë e zonave me potenciale të ngjashme.

SWOT| Infrastruktura

1 STRENGTHS (PIKAT E FORTA)	2 WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA)	3 OPPORTUNITIES (MUNDËSITË)	4 THREATS (RREZIQET)
<ul style="list-style-type: none">-- Ndërtimi i rrugës që lidh Belshin me Lushnjën dhe Elbasanin;- Ekzistencave e rrugëve lidhëse brenda qendrave administrative të bashkisë dhe fshtrave përkatës;	<ul style="list-style-type: none">-- Mungesa e organizimit të transportit ndër-urban;- Një pjesë e madhe e fshatrave nuk kanë lidhje direkte me qendrat kryesore administrative dhe infrastruktura rrugore është e dobët;	<ul style="list-style-type: none">-- Ndërlidhja e shpejtë me Belshin;- Ofrimi i infrastrukturës për ujë dhe pijshëm;- Infrastruktura inovative për menaxhimin e ujërave të zeza;	<ul style="list-style-type: none">-- Mungesa e financave të përshtatshme;- Mos përfshirja e komunitetit në proceset e planifikimit;- Humbja e besimit në qeverisje dhe në planifikim.

- Afërsia me Aeroportin e Tiranës dhe Portin e Durrësit;
- Afërsia dhe aksesueshmëria e mirë me Elbasanin dhe Lushnjën.

- Furnizimi me ujë të pijshëm bëhet vetëm për një pjesë të popullsisë;
- Pjesa më e madhe e rrugëve brenda qytetit të Belshit janë të pashtruara;
- Mungesa e kanalizimeve për ujërat e zeza;
- Rrjeti i KUZ i qytetit të Belshit derdhet në liqen;
- Përfshirja e komunitetit dhe grupeve të interesit në qeverisje është e vogël.

- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve;
- Planifikim i Integruar dhe Gjithëpërfshirës.- Afërsia e njësive ndërmjet tyre që sjell lehtësi në bashkpunim;

SWOT| Bujqësia

1 STRENGTHS (PIKAT E FORTA)

- Boniteti i lartë i tokave bujqësore;
- Toka bujqësore në përgjithësi është ruajtur nga zhvillimi urban;
- Bujqësia është sektori kryesor ekonomik në zonë dhe fokusi kryesor i Bashkisë për gjenerimin e të ardhurave;
- Diversifikimi i produkteve bujqësore
- Duhani, Ullishtet dhe Vreshtaria janë të zhvilluara;
- Afërsia me qendra të rëndësishme urbane dhe bujqësore si Elbasani, Lushnja dhe Tirana.

2 WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA)

- Mungesa e një pike grumbullimi për produktet bujqësore;
- Mungesa e infrastrukturave të nevojshme për mirëfunksionimin e sektorit bujqësor;
- Sistemi vaditës është i amortizuar dhe pjesë-pjesë nuk ekziston;
- Mungesa e PPP për bujqësinë;
- Sipërfaqe të mëdha tokash të papunuara;
- Interesi i të rinjve për specializim në bujqësi është në rënie;
- Mekanizim dhe teknologji e vogël në përdorim për bujqësinë;
- Mungesa e qendrave të specializuara për ngritjen e kapaciteteve & trajnimin në bujqësi;
- Mungesa e tregjeve lokale dhe rajonale.

3 OPPORTUNITIE (MUNDËSITË)

- Ekzistenca e fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare për subvencionimin e bujqësisë;
- Mundësi për krijimin e brandeve të ndryshme për duhanin, verën, rakinë dhe ullirin duke qenë se zona është e pasur me vreshta dhe ullishte;
- Agroturizmi si një mundësi për të shtuar vlerën e produkteve bujqësore.

4 THREATS (RREZIQET)

- Disbalanca në shfrytëzimin e burimeve natyrore ujore për prodhimin e kulturave bujqësore;
- Ndotja e burimeve ujore;
- Migrimi i popullsisë;
- Konkurenca nga tregje të tjera të rëndësishme .

SWOT| Gjendja social-kulturore

1 STRENGTHS (PIKAT E FORTA)	2 WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA)	3 OPPORTUNITIES (MUNDËSITË)	4 THREATS (RREZIQET)
<ul style="list-style-type: none">-- Shpërndarja e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në të gjithë territorin e Bashkisë;- Ansambli popullor i cili përfaqëson Belshin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;- Shkolla profesionale në Elbasan dhe në Lushnjë.	<ul style="list-style-type: none">-- Mungesa e interesit në arsimim;- Mungesa e aktiviteteve kulturore për të gjitha grupmoshat, gjinitë dhe grupet e interesit;- Mungesa e strukturave të cilat ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;- Gjendja e shkollave në territorin e bashkisë nuk është në kushtet e përshtatshme'- Gjendje jo e mirë e objekteve ekzistuese kulturore.	<ul style="list-style-type: none">-- Ekzistenca e moshave të reja dhe integrimi i tyre në aktivitete social-kulturore;- Përfshirja e gjinisë femërore në prodhimin e produkteve bujqësore dhe artizanale;- Ngritja e kapaciteteve tek të rinjtë me anë të edukimit dhe Qendrave Multi-funksionale.	<ul style="list-style-type: none">-- Largimi i të rinjve për shkolim në qytete të tjera brenda ose jashtë Shqipërisë;- Segregimi Social i grupeve të ndryshme shoqërore;- Rënia e nivelit të frekuentimit të shkollave.

SWOT| Turizmi

1 STRENGTHS (PIKAT E FORTA)	2 WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA)	3 OPPORTUNITIES (MUNDËSITË)	4 THREATS (RREZIQET)
<ul style="list-style-type: none">-- Prania e 85 liqeneve me origjinë karstike;- Larmishmëria e elementeve natyrore dhe peizazhistike;- Prania e specieve të rralla të peshqve në liqene;- Prania e disa liqeneve që janë shpallur si monumente natyrore: Seferani, Merhoje etj.;- Bujqësia dhe Peizazhi Bujqësor.	<ul style="list-style-type: none">-- Marketim i dobët i produktit turistik vendas;- Infrastruktura e dobët për të arritur në destinacion;- Mungesa e guidave turistike dhe sinjalistikës përkatëse;- Mungesa e bujtinave për të promovuar vlerat e zonës;- Mungesa e promovimit të pikave potenciale turistike;- Mos ekzistenca e info-point;- Personel jo i kualifikuar vendas për ofrimin e guidave turistike.	<ul style="list-style-type: none">-- Mundësia për të zhvilluar agro-turizmin në zonë;- Ekzistenca e projekteve dhe fondeve për zhvillimin e agro-turizmit;- Mundësi për të rinjtë dhe te rejat e zonës të punësohen në sektorin e turizmit duke ofruar guida turistike.	<ul style="list-style-type: none">-- Hedhja dhe shumimi në liqene i specieve të ndryshme rrezikon të zhduk speciet e rralla;- Ndotja e liqeneve;- Dëmtimi i peizazhit;- Konkurenca nga vende të tjera.

SWOT| Barazia Gjinore dhe Integrimi Social

1 STRENGTHS (PIKAT E FORTA)

-
- Moshë mesatare e popullsisë tregon për popullsi të aftë për punë;
- Numër i konsiderueshëm të rinjsh dhe popullsisë së gjinisë femërore;
- Hapësirë për të integruar këto dy grupe të popullsisë;
- Bashkia ka nisur të mendojë për programe dhe politika për të përmirësuar situatën.

2 WEAKNESSES (PIKAT E DOBËTA)

-
- Mungesë e zyrës përkatëse në Bashki, që adreson çështjet gjinore;
- Mungesë programesh dhe fondesh për këto çështje;
- Numër në zvogëlim i organizatave që operojnë në Bashki;
- Infrastruktura e dobët lidhëse ndërmjet zonave nxit uljen e pjesëmarrjes së këtij grupi në jetën sociale;
- Si rrjedhojë, segregim (të rinjve dhe femrave);
- Mungesa e diversifikimit të ekonomisë, krijon pak hapësirë për integrimin e femrave dhe të rinjve;
- Rol relativisht i dobët i Qendrave Kulturore, në aktivizimin e të rinjve dhe organizimin e aktiviteteve (mungesë programesh e aktiviteteve të vazhdueshme);
- Mungesa e aktiviteteve dhe hapësirave të dedikuara dhe gjithëpërfshirëse për ndërveprim social.

3 OPPORTUNITIE (MUNDËSITË)

-
- Angazhim më i madh i Bashkisë, duke krijuar strukturat përkatëse në administratë dhe duke hartuar programe të posaçme për rritjen e integritit të të rinjve dhe gjinisë femërore;
- Rivitalizimi i Qendrës Kulturore me qëllim gjithëpërfshirjen sociale me fokus të veçantë tek problemet gjinore dhe të rinjtë;
- Aplikimi i politikave mbështetëse për diversifikimin e ekonomisë e punësimit, duke rritur përfshirjen e grave e të rinjve;
- Gjithëpërfshirja përmes aktiviteteve artistike e sportive më të shpeshta dhe të strukturuar;
- Përdorimi i Qendrave Kulturore, si qendra komunitare, me fokus gjithëpërfshirjen sociale, sidomos të femrave dhe të të rinjve.

4 THREATS (RREZIQET)

-
- Rritje e segregimit të grupeve të popullsisë (përgjithësisht të rinjtë dhe femrat);
- Largim i popullsisë;
- Theksimi i ndarjes gjinore mos përfshirja e femrave në aktivitete e punësim.





PROBLEMATIKAT DHE PRIORITETET



5.1 Problematikat dhe Prioritetet

Bazuar në analizat e mësipërme, si dhe në ‘pemën e problematikave’ (bashkangjitur në Aneks-in 2), grupi i punës ka identifikuar problematikat më të rëndësishme, me të cilat përballlet Bashkia e re e Belshit, duke rekomanduarmë tej prioritetet si më poshtë:

PROBLEMATIKA



ORGANIZIMI INSTITUCIONAL-ADMINISTRATIV

- Nevojë për ngritje kapacitetesh në planifikim dhe menaxhim territori;
- Mungesa e planifikimit në nivel vendor dhe ndërlidhja me financat dhe buxhetin;
- Financat Lokale të pamjaftueshme;
- Mungesë e shërbimeve cilësore dhe të shpejta për publikun (lejet e ndërtimit, zhvillimi i turizmit dhe mbështetje për bujqësinë).

PRIORITETE

Ngritja e Kapaciteteve vendore në menaxhimin, planifikimin dhe zhvillimin e territorit

- Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor;
- Ngritja e Kapaciteteve Lokale në planifikim dhe menaxhim territori;
- Ngritja e Zyrës së Punës, si dhe Zyrës me një Ndalesë për Zhvillimin e Territorit.



ZHVILLIMI EKONOMIK

- Mungesa e tregjeve bujqësore;
- Mungesa e diversifikimit në ekonomi;
- Papunësi e lartë tek të rinjtë;
- Integrim i vogël i femrave në ekonomi.

Diversifikimi i Ekonomisë dhe Zhvillimi Ekonomik:

- Ngritja e kapaciteteve tek të rinjtë dhe mbështetja e sipërmarrjeve të reja lokale;
- Rritja e vizibilitetit, aksesueshmërisë në tregje dhe promovimi i produkteve lokale;
- Diversifikim dhe specializim i ekonomisë me fokus më të madh në turizmin liqenor, agro-turizëm, agro-përpunim.



MJEDISI

- Ndotja e Liqeneve;
- Menaxhimi i dobët i mbetjeve urbane;
- Kanalizimet e ujërave të zeza të cilat derdhen në liqene.

Rehabilitimi i mjedisit:

- Ndalim i derdhjes së ujërave të ndotura në liqene;
- Mbrojtja e mjedisit dhe peizazhit;
- Menaxhim i mbetetjeve.



INFRASTRUKTURA

- Dëmtimi i infrastrukturës vaditëse për bujqësinë;
- Nevojë për ndërhyrje përmirësuese në ofrimin e shërbimi me ujë të pijshëm;
- Infrastruktura rrugore lokale e dobë.

Përmirësimi i Infrastrukturës Rrugore :

- Përmirësim i aksesit në zonë;
- Rregullim i infrastrukturës lokale;
- Transporti ndërurban.

Asfaltimi i segmenteve kryesore rrugore me efekte në përmirësimin e ekonomisë, duke siguruar një akses më të mirë dhe më të shpejtë për banorët me qendrën e Belshit dhe midis njësive të tjera, si dhe për të siguruar mundësi për tregëtimin e produkteve bujqësore që kultivohen në këto zona.

Gjithashtu kjo do të sigurojë dhe një akses më të mirë dhe më të shpejtë për vizitorët në të gjitha pikat më të rëndësishme turistike që ndodhen në zonë.



SOCIAL-KULTURORE

- Mungesa e aktiviteteve social-kulturore, me karakter gjithë-vjetor (aktivizim më i madh i Qendrave Kulturore, si qendra multifunktionale me përgjegjësi sociale për rivitalizimin dhe aktivizimin e moshave të ndryshme, sidomos të rinjtë dhe gjininë femërore);
- Mungesa e aktiviteteve për të rinjtë;
- Mungesa e përfshirjes së të gjinisë femërore në aktivitete sociale;
- Mangësi në qendrat e trajnimit dhe të ngritjes së kapaciteteve lokale;
- Mungesë e prezencës dhe aktivizimit të organizatave që meren me çështjet e barazisë gjinore, përkrahjes së të rinjve dhe mbështetjes së femrave në shoqëri.

Shfytëzimi i objekteve që Bashkia ka në zotërim për zhvillimin e aktiviteteve sociale për grupmosha të ndryshme, duke filluar nga parashkollorët e deri tek grupmosha e tretë:

- Mbështetja e të rinjve;
- Ngritja e strukturave në mbështetjen e grave;
- Aktivitetet Social-Kulturore në zonë;

Shërbimet Publike:

- Përmirësimi i sistemit të furnizimit me Ujë të pishëm;
- Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza;
- Ngritja e nje sistemi funksional për grumbullimin e të dhënave mbi territorin dhe popullsinë e Bashkisë Belsh;
- Përmirësimi i kushteve fizike të institucioneve arsimore;
- Përmirësimi i kushteve fizike të institucioneve shëndetësore.



5.2 Vizioni për Bashkinë Belsh

“Belshi një qendër e zhvillimit të bujqësisë dhe turizmit agrikorikultor e peizazhistik, përmes transformimit në një hapësirë të qëndrueshme për zhvillimin e produkteve bujqësore e blegtorale. Një bashki, e cila bazon zhvillimin në respektin e ambientit natyror e peizazhistik, të vetmit të llojit të tij me 84 liqene”




Figura 12: Harta e Vizionit për Bashkinë Belsh



PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIMIN LOKAL NË BASHKINË BELSH

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
<p><i>Ngritja e Kapaciteteve vendore në menaxhimin, planifikimin dhe zhvillimin e territorit</i></p>	<p>1. Trajnimi i stafit në planifikimin dhe zhvillimin e territorit</p>	<p>Bashkia Belsh ka në strukturën e saj një staf prej 114 personash. Me ndryshimet e reformës territoriale, Bashkisë i janë shtuar kompetencat si dhe tashmë duhet të menaxhojë një territor shumë më kompleks si nga pikëpamja hapësinore ashtu dhe nga diversiteti i çështjeve sociale, ekonomike e kulturore.</p> <p>Gjithashtu, koordinimi i Njësive Administrative është një sfidë më vete, me të cilën përballet Bashkia. Në mënyrë që të garantohet një zhvillim sa më i qëndrueshëm i Bashkisë si dhe të ofrohet një shërbim sa më cilësor ndaj qytetarit është tejet e nevojshme që të ngrihen kapacitetet e punonjësve të qeverisë vendore. Në këtë aspekt janë identifikuar dy fusha si më prioritaret:</p> <p>a. Planifikim dhe Menaxhim Territori;</p> <p>b. Trajnimi i çështjeve sociale.</p>	<p>500,000- 700,000 Lekë</p> <p>12 muaj</p>
	<p>2. Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor</p>	<p>Bashkia Belsh nuk ka një Plan të Përgjithshëm Vendor. Bazuar në ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të gjitha njësitë e</p>	<p>15,000,000 Lekë</p> <p>12 muaj</p>

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Belsh	50% Bashkia MZHU, AKPT, MMSR, PLGP USAID, UNDP, OSCE	a. Lidhje e marrëveshjeve me MZHU, AKPT, MMSR si dhe organizata të tjera, të cilat ofrojnë ngritje kapaciteti në fushat e sipërpërmendura; b. Ndjekje e trajnimeve të specializuara të organizuara nga Qeveria, Organizata, Programe Ndërkombëtare etj.; c. Ndjekje të kurseve të specializuara; d. Vizita në Bashki të tjera për njohjen me praktika më të mira.	<ul style="list-style-type: none"> - Ngritja e kapaciteteve vendore në administratën publike; - Ngritja e kapaciteteve vendore në planifikimin e territorit; - Ngritja e kapaciteteve vendore në menaxhimin e territorit; - Ngritja e kapaciteteve vendore për menaxhimin e çështjeve sociale; - Ngritja e mekanizmit të Referimit për dhunën në familje <p>Ngritja e kapaciteteve do të aplikohet në të paktën 50 punonjës të qeverisjes vendore në sektorët kyç si planifikim i territorit, projekte strategjike, ndihma sociale etj. Kjo gjë do të aplikohet jo vetëm për Njësine Administrative Belsh por edhe për stafin e Njësive të tjera administrative;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngritja e kapaciteteve të administratës vendore ndikon drejtpërdrejtë në ofrimin e një shërbimi cilësor ndaj qyteterëve dhe palëve të tjera të interesuara. Gjithashtu, krijon një ambient të përgatitur për t'u përballur me sfidat territoriale të reformës administrative.
Bashkia Belsh	10-15 % Bashkia MZHU/ AKPT/ USAID PLGP/ OSCE/ UNDP	<ul style="list-style-type: none"> - Nisma për hartimin e PPV (2-3 Javë);- Formimi i grupit të punës (2-3 javë); - Formimi i Forumit për Bashkërendimin dhe Këshillimin (1-2 javë); - Hartimi i Analizës së thelluar 	Përfitues të hartimit të këtij projekti janë banorët e Bashkisë-Belsh, fermerët, investitorët dhe vetë Bashkia. Projekti bazohet në përcaktimet e ligjit 107/2014 "Përplanifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" dhe akteve nënlig-

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		<p>qeverisjes vendore duhet të hartojnë planet e tyre vendore brenda një periudhe 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e ligjit. Projekti përbëhet nga disa faza. Fillimisht është faza përgatitoreku duhen grumbulluar të gjithë materialet e nevojshme për hartimin e PPV, gjithashtu në këtë fazë duhet hartuar Nisma për Hartimin e Planit si dhe krijuar Forumi i Këshillimit dhe i Bashkërendimit.</p> <p>Faza e dytë lidhet me vlerësimin dhe analizën e thelluar të territorit. Në këtë fazë analizohen dhe evidentohen të gjitha aspektet e zhvillimit të territorit si ato urbanistike, mjedisore, zhvillimi ekonomik dhe social. Gjithashtu e rëndësishme është edhe ndërthurja e komponentëve të çështjeve gjinore.</p> <p>Faza e tretë është strategjia e territorit dhe vizioni strategjik. Nëpërmjet Planit Operacional të Zhvillimit Lokal është krijuar një inventar i mirë i situatës ekzistuese si dhe janë përcaktuar disa prioritete kryesore. Për këtë arsye dy fazat e para duhet të zhvillohen brenda një afati kohor të shkurtër.</p> <p>Faza e 4 lidhet me hartimin e Planit të Përdorimit të Tokës si dhe</p>	

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
		<p>të territorit (3-4 muaj);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Territorit (2 muaj); - Hartimi i Planit të Përdorimit të Tokës dhe Rregullores së Planifikimit dhe Zhvillimit (3-4 muaj); - Dëgjesa Publike (të paktën 2 dëgjesa); - Hartimi i Planit të Investimeve Kapitale dhe Vlerësimit Satrategjik Mjedisor (1 muaj); - Dërgim për miratim në KKT (1 muaj). 	<p>jore në zbatim të tij. Projekti më pas do të garantojë bazën për zhvillimin e territorit të Bashkisë Belsh.</p>

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		me rregulloret në zbatim të tij.	
	3. Ngritja e Zyrës me një ndalesë për “Zhvillimin e Territorit” (One Stop Shop)	Bazuar në parashikimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dheZhvillimin e Territorit” dhe në VKM “Për Zhvillimin e Territorit”, në të cilën thuhet se “Njësitë e Qeverisjes vendore duhet të marrin masa për ngritjen e zyrave me një ndalesë për zhvillimin e territorit”. Deri më tani, Bashkia Belsh nuk ka një strukturë të tillë dhe aplikimet për lejet e ndërtimit menaxhohen nga zyra e planifikimit të territorit. Projekti konsiston në hapjen e një zyre me një ndalesë për “zhvillimin e territorit”. Kjo zyrë do të kryejë shërbimet e nevojshme për kërkuesit e lejeve të ndërtimit. Disa nga shërbimet e zyrës lidhen me dhënien e informacionit mbi procedurat e lejeve të ndërtimit, koordinim institucional për thjeshtëzimin e procedurave të lejeve.	500,000 Lekë 4 muaj
<i>Diversifikim i Ekonomisë dhe Zhvillim Ekonomik</i>	4. Pastrimi dhe Rikonstrukcioni i Kanaleve të Ujitjes dhe kullimit në Bashkinë Belsh	Bashkia e Belshit është thellësisht e varur nga sektori i bujqësisë,ku rreth 70% e punësimit është në këtë sektor. Si rrjedhojë e zhvillimeve	26,000,000 Lekë 20 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Belsh	70-100% Bashkia	<ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimin e vendit (zyrës), ku do të vendoset shërbimi me një ndalesë për Zhvillimin e Territorit; - Përcaktimi dhe plotësimi i stafit të përfshirë në këtë zyrë; - Trajnimi i stafit dhe njohja me dispozitat ligjore dhe procedurale bazuar në Ligjin 107/2014 “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; - Plotësimi me bazën materiale si kompjutera, printera, internet, orendi zyre etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - Përsheptim të afateve për pajisjen me leje ndërtimi; - Zvogëlim të burokracive administrative; - Zvogëlim të kostove ekonomike për aplikuesit për leje ndërtimi; - Tërheqjen e investitorëve si rrjedhojë e përmirësimit të cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit.
Bashkia Belsh, MBZHRAU	5 % Bashkia Bashkëfinancim me FZHR- Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin, MBZHRAU	Projekti është i ndarë në 3 faza sipas vendeve përkatëse të përcaktuara: <ul style="list-style-type: none"> - Marinzë - Cërragë - Plevicë 	Përfitues të këtij projekti fillimisht do të jenë banorët dhe fermerët e zonave Marinzë, Cërragë dhe Plevicë; Rezultatet e pritshme janë: <ul style="list-style-type: none"> - Rritja e produktivitetit; - Ulja e kostove të fermerëve;

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		<p>informale dhe mungesës së investimeve në pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve të kullimit dhe ujitjes shumë prej tyre janë të bllokuar dhe jofunksional. Për këtë arsye, shpesh fermerët janë të detyruar që të rrisin kostot e prodhimit, si rrjedhojë e nevojës për të gjetur mënyra alternative dhe individuale për ujitjen e tokave. Ky problem është i rëndësishëm në dy aspekte ku, së pari kostot e larta të ujitjes për fermerët dhe së dyti si rrezik i ndotjes së shaktuar në toka bujqësore. Projekti konsiston në rigjenerimin e kanaleve të ujitjes dhe kullimit në zonat Marinzë, Cërragë dhe Plevicë. Rigjenerimi konsiston në pastrimin dhe rikonstruksionin (aty ku është e nevojshme) e kanaleve të ujitjes dhe kullimit.</p>	
	<p>5. Ngritja e Qendrës së Grumbullimit të Produkteve Bujqësore/Blegtorale</p>	<p>Zona e Belshit ka një produktivitet të madh në duhan, vreshtaridhe ullinj. Gjithashtu në vitet e fundit janë zhvilluar dhe punishtet e ullirit, prodhimit të verës dhe rakisë. Aksesueshmëria në tregje më të mëdha për prodhuesit është shumë e vogël. Mungesa e një pike grumbullimi</p>	<p>15,000,000 Lekë 12 muaj</p>

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
		Fillimisht do të kryhet një vlerësim i detajuar i situatës së këtyre.	<ul style="list-style-type: none"> - Reduktim i ndotjes së ujërave si rrjedhojë e pastrimit të kanaleve; - Përmirësim i situatës së kanaleve të ujitjes dhe kullimit; - Pastrim i kanaleve; - Rikonstrukcion i kanaleve ekzistues; - Rigjenerim i sistemit të kanaleve të ujitjes dhe kullimit.
Bashkia Belsh MBZHRAU	1 % Bashkia FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit për ngritjen e Qendrës së Grumbullimit; - Përgatitja e projektit teknik; - Aplikim për Fonde (Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave). 	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i vendeve të reja të punës me ngritjen e Qendrës së Grumbullimit (të paktën 20-30 vende pune); - Mbështetja e fermerëve (trajnime, konsultime, kontroll sigurie të produkteve etj).

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		<p>për të gjitha produktet e prodhuara në Bashki, bën që prodhuesit të kenë kosto të larta transportit lidhur me sasinë e ulët të produktit që ata tregtojnë individualisht, ndaj fitimi është shumë i ulët, për të mos thënë inekzistent. Qendra e grumbullimit do të mbështesë kryesisht produktet e duhanit, vreshtarisë dhe ullishteve, të cilat janë dhe prodhimet kryesore të zonës.</p>	
	6. Krijimi i Thertores	<p>Projekti konsiston në ngritjen e një qendre thertoreje në DeponNr. 2, Shkozë, Lagjia Pepa. Aktualisht thertoret janë në kushte të papërshtatshme dhe pa standartet e kërkuara sipas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Inspektoriatit Ushqimor, duke sjellë rrezik për konsumatorët.</p> <p>Është e nevojshme ngritja e një thertoreje, e cila duhet të plotësojë standartet e kërkuara, duke ofruar shërbim cilësor ndaj popullsisë së Belshit.</p> <p>Thertorja do të mbështesë blegtorët vendas në mbarështimin e kafshëve të imta, në veçanti gjelit të detit, qingjave/deleve dhe keçave/dhive.</p>	9,000,000 Lekë 12 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Belsh	1 % Bashkia FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit për thertoren; - Përgatitja e projektit teknik; - Aplikim për Fonde (Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave); - Implementim dhe ndërtim i thertoresh; - Promovim i thertoresh, krijim marrëdhëniesh me biznese dhe fermerë. 	Përfitues të hartimit të këtij projekti janë fermerët e zonës dhërritja e produktivitetit. Aksesueshmëria në tregje më të mëdha për prodhuesit. Bashkia e Belshit është thellësisht e varur nga sektori i bujqësisë, ku rreth 70% e punësimit është në këtë sektor. Thertorja do të sigurojë gjithashtu kontrollin dhe sigurinë e prodhimeve bujqësore.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
	7. Promovimi dhe Brandimi i Bashkisë Belsh	<p>Zona e Belshit ka një produktivitet të madh në duhan, vreshtaridhe ullinj. Gjithashtu ajo zotëron potenciale të mëdha natyrore e peizazhistike. Promovimi i këtyre asetëve dhe rritja e vizitorëve do të ndihmojë në qëndrueshmërinë e projektit.</p> <p>Gjithashtu do të ketë dhe një tarifë simbolike nga bizneset, të cilat do të përfitojnë reklamim/promovim. Projekti synon rritjen e vizibilitetit të Bashkisë Belsh dhe promovimit të potencialeve. Ai përbëhet nga disa hallka të lidhura me njëra tjetrën, si krijimi i një “marke” të dedikuar për Belshin. Projekti do të shoqërohet edhe me krijimin e një faqeje interneti për komunikimin me publikun, vizitorët dhe promovimin e potencialeve e aktiviteteve që zhvillohen në Belsh.</p>	750,000 Lekë 6 muaj
	8. Krijimi i Itinerarit Turistik/ Natyror të Liqeneve të Belshit	Në Bashkinë Belsh janë gjithsej 84 liqene karsitike. Një element qëka ulur atraktivitetin përreth këtyre liqeneve, është mungesa e aksesueshërisë së drejtpërdrejtë, mungesa e shërbi-meve mbështetëse të turizmit, si dhe mungesa e kujdesit ndaj ndotjes së	7,500,000 Lekë 16 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Belsh	100 % Bashkia	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i një logoje për brandimin e Bashkisë Belsh; - Krijimi i databazës për potencialet natyrore, kul-turore, historike e peizazhistike; - Krijimi i një liste aktive-tesh promovuese si panairë, festivale, konferenca, seminare; - Krijimi i faqes elektronike që ofron informacionin për promovimin e Bashkisë; - Inventarizim i Potencialeve Natyrore; - Inventarizim i Aseteve Historiko-Kulturore; - Inventarizim i Fermave; - Inventarizim i Bujtinave dhe Vendeve të Ako-modimit; - Kalendari i aktiviteteve si panairë dhe festa lokale; - Ndërtimi i faqes së internetit; - Hartimi i broshurave; - Faqe në rrjetet sociale si facebook, twitter etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - Përfitues janë të gjithë banorët e Bashkisë; - Rritja e numrit të vizito-rëve; - Rritja e vizibilitetit të potencialeve dhe tërheqja e investitorëve ; - Promovimi i Bashkisë në nivel kombëtar e ndërkombëtar; - Punësim dhe integrim më i madh i të rinjve dhe grave. - Krijimi i një brand (markë) për Bashkinë Belsh; - Promovimi i produkteve bujqësore dhe potencialeve për agro-turizëm; - Promovimi i potencialve natyrore; - Krijimi i një kalendari aktiviteteve me fokus promovimin e potencialeve të Belshit; - Rritjen e numrit të të punësuarve në shërbim të fushave të ndryshme të brandimit, sidomos integrimin e të rinjve dhe grave.
Bashkia Belsh,	FZHR- fondi i infrastrukturës vendore USAID, GIZ, ADA, ADF, SIDA etj.	<ul style="list-style-type: none"> - Dizajnimin e hartës së itinerarit; - Vendosjen e tabelave dhe sinjalistikës përkatëse; - Zhvillimi i itinerarit me shërbime plotësuese; - Identifikimi i bujtinave dhe shtëpive pritëse; - Zhvillimi i dy zonave të kampingut; - Aplikim për fonde pranë 	<ul style="list-style-type: none"> Përfitues të hartimit të këtij projekti janë bano-rët e zonës, bizneset e vogla, dhe shërbimet turistike. - Aksesueshmëri më e mirë me anë të itinerareve natyrore të liqeneve; - Rritja e turizmit natyror dhe liqenor në zone; - Rritje e punësimit, sidomos tek të rinjtë dhe gratë.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		<p>tyre. Projekti synon që të ndërlidhë liqenet me anë të një itinerari me impakt sa më të ulët në mjedis, kryesisht me rrugëkalimi këmbësore dhe për pedalim. Ndër elementët që duhen për krijimin e itinerarit janë ofrimi i shërbi-meve shtesë, siç janë përcaktimi i disa qendrave kamping-u me rulo ose çadër, përcaktimi i disa vendeve me interes turistik, dhe përcaktimi i rrugëve natyrore të kalimit.</p>	
	<p>9. Ngritja e Bujtinave Pritëse, shërbyese të Agro-Turizmit</p>	<p>Projekti konsiston në identifikimin e hapësirave, të cilat do të mund të kthehen në bujtina dhe ambiente në shërbim të agro-turizmit. Bujtinat do të përdorin kryesisht prodhimtarinë bio-vendase, e cila është një aset për t'u vlerësuar. Gjithashtu projekti do jetë pjesë e paketave turistike, të cilat do të krijojnë lehtësira dhe mundësi të mira për zhvillimin e turizmit në zonë. Projekti do të kontribuojë në përmirësimin dhe rritjen e nivelit ekonomik të zonave rurale. Bujtinat do shërbejnë si model për hapjen e bizneseve të ngjashme në pjesë të ndryshme të territorit të Bashkisë Belsh.</p>	<p>5,000,000 Lekë 12 muaj</p>

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
		<p>FZHR (Ministria e Zhvillim-it Urban).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faza 1: Krijimi i infra-strukturës rrugore për këmbësorë dhe biçikleta dhe ven-dosja e sinjalistikës për-katëse; - Faza 2: Identifikimi i bujtinave dhe zonave kryesore bujqësore/blegatorale, me rëndësi për agro-turizmin; - Faza 3: Ngritja e zonave të kampimit. 	
Bashkia Belsh,	<p>5% (Bashkia) 5% (Familjet, strukturat e të cilave do të përdoren) Donatorë të mundshëm: USAID, GIZ, ADA, ADF, SIDA, AKT, ATA</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhjen e 4 familjeve/fermerëve; - Dakortësimin me 4 familjet/fermerët; - Gjetjen e donatorëve të tjerë të mundshëm (përmendur më sipër disa prej tyre); - Incentivimin e familjeve/fermerëve për të krijuar bujtinat; - Ngritja e kushteve të përshtatshme pranë bujtinave, sigurimi i cilësisë dhe standardeve; - Përfshirja e bujtinave në itineraret turistike, si dhe gruidat e Bashkisë së Belshit; - Promovimi i bujtinave;- Ngritja e një sistemi për menaxhimin e bujtinave, që do të bëjë kontrollin e cilësisë dhe kualifikimin e objekteve/fermave që do të duan të shndërrohen në bujtina në të ardhme. 	<p>Përfitues të hartimit të këtij projekti janë fil-limisht banorët e 4 familjeve, me të cilat do të nisë projekti, Bashkia, si dhe të gjithë turistët që do të akomodohen pranë këtyre bujtinave. Përmes këtij projekti pritet jo vetëm rritje ekonomike e familjeve/fermerëve të përfshirë në projekt, por mbi të gjitha do të kontribuohet në përmirësimin e imazhit të Bashkisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i turizmit, si-domos në zonat rurale; - Lidhja e zhvillimit të bujqësisë e blegtorisë me agroturizmin; - Përfshirja e fermerëve në ngritjen dhe menaxhimin e bujtinave; - Ndërtimi i një marrëdhënieje të shën-doshë midis Bashkisë, donatorëve të mundshëm dhe fermerëve e familjeve pritëse; - Rritje e punësimit, sidomos tek të rinjtë dhe gratë.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
	10. Ngritja e Zyrës së Punës në Belsh	Bashkia Belsh ka një përqindje të lartë papunësie, veçanërisht tek të rinjtë dhe tek gratë. Kjo vjen deri diku si rrjedhojë e mbështetjes së ekonomisë ven-dase kryesisht në sektorin bujqësor ndërkohë që sektorët e tjerë të shërbimeve dhe industrisë janë shumë të vegjël për të gjeneruar punësim për të gjithë. Për këtë arsye, ky projekt konsiston në hapjen e zyrës së punës në Bashkinë Belsh, e cila do të kontribuojë veçanërisht edhe në diversifikimin e vendeve të punës dhe rritjen e mundësive për punësim tek të rinjtë dhe gratë.	700,000 Lekë 12 muaj
<i>Infrastruktura Rrugore</i>	11. Asfaltimi i Rrugës Belsh-Kajan-Dragnet	Përshkrimi i projektit Projekti konsiston në asfaltimi të rrugës Belsh-Kajan-Dragnet. Është një ndër rru-gët lidhëse më të rëndësishme në zonën e Belshit. Rruga kalon në mes të bashkisë dhe është e rëndësishme për rritjen e aksesueshmërisë. Rruga ka filluar dhe ekziston projekti, por nuk është përfunduar. Ka mbetur shtrimi dhe stabilizimi i saj në disa pjesë, por si rrjedhojë e mos përfundimit ka nevojë të vlerësohet dhe	35,000,000 Lekë 12 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Belsh	100 % Bashkia	<ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimin e vendit të zyrës;- Rregullimin e ambienteve të punës dhe plotësimin me materiale; - Gjetjen dhe trajnimin e stafit; - Krijimin e lidhjeve strategjike me bizneset lokale; - Organizimin e eventeve trajnuese dhe “networking” midis punëdhënësve-punëmarësve; - Organizimin e trajnimeve në bazë të nevojave lokale. 	<ul style="list-style-type: none"> - 10,000 përfitues direkt dhe indirekt; - Këshillim karriere për mbi 1,000 nxënës të shkollave të mesme; - Këshillim karriere dhe trajnim për të rinj të pa-punë, - Këshillim dhe trajnim për gratë e papuna.
Bashkia Belsh	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve - Granti konkurrues për infrastrukturën vendore	<ul style="list-style-type: none"> - Studimin e situatës së rrugës pas investimit fillestar; - Aplikimin për fonde; - Asfaltimin e rrugës. 	<p>Numri i përfituesve nga asfaltimi i këtij segmenti rrugor parashikohet të jetë rreth 10,000 individë, banorë të zonave përreth. Ky aks gjithashtu shërben për të lidhur më mirë Kajanin si një ndër njësitë administrative kryesore me Belshin.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rritja e aksesueshmërisë në Belsh; - Asfaltimi i 12 km rrugë rurale; - Integrimi i zonave rurale me akset kryesore dhe qendrat kryesore të banuara.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		përmirësohet stabilizimi i saj. Në fund më pas do të asfaltohet.	
	12. Krijimi i vendqëndrimit të automjeteve të transportit pasagjer	Projekti konsiston në ndërtimi dhe rregullimin e një vendqëndrimipër mjetet e transportit të pasagjerëve në nivel ndër-qtetas dhe brenda njësive administrative të Bashkisë. Aktualisht janë dy pika në të cilat pozicionohen mjetet e transportit, të cilat shkaktojnë konfuzion dhe trafik të panevojshëm në zonë. Vendqëndrimi do të unifikohet në një të vetëm, pranë Postës së Qytetit të Belshit.	5,000,000 Lekë 12 muaj
	13. Krijimi i Unazës Rrugore të qytetit të Belshit	Aktualisht të gjitha mjetet që udhëtojnë në drejtim të Belshit me orientim Veri-Jug dhe Lindje-Perëndim kalojnë në mes të qytetit. Kjo gjë shkakton shpesh trafik dhe ndotje të ajrit. Në disa raste ka edhe mjete të tonazhit të rëndë, të cilat janë të detyruara të kalojnë në mes të qendrës urbane në mënyrë që të vazhdojnë më pas për në destinacionin e tyre. Projekti konsiston në ndërtimi e një unaze rrugore në qytetin e Belshit, e cila do të mënjanojë trafikun nga qendra e qytetit në formën e një bypassi.	28,000,000 Lekë 24 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Belsh	5% Bashkia Fondi për Zhvillimin e Rajoneve- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitjen e projektit të detajuar; - Aplikimin për fonde; - Implementimin e projektit. 	<p>Përfitues të këtij projekti do të jenë të gjithë banorët e Bashkisë Belsh.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Reduktim i trafikut në Belsh; - Informacion i qartë për udhëtarët; - Thjeshtëzim dhe formalizim i transportit ndërqytetas; - Lehtësim në qarkullimin ndërqytetas, dhe rritje e lëvizshmërisë nëpër territorin e Bashkisë.
Bashkia Belsh	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve - Granti konkurrues për infrastrukturën vendore	<ul style="list-style-type: none"> - Faza 1 implmentimi i unazës veriore të qytetit të Belshit - Faza 2, përgatitja e projektit për unazën lindore - Aplikimi për fonde - Implementimi i projektit 	<p>Përfitues të këtij projekti janë banorët e qytetit të Belshit dhe zonave përreth, si dhe bizneset kryesore që operojnë në zonë.</p> <p>Përmes projektit pritet të arrihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Reduktim i trafikut; - Eficientim i qarkullimit rrugor dhe sistem i plotë infrastrukturor; - Devijim i trafikut të rëndë jashtë qendrës urbane; - Reduktim i ndotjeve urbane, të ajrit dhe akustike.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
<p><i>Përmirësimi i Cilësisë së Shërbimeve Publike.</i></p>	<p>14. Përmirësimi i cilësisë së Shkollave të mesme</p>	<p>Cilësia e shkollave të mesme në Belsh është e dobët. Ndërtesatjanë të amortizuara dhe nuk ofrojnë një ambjent të përshtatshëm për mësimdhënie. Strukturat janë të vjetëruara dhe kanë mangësi në izolim e termo-izolim, duke rritur mjaft kostot e përdorimit të mjeteve alternative për të siguruar kushtet e përshtatshme gjatë periudhës së pikut në verë dhe dimër. Projekti konsiston në përmirësimin e godinave të dy shkollave tëmesme në Bashkinë Belsh. Secila prej tyre do të marrë funksione shtesë dhe njëra prej tyre do të shërbejë edhe si qendër komunitare për Njësinë Administrative të Belshit. Qëllimi i kësaj qendre komunitare do të jetë ofrimi i trajnimeve dhe konsultimi i grave në zonat rurale.</p>	<p>9,000,000 Lekë 36 muaj</p>
	<p>15. Përmirësimi i cilësisë së ambjeteve të ambulancave</p>	<p>Situata e ndërtesave të qendrave shëndetësore në Bashkinë Belsh është e dobët. Shumë prej tyre janë të amortizuara dhe në nevojë për rikonstrukcion. Gjithashtu, edhe përsa i përket pajisjeve, konstatuar edhe nga vizitat në terren, vërehet që ka mjaft mangësi. Projekti konsiston në përmirë-</p>	<p>50,000,000 Lekë 36 muaj</p>

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Belsh	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve - Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar	<p>Faza 1:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i projektit të detajuar - Rikonstruksion i shkollës dhe konvertim në qendër për komunitetin <p>Faza 2:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitje e projektit të detajuar - Rikonstruksion i shkollës së dytë 	<p>Përfitues janë nxënësit e shkollave të mesme (gjithsej rreth 300 nxënës). Projekti synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kushte më të mira dhe performace më e mirë nga nxënësit dhe mësuesit e këtyre shkollave; - Gratë si përfituese të shërbimeve të qendrës komunitare; - Rritje e numrit të nxënësve që ndjekin shkollën e mesme.
Bashkia Belsh	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve - Granti konkurrues përshëndetësinë	<p>Rikonstruksioni dhe plotësimi me pajisje i:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qendra Shëndetësore Rrasë; - Qendra Shëndetësore Fierzë; - Qendra Shëndetësore Kajan; - Qendra Shëndetësore Grekan; - Qendra Shëndetësore Belsh. 	<p>Përfitues të projektit janë të gjithë banorët e Belshit. Projekti synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kushte të përshatshme dhe ftuese sidomos për të rinjtë dhe gratë (në veçanti nënat e reja, apo ato me probleme); - Kujdes dedikuar edhe të moshuarve; - Përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit shëndetësor; - Plotësimin me pajisje për kontrollin shëndetësor;

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		<p>simin e godinave të qendrave shëndetësore në Njësitë Administrative kryesore të Bashkisë Belsh.</p> <p>Projekti është i ndarë në disa faza dhe secila fazë konsiston me përmirësimin e cilësisë së një qendre.</p> <p>Përtej përmirësimit të aspektit fizik të ndërtesave e rëndësishme është që të plotësohen edhe me pajisje të specializuara.</p>	
<p><i>Mirëqënia Sociale dhe Ekonomike</i></p>	<p>16. Zhvillimi i Qendrës Multifunktionale Belsh</p>	<p>Projekti synon zhvillimin e një Qendre Multifunktionale Kulturore në qytetin e Belshit, e cila do t'i shërbejë të gjithë qytetarëve, por me një fokus të vecantë tek tek të rinjtë dhe gjinia femërore. Për këtë projekt do të përdoret ndërtesa e ish-Mapos, e cila duhet fillimisht të rikonstruktohet dhe më pas të zgjerohet sipërfaqja, në mënyrë që të akomodojë të gjitha aktivitetet e parashikuara. Qendra Multifunktionale Kulturore duhet të ketë ambiente të ndryshme për të akomoduar një sërë aktivitetesh. Aty mund të krijohen kushtet që të zhvillohen lojëra të ndryshme si: shah, volejbol, basketboll, balet; si dhe kurse gjuhësh të</p>	<p>25,000,000 Lekë</p> <p>20 muaj</p>

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
			<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësim e kushteve të ndërtesave të qendrave shëndetësore; - Plotësimi me staf të specializuar në fusha të ndryshme.
Bashkia Belsh	FZHR- Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e projektit teknik; - Rikonstruksioni dhe krijimi i hapësirave të përshtatshme në ambientet e ish-Mapos; - Plotësimi me bazën materiale; - Promovimi dhe zhvillimi i aktiviteteve gjithë-vjetorë. 	<p>Përfituesit kryesorë janë banorët e Bashkisë Belsh, por edhe të njësive të tjera administrative. Projekti synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rritjen e angazhimit të rinjve në jetën social-kulturore; - Integrim më të madh të gjinisë femërore në jetën social-kulturore; - Trajnime dhe mundësi për zhvillimin e kapitalit social; - Gjenerim idesh dhe “start-up”; - Zhvillim aktiviteteve social kulturore.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		huaja, kinema në sallë të vogël, sallë për shfaqje, sallë bibli-oteke, sallë për muze, salla/klasa të një madhësie më të vogël për trajnime dhe kurse të tilla si muzikë, viza-tim/pikturë, IT, zhvillim biznesi etj.	
	17. Zhvillimi i Qendrës Rinore, Dëshiran	Projekti konsiston në hapjen një Qendre Rinore në fshatin Dëshiran. Ky është një ndër fshatrat më të mëdhenj të Bashkisë, me një numër të konsiderueshëm banorësh. Momentalisht në këtë fshat ka një ndërtesë ekzistuese, e cila nuk është në përdorim dhe ndodhet në kushte shumë të këqija. Me anë të ndërhyrjeve rikonstruktuese kjo ndërtesë mund të shndërrohet në një pol të rëndësishëm kulturor me fokus të rinjtë e kësaj Njësie Administrative.	15,000,000 Lekë 12 muaj
Mjedisi	18. Rehabilitimi i Liqenit të Belshit dhe krijimi i Parku përreth Liqenit.	Një ndër liqenet më të ndotura është dhe ai i Belshit që ndodhet në qendër të qytetit të Belshit. Edhe pse ky liqen konsiderohet si një potencial i rëndësishëm, momentalisht është në nivele të larta të ndotjes dhe nuk përdoret si nga qytetarët për arsye rekreacioni. Projekti syn-	96,000,000 Lekë

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Belsh	10% Bashkia Belsh FZHR- Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar	<ul style="list-style-type: none"> - Projekti i detajuar teknik; - Gjetje e fondeve; - Implementim i projektit; - Promovim i Qendrës Rinore. 	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i përfituesve është rreth 500 të rinj nxënës të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare (të ndarë sipas gjinive); - Përfitim në një edukim më të mirë dhe sensibil-izim ndaj tij; - Shtim të aktiviteteve jashtë-shkollore; - Shtim të aktivitete so-cial-kul-turore.
Bashkia Belsh	FZHR: <ul style="list-style-type: none"> - Granti konkurrues për infrastrukturën vendore; - Granti konkurrues për pyllëzimin. 	<ul style="list-style-type: none"> - Së pari duhet të evidento-hen të gjithë ndotësit e zonës; - Të atakohen burimet e ndotjeve kryesore (ndotje të ngurta, ndotje të kanal-izimeve të ujërave të zeza, ndotje nga bujqësia etj.); - Të realizohet rigjenerimi dhe patrimi i habitatit natyror të liqenit me anë të veg-jetacionit dhe tekni-kave 	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësim i imazhit të qytetit; - Përmirësim i perfor-mancës mjedisore; - Reduktim i reziqeve të sëmund-jeve si rrjedhojë e ndotjes së liqenit; - Më shumë hapësira kualitative për aktivitete rekreative për banorët; - Më tepër mundësi për gjithëpërfshirjen e grupeve të ndryshme (të rinjtë, fëmijët,

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		<p>on të ndryshojë imazhin e qytetit të Belshit, duke idhënë atij një mundësi për të rigjeneruar hapësirën natyrore. Përtej këtij aspekti ai do të ndikojë dhe në rritjen e cilësisë dhe performancës mjedisore, duke qenë se synohet të bëhet rehabilitimi i liqenit dhe zonës përreth, duke përdorur teknika ambientale dhe miqësore ndaj mjedisit (rigjenerimi përmes shtimit të vegjetacionit dhe bimësisë që pastron habitatin natyror).</p>	
	<p>19. Studim mbi ndotjen e liqeneve të Belshit</p>	<p>Bashkia e Belshit është e njohur për prezencën e 84 liqenevekarstike, të cilat përbëjnë një burim të rëndësishëm ekonomik për zonën, qoftë në përdorimin e tyre për peshkim, ashtu edhe për sa i përket rëndësisë që kanë në zhvillimin e bujqësisë dhe rezervave ujore që ato ofrojnë. Liqenet përbëjnë gjithashtu një potencial të madh edhe për sa i përket zhvillimit të turizmit dhe aktiviteteve rekreative, edhe pse momentalisht ky potencial nuk është shfrytëzuar plotësisht. Një ndër problematikat kryesore që prek liqenet e Belshit është ndotja që i është bërë, dhe këtu përmendim si mbetjet</p>	<p>1,000,000 Lekë 6-8 muaj</p>

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
		<p>miqësore ndaj mjedisit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i parkut përreth liqenit të Belshit (shtimi i vegjetacionit, stolave, koshave për mbetjet, elementëve të ndriçimit); - Krijimi i shëtitorës që lidh qendrën e qytetit me liqenin dhe parkun përreth liqenit. 	<p>gratë dhe nënat, të moshuarit në jetën sociale dhe aktivitetet e ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Edukim i brezave të rinj për të mbrojtur natyrën dhe bashkëjetuar me të.
Bashkia Belsh	<p>20 % Bashkia.</p> <p>Fonde dhe Donacione të tjera</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Marrjen e kampionëve të ujit nga liqenet; - Kryerjen e analizave; - Identifikimin e burimeve të ndotjeve; - Rekomandime dhe masa për rehabilitimin e liqeneve dhe habitateve të tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim i nivelit të ndotjeve; - Gjetjen e masave mjedisore dhe inxhinierike për rehabilitimin e liqeneve të ndotura; - Sensibilizimin e qytetarëve për të mirëmbajtur asetet natyrore; - Përmirësim të performancës natyrore të liqeneve dhe habitateve të tyre përkatëse; - Mundësi më të mëdha për përfshirjen e liqeneve në programe të veçanta, dedikuar zhvillimit të turizmit.

PRIORITETI OPERACIONAL	PROJEKTI KONKRET	GRUPI I SYNUAR DHE SI ADRESOHET	PERIUDHA E ZBATIMIT DHE VLERA E FONDIT
		urbane, ujërat e zeza dhe mbetjet bujqësore, të cilat derdhen të tëra në liqen. Për këtë arsye është e nevojshme të bëhet një studim i thelluar mbi ndotjen e liqeneve, faktorëve ndotës, masat parandaluese të ndotjeve dhe teknikat e rigjenerimit të liqeneve të ndotur.	
<i>Diversifikim i Ekonomisë dhe Ngritje Kapacitetesh</i>	20. Ngritja e Qendrës Trajnuese / Trajnimi i Udhëheqësve të Guidave Turistike	Projekti synon që të rrisë kapacitetet vendase për të përkrahur dhe zhvilluar më tej të gjitha format e turizmit, brenda Bashkisë Belsh. Bashkia është e pasur me potenciale dhe pejzazhe të rralla natyrore, objekte historike, si dhe ofron mundësi të shkëlqyera për zhvillimin e turizmit bazuar tek bujqësia, blegtoria dhe arti-zanati, si në produkte artistike, ashtu edhe në ato ushqimore vendase. Krijimi i një strukture që merret me ngritjen e kapacitetit dhe trajnimin e të rinjve/rejave vendase për të mirëpritur zhvillimin e turizmit, është me mjaft rëndësi për Bashkinë e Belshit.	500,000 Lekë 10 muaj

PËRGJEGJËSIT DHE ZBATUESIT	BURIMI FINANCIAR DHE %-ET	MËNYRA E ZBATIMIT	IMPAKTI I PRITSHËM DHE SUPOZIME
Bashkia Belsh	<p>50% Bashkia</p> <p>USAID, GIZ, ADA, ADF, SIDA, etj.</p> <p>NGO që meren me përkrahjen dhe zhvillimin e turizmit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përpilimin e Strukturës dhe Programit Trajnues; - Gjetja e partnerëve trajnues (NGO, etj.); - Gjetja e partnerëve të tjerë vendas që do të ndihmojnë në njohjen e potencialeve dhe pasurive kryesore për zhvillimin e Turizmit në Bashkinë Belsh; - Ngritja e infrastrukturës bazë pranë Qendrës Rinore. - Pajisja me të gjitha mjetet e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit trajnues; - Promovimi i Strukturës dhe Programit trajnues në të gjithë Bashkinë Belsh; - Identifikimi i 30 personave të parë që do të bëhen pjesë e trajnimit; - Planifikimi i hapave të mëtejshme të Strukturës dhe Qendrës Trajnuese. 	<p>Përfitues të hartimit të këtij projekti janë banorët e zonës (të rinjtë/rejat, sidomos grupet në nevojë: gratë dhe vajzat e dhunuara; grupet Rome dhe Egjiptiane), bizneset e vogla, dhe shërbimet turistike. Projekti synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të rrisë eficientimin e investimit në zhvillimin ekonomik, duke integruar kapitalin human vendas; - Aftësim të kapitalit human vendas, duke rritur interesin për të qëndruar në Bashkinë Belsh, duke ulur kështu popullsinë emigruese/migruese.

PLANI OPERACIONAL PËR ZHVILLIM DHE PLANIFIKIMIN E TERRITORIT



Bashkia Belsh nuk zotëron ndonjë plan të zhvillimit të territorit, dhe njëkohësisht nuk ka filluar proceset e hartimit të planit të përgjithshëm vendor, apo të strategjisë së zhvillimit të territorit. Bazuar në ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Bashkitë, brenda një afati kohor prej dy vjetësh nga miratimi i ligjit duhet të hartojnë planet e përgjithshme vendore.

Në kontekstin e planifikimit të territorit, plani operacional për zhvillimin lokal nuk zëvendëson Planin e Përgjithshëm Vendor, por ndihmon në procesin e hartimit të tij. Në këtë kuadër, grupi i konsulentëve është treguar i kujdesshëm që të shfrytëzojë procesin e hartimit të Planit Operacional për Zhvillimin Lokal edhe si pjesë e procesit të vizionimit.

Bashkia, tashmë ka të identifikuar disa prej problematikave më kryesore si dhe disa prioritete zhvillimi. Edhe pse vizioni është ende në fillesat e hartimit të tij, përbën një bazë të mirë për të filluar hartimin e strategjisë së zhvillimit të territorit. Për të arritur në formulimin e strategjisë është e nevojshme që bazuar në prioritetet e përcaktuara në këtë dokument të elaborohen më tej politikat përkatëse sektoriale në mbështetje të vizionit dhe qëllimeve të zhvillimit.

Plani Operacional për Zhvillimin Lokal, shërben si një hap fillestar në proceset e planifikimit por që në asnjë mënyrë nuk zëvendëson Planin e Përgjithshëm Vendor. Në të identifikohen problematikat kryesore dhe parashtrihen disa prioritete zhvillimi të cilat më pas duhet të mbështeten me politika të qarta lokale (strategjia e zhvillimit) si dhe të përkthehen në përdorime të përshtatshme të tokës (plani i përdorimit të tokës) të shoqëruara me rregullat përkatëse të zhvillimit (rregullore e planit të përgjithshëm vendor).

Hartimi i planit të përgjithshëm vendor kalon në disa faza. Fillimisht duhet hartuar Nisma për Hartimin e Planit si dhe krijuar Forumi i Këshillimit dhe i Bashkërendimit. Faza e dytë lidhet me vlerësimin dhe analizën e thelluar të territorit. Faza e tretë është strategjia e territorit dhe vizioni strategjik. Nëpërmjet Planit Operacional të Zhvillimit Lokal është krijuar një inventar i mirë i situatës ekzistuese si dhe janë përcaktuar disa prioritete kryesore.

Për këtë arsye dy fazat e para duhet të zhvillohen brenda një afati kohor të shkurtër. Faza e 3 lidhet me hartimin e Planit të Përdorimit të Tokës si dhe me rregulloret në

zbatim të tij. Në fund, hartohen planet e investimeve si dhe vlerësimi strategjik mjedisor. Gjatë gjithë kohës së hartimit të planit të përgjithshëm vendor, Bashkia duhet të sigurojë përfshirjen e publikut. Në fund plani duhet të shoqërohet me procesin paralel të hartimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.





ANEKSI 1

(PROJEKT - FISHAT)

NGRITJA E KAPACITETEVE VENDORE NË MENAXHIMIN, PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT

PROJEKT 1	
• Titulli i projektit	Trajnimi i Stafit Lokal në Planifikim Terriori dhe Aspekte Sociale
• Tipi i Projektit	Shërbime Publike/ Kapacitete Vendore
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Belsh (duke integruar stafin e Njësive Administrative)
• Buxheti total i projektit	500,000- 700,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 50% Donacione të tjera të mundshme: MZHU, AKPT, MMSR, PLGP USAID, UNDP, OSCE
• Përshkrimi i projektit	<p>Bashkia Belsh ka në strukturën e saj një staf prej 114 personash. Me ndryshimet e reformës territoriale, Bashkisë i janë shtuar kompetencat si dhe tashmë duhet të menaxhojë një territor shumë më kompleks si nga pikëpamja hapësinore ashtu dhe nga diversiteti i çështjeve sociale, ekonomike e kulturore.</p> <p>Gjithashtu, koordinimi i Njësive Administrative është një sfidë më vete, me të cilën përballlet Bashkia. Në mënyrë që të garantohet një zhvillim sa më i qëndrueshëm i Bashkisë si dhe të ofrohet një shërbim sa më cilësor ndaj qytetarit është tejet e nevojshme që të ngrihen kapacitetet e punonjësve të qeverisë vendore. Në këtë aspekt janë identifikuar dy fusha si më prioritaret:</p> <ol style="list-style-type: none">Planifikim dhe Menaxhim TerrioriTrajtimi i çështjeve sociale (duke përfshirë aspekte të barazisë gjinore) <p>Përsa i përket planifikimit dhe menaxhimit të territorit, trajnimet mund të konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none">- Hartim politikash zhvillimi;- Përdorimi i instrumentave të drejtimit të zhvillimit;- Përdorimi i GIS dhe Regjistrimit të Territorit;- Ngritja e databazës së të dhënave për Bashkinë e re të Belshit, menaxhimi dhe përditësimi i saj i vazhdueshëm;- Menaxhim Projektsh;- Rregulla të përdorimit të tokës; <p>Ndërkohë përsa i përket çështjeve sociale trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve mund të konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none">- Trajnime për trajtimin e rasteve të dhunës në familje;- Trajnime për trajtimin e grave të dhunuara;- Trajnime për këshillimin e të rinjve;- Trajnime për strehimin social;- Trajnime për integrimin e grave dhe të rinjve në shoqëri.

<ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi dhe objektivat 	<ul style="list-style-type: none"> - Ngritja e kapaciteteve vendore në administratën publike; - Ngritja e kapaciteteve vendore në planifikimin e territorit; - Ngritja e kapaciteteve vendore në menaxhimin e territorit; - Ngritja e kapaciteteve vendore për menaxhimin e çështjeve so-ciale; - Ngritja e mekanizmit të Referifimit për dhunën në familje.
<ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e pritshme 	<p>Ngritja e kapaciteteve do të aplikohet në të paktën 50 punonjës të qeverisjes vendore në sektorët kyç si planifikim i territorit, projekte strategjike, ndihma sociale etj. Kjo gjë do të aplikohet jo vetëm për Njësinë Administrative Belsh por edhe për stafin e Njësive të tjera Administrative. Ngritja e kapaciteteve të administratës vendore ndikon drejtpërdrejtë në ofrimin e një shërbimi cilësor ndaj qyteterëve dhe palëve të tjera të interesuara. Gjithashtu, krijon një ambient të përgatitur për t'u përballur me sfidat territoriale të reformës administrative.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Rendi prioritar 	7 / 10
<ul style="list-style-type: none"> • Qëndrueshmëria e projektit 	<p>Rëndësia e këtij projekti është shumë e madhe edhe për projekte e tjera të hartuara në kuadër të Planit Operacional për Zhvillimin Vendor. Ky investim në trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve do të garantojë një implementim të suksesshëm të projekteve të tjera si dhe do të ndihmojë në ngritjen e kapacitetit të bashkisë për të hartuar projekte dhe plane të tjera afatgjatë.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e projektit 	<p>Projekti do të ketë një kohëzgjatje prej 12 muajsh dhe në të parashikohen:</p> <ol style="list-style-type: none"> Lidhje e marrëveshjeve me MZHU, AKPT, MMSR si dhe organizata të tjera, të cilat ofrojnë ngritje kapaciteti në fushat e sipërpërmendura; Ndjekje e trajnimeve të specializuara të organizuara nga Qeveria, Organizata, Programe Ndërkombëtare etj.; Ndjekje të kurseve të specializuara; Vizita në Bashki të tjera për njohjen me praktika më të mira.
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	N/A
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim. 	<p>Projekti është në nivel koncept ideje. Duhet dakordësuar me Ministrinë e Zhvillimit Urban, Agjencinë Kombëtare të planifikimit të Territorit, Ministrinë e Mirëqënies Sociale, Universitete, Programe Ndërkombëtare, OJQ/F për organizimin e trajnimeve. Gjithashtu duhen krijuar kontakte (ose binjakëzime) me Bashki të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për njohjen me praktika të mira.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	N/A

PROJEKT 2	
• Titulli i projektit	Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor
• Tipi i Projektit	Planifikim Territori
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Belsh
• Buxheti total i projektit	15,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 10-15 % Donacione të tjera të mundshme: MZHU, AKPT, MMSR, PLGP USAID, UNDP, OSCE
• Përshkrimi i projektit	<p>Bashkia Belsh nuk ka një Plan të Përgjithshëm Vendor. Bazuar në ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të gjitha njësitë e qeverisjes vendore duhet të hartojnë planet e tyre vendore brenda një periudhe 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e ligjit. Duke marrë në konsideratë reformën territoriale dhe zgjedhjet vendore të vitit 2015, atëherë dhe afati i hartimit të PPV është shtyrë. Në këtë kontekst, Bashkia Belsh, ba-zuar në dispozitat ligjore duhet të hartojë PPV brenda 2017. Gjithashtu, PPV është i nevojshëm për të mundësuar që zhvillimi të jetë sa më i qëndrueshëm. Bashkitë mund të japin leje ndërtimi vetëm në sajë të PPV. Në këtë kontekst, hartimi i PPV është tejet i nevojshëm për mirë menaxhimin dhe zhvillimin e territorit të Bashkisë. Në fund, PPV është i nevojshëm për koordinimin e politikave të ndryshme sektoriale dhe drejtimin e punës dhe projekteve të Bashkisë.</p> <p>Projekti përbëhet nga disa faza:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fillimisht është faza përgatitore ku duhen grumbulluar të gjithë materialet e nevojshme për hartimin e PPV, gjithashtu në këtë fazë duhet hartuar Nisma për Hartimin e Planit si dhe krijuar Forumi i Këshillimit dhe i Bashkërendimit. - Faza e dytë lidhet me vlerësimin dhe analizën e thelluar të territorit. Në këtë fazë analizohen dhe evidentohen të gjitha aspektet e zhvillimit të territorit si ato urbanis-tike, mjedisore, zhvillimi ekonomik dhe social. Gjithashtu e rëndësishme është edhe ndërthurja e komponentëve të çështjeve gjinore. - Faza e tretë është strategjia e territorit dhe vizioni strategjik. Nëpërmjet Planit Operacional të Zhvillimit Lokal është krijuar një inventar i mirë i situatës ekzistuese si dhe janë përcaktuar disa prioritete kryesore. Për këtë arsye dy fazat e para duhet të zhvillohen brenda një afati kohor të shkurtër. - Faza e 4 lidhet me hartimin e Planit të Përdorimit të Tokës si dhe me rregulloret në zbatim të tij. <p>Në fund, hartohen Planet e Investimeve Kapitale si dhe Vlerësimi Strate-gjik Mjedisor. Gjatë gjithë kohës së hartimit të PPV, Bashkia duhet të sig-urojë përfshirjen aktive të publikut.</p>

<ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi dhe objektivat 	<p>Qëllimi i punës konsiston në një numër aktiviteteve/studimesh që do të çojnë drejt produktit final të dokumentit të planifikimit të përgjithshëm vendor dhe komponentëve të tij, sipas përcaktimeve të Ligjit dhe rregullore në zbatim të tij.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e pritshme 	<p>Përfitues të hartimit të këtij projekti janë banorët e Bashkisë Belsh, fermerët, investitorët dhe vetë Bashkia. Rezultatet e pritshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhim më i mirë i territorit dhe kontroll mbi zhvillimin; - Mundësi për rritjen e investimeve dhe rritje ekonomike; - Ulja e numrit të popullsisë që largohet nga Bashkia; - Zhvillim i qëndrueshëm.
<ul style="list-style-type: none"> • Rendi prioritar 	<p>7 / 10</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Qëndrueshmëria e projektit 	<p>Projekti bazohet në përcaktimet e ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Projekti më pas do të garantojë bazën për zhvillimin e territorit të Bashkisë Belsh.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e projektit 	<p>Projekti për Hartimin e PPV për Bashkinë Belsh parashikohet të zgjasë për një periudhë 12 Mujore. Në të parashikohen aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nisma për hartimin e PPV (2-3 Javë); - Formimi i grupit të punës (2-3 javë); - Formimi i Forumit për Bashkërendimin dhe Këshillimin (1-2 javë); - Hartimi i Analizës së thelluar të territorit (3-4 muaj); - Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Territorit (2 muaj); - Hartimi i Planit të Përdorimit të Tokës dhe Rregullores së Planifikimit dhe Zhvillimit (3-4 muaj); - Dëgjesa Publike (të paktën 2 dëgjesa); - Hartimi i Planit të Investimeve Kapitale dhe Vlerësimit Satrate-gjik Mjedisor (1 muaj); - Dërgim për miratim në KKT (1 muaj).
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	<p>Hartimi i PPV shoqërohet me Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Kjo gjë garanton impaktin që impakti i politikave territoriale të jetë sa më i vogël në mjedis, si dhe garanton masat, të cilat duhen marrë në mënyrë që të minimizohen problematikat si dhe të përmirësohet cilësia e mjedisit. Një komponent i rëndësishëm i VSM ka të bëjë edhe me ndryshimet klimatike dhe me marrjen e masave në mënyrë që Bashkia të jetë sa më e përgatitur në këtë aspekt.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim. 	<p>Plani Operacional për Zhvillimin Lokal ofron një bazë të mirë për fillimin e punës për hartimin e PPV. Në të janë identifikuar disa nga problematikat kryesore, me të cilat përballë Bashkia si dhe janë përcaktuar prioritetet për zhvillim. Ky plan përbën bazën për fillimin e punës, për hartimin e PPV dhe drejtimet kryesore mbi të cilat duhet të bazohet plani.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	<p>Hartimi i PPV bazohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parashikimet ligjore të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; - Planin e Përgjithshëm Kombëtar (draft).

PROJEKT 3	
• Titulli i projektit	Ngritja e Zyrës me një ndalesë për “Zhvillimin e Territorit” (One Stop Shop)
• Tipi i Projektit	Shërbime Publike
• Vendndodhja e projektit	Belsh (Qytet)
• Buxheti total i projektit	500,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 70-100%
• Përshkrimi i projektit	<p>Bazuar në parashikimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe në VKM “Për Zhvillimin e Territorit”, në të cilën thuhet se “Njësitë e Qeverisjes vendore duhet të marrin masa për ngritjen e zyrave me një ndalesë për zhvillimin e territorit”. Deri më tani, Bashkia Belsh nuk ka një strukturë të tillë dhe aplikimet për lejet e ndërtimit me-naxhohen nga zyra e planifikimit të territorit.</p> <p>Projekti konsiston në hapjen e një zyre me një ndalesë për “zhvillimin e territorit”. Kjo zyrë do të kryejë shërbimet e nevojshme për kërkuesit e lejeve të ndërtimit. Disa nga shërbimet e zyrës lidhen me dhënien e in-formacionit mbi procedurat e lejeve të ndërtimit, koordinim institucional për thjeshtëzimin e procedurave të lejeve.</p> <p>Gjithashtu, në një fazë të dytë, pasi zyra të ketë fituar eksperiencë mund të kalohet në ofrimin e shërbimit për Lejet Elektronike. Ky është një pro-jekt, i cili po aplikohet fillimisht nga MZHU në nivel qendror dhe që më pas mund të aplikohet në nivel vendor.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<p>Qëllimi i punës konsiston në reduktimin e burokracive procedurale dhe thjeshtëzimin e procedurave për marrjen e lejeve të ndërtimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngritja e zyrës me një ndalesë; - Ngritja e kapaciteteve vendore; - Thjeshtëzim dhe qartësim i procedurave; - Përmirësim i shërbimeve publike.
• Rezultatet e pritshme	<p>Përfitues të hartimit të këtij projekti janë banorët dhe personat e inter-esuar për të ndërtuar dhe investuar në Bashkinë Belsh. Disa nga përfitimet kryesore të këtij projekti konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përsheptim të afateve për pajisjen me leje ndërtimi; - Zvogëlim të burokracive administrative; - Zvogëlim të kostove ekonomike për aplikuesit për leje ndërtimi; - Tërheqjen e investitorëve si rrjedhojë e përmirësimit të cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit.
• Rendi prioritar	5 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i qëndrueshëm dhe në kombinim me dy projektet e mëparshme për ngritjen e kapaciteteve vendore dhe hartimin e PPV për Bashkinë ofron një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e territorit të Belshit.

<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e projektit 	<p>Projekti parashikohet të zgjasë për një periudhë 4 mujore deri në im-plementimin e plotë të tij. Disa nga aktivitetet kryesore të parashikuara përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimin e vendit (zyrës), ku do të vendoset shërbimi me një ndalesë për Zhvillimin e Territorit; - Përcaktimi dhe plotësimi i stafit të përfshirë në këtë zyrë; - Trajnimi i stafit dhe njohja me dispozitat ligjore dhe proceduriale bazuar në Ligjin 107/2014 “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; - Plotësimi me bazën materiale si kompjutera, printera, internet, orendi zyre etj.
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	<p>N/A</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim 	<p>Projekti është në fazë koncepti. Bashkia duhet të përzgjedhë vendin ku do të vendoset shërbimi me një ndalesë për zhvillimin e territorit dhe më pas të ndiqen hapat e sipërpërmendura.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	<p>Ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar VKM “Për Zhvillimin e Territorit”.</p>

DIVERSIFIKIMI I EKONOMISË DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

PROJEKT 4	
• Titulli i projektit	Pastrimi dhe Rikonstruksioni i Kanaleve të Ujitjes dhe kullimit në Bashkinë Belsh
• Tipi i Projektit	Zhvillimi Ekonomik/ Infrastrukturë
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Belsh, Marinzë, Cërragë, Plevicë
• Buxheti total i projektit	26,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 5% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin, MBZHRAU
• Përshkrimi i projektit	<p>Bashkia e Belshit është thellësisht e varur nga sektori i bujqësisë, ku rreth 70% e punësimit është në këtë sektor. Si rrjedhojë e zhvillimeve in-formale dhe mungesës së investimeve në pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve të kullimit dhe ujitjes shumë prej tyre janë të bllokuar dhe jo-funksional</p> <p>Për këtë arsye, shpesh fermerët janë të detyruar që të rrisin kostot e pro-dhimit, si rrjedhojë e nevojës për të gjetur mënyra alternative dhe indi-viduale për ujitjen e tokave. Ky problem është i rëndësishëm në dy aspekte ku, së pari kostot e larta të ujitjes për fermerët dhe së dyti si rre-zik i ndotjes së shkaktuar në toka bujqësore.</p> <p>Projekti konsiston në rigjenerimin e kanaleve të ujitjes dhe kullimit në zonat Marinzë, Cërragë dhe Plevicë. Rigjenerimi konsiston në pastrimin dhe rikonstruksionin (aty ku është e nevojshme) e kanaleve të ujitjes dhe kullimit.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<p>Qëllimi i projektit është mbështetja e fermerëve lokalë. Ndër objektivat kryesore mund të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësim i situatës së kanaleve të ujitjes dhe kullimit; - Pastrim i kanaleve; - Rikonstruksion i kanaleve ekzistues; - Rigjenerim i sistemit të kanaleve të ujitjes dhe kullimit.
• Rezultatet e pritshme	<p>Përfitues të këtij projekti fillimisht do të jenë banorët dhe fermerët e zonave Marinzë, Cërragë dhe Plevicë. Rezultatet e pritshme janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rritja e produktivitetit; - Ulja e kostove të fermerëve; - Reduktim i ndotjes së ujërave si rrjedhojë e pastrimit të kanaleve.
• Renditja prioritar	9 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Ky projekt do të jetë i qëndrueshëm pasi do të shoqërohet me një sërë masash dhe projektesh të tjera për rigjenerimin e plotë të sistemit të kul-limit dhe vaditjes në Bashkinë Belsh. Në këtë kuadër gjithashtu do të ngrihen dhe strukturat përkatëse për mirëmbajtjen e kanaleve.
• Aktivitetet e projektit	Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 20 muajsh dhe është i ndarë në 3 faza sipas vendeve përkatëse të përcaktuara:

	<ul style="list-style-type: none"> - Marinzë - Cërragë - Plevicë <p>Fillimisht do të kryhet një vlerësim i detajuar i situatës së këtyre kanaleve, duke identifikuar ndërhyrjen me anë të pastrimit dhe rikonstruksionit, aty ku është e nevojshme.</p>
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazën e konceptit. Janë identifikuar nga bashkia 3 zonat më problematike përse i përket kanaleve të ujitjes dhe kullimit. Paraprakisht duhet kryer një studim i detajuar për vlerësimin e detajuar të situatës në këto tre zona e më pas të aplikohet për financim tek MBZHRAU.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	<ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave- Ujitja dhe Kullimi dhe Mbrojtja nga përmytja e Tokave Bujqësore (2014) - Plani i Përgjithshëm Kombëtar (Draft- 2016)

PROJEKT 5	
• Titulli i projektit	Ngritja e Qendrës së Grumbullimit të Produkteve Bujqësore/Blegtorale
• Tipi i Projektit	Zhvillim ekonomik
• Vendndodhja e projektit	Depo Nr.1, Shkozë, Lagjia Plepa
• Buxheti total i projektit	15,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 1% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU
• Përshkrimi i projektit	<p>Zona e Belshit ka një produktivitet të madh në duhan, vreshtari dhe ullinj. Gjithashtu në vitet e fundit janë zhvilluar dhe punishtet e ullirit, prodhimit të verës dhe rakisë. Aksesueshmëria në tregje më të mëdha për prodhuesit është shumë e vogël. Bashkia e Belshit është thellësisht e varur nga sektori i bujqësisë, ku rreth 70% e punësimit është në këtë sektor. Projekti synon gjithashtu të bëjë kontrollin e cilësisë dhe sigurinë e prodhimeve bujqësore.</p> <p>Projekti konsiston në ngritjen e një qendre grumbullimi për produktet vendase. Ndër problemet e tjera për këtë sektor është kostoja e lartë e dërgimit të këtyre produkteve në tregun e madh. Mungesa e një pike grumbullimi për të gjitha produktet e prodhuara në Bashki, bën që prodhuesit të kenë kosto të larta transportit lidhur me sasinë e ulët të produktit që ata tregtojnë individualisht, ndaj fitimi është shumë i ulët, për të mos thënë inekzistent. Qendra e grumbullimit do të mbështesë kryesisht produktet e duhanit, vreshtarisë dhe ullishteve, të cilat janë dhe prodhimet kryesore të zonës.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<p>Qëllimi i projektit është mbështetja e prodhimeve vendase.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Siguri për produktet bujqësore; - Rritje e tregtimit të produkteve bujqësore; - Mbështetje ndaj fermerëve; - Ngritje kapaciteti (duke operuar edhe si qendër trajnimi).
• Rezultatet e pritshme	<p>Duke qenë se gati 70% e punësimit në Bashkinë Belsh është e bazuar në bujqësi, masa përfitimeve nga ky projekt pritet të prekë një gamë të gjerë të popullsisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i vendeve të reja të punës me ngritjen e Qendrës së Grumbullimit (të paktën 20-30 vende pune); - Mbështetja e fermerëve (trajnime, konsultime, kontroll sigurie të produkteve etj).
• Rendi prioritar	8 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Zona e Belshit ka një produktivitet të madh në duhan, vreshtari dhe ullinj. Gjithashtu në vitet e fundit janë zhvilluar dhe punishtet e ullirit, prodhimit të verës dhe rakisë. Qendra e grumbullimit do të ofrojë siguri për fermerët dhe blerësit, në këtë mënyrë incentivohet prodhimi më i madh dhe jetëgjatësia e qendrës.

<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e projektit 	<p>Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 12 muaj. Disa nga aktivitetet më kryesore përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit për ngritjen e Qendrës së Grumbullimit; - Përgatitja e projektit teknik; - Aplikim për Fonde (Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave).
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	<p>Projekti duhet të shoqërohet me një Vlerësim të ndikimit në Mjedis. Një ndër çështjet më kryesore, e cila lidhet me mbetjet organike që mund të gjenerohen nga qendra është parashikuar në projekt. Qendra parashi-kohet të ndërtohet në depon Nr.1 në Shkozë, pra do të bëhet rehabilitimi i zonës dhe përshtatja për krijimin e Qendrës. Në këto kushte pas ndërhyrjes zona do të jetë në kushte më të mira se ato aktuale, por duhet gjithsesi adresuar çështja e ndotjeve gjatë funksionimit të kësaj Qendre. Një VNM duhet hartuar pasi të ketë mbaruar faza e projektimit të saj.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim 	<p>Projekti është ende në fazën e konceptit. Është parashikuar vendi për zhvillimin e projektit gjithsesi duhet të përgatitet projekti i detajuar teknik e më pas të aplikohet për fonde tek FZHR.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	<p>Projekti është në kuadër të strategjisë së Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për ngritjen e tregjeve dhe qendrave të grumbullimit. Gjithashtu bazohet në hartën e rajonalizimit të produkteve bujqësore dhe përbën një incentivë për zbatimin e kësaj politike.</p>

Figura 13: Skema e Funksionimit të Cluster-it të Bujqësisë (bashkangjitur në Aneks-in 2)

PROJEKT 6	
• Titulli i projektit	Krijimi i Thertores, Belsh
• Tipi i Projektit	Zhvillimi Ekonomik/ Blegtori
• Vendndodhja e projektit	Depo Nr.2, Shkozë, Lagjia Pepa
• Buxheti total i projektit	9,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 1% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU
• Përshkrimi i projektit	Projekti konsiston në ngritjen e një qendre thertoreje në Depon Nr. 2, Shkozë, Lagjia Pepa. Aktualisht thertoret janë në kushte të papërshtatshme dhe pa standartet e kërkuara sipas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Inspektoriatit Ushqimor, duke sjellë rrezik për konsumatorët. Është e nevojshme ngritja e një thertoreje, e cila duhet të plotësojë standartet e kërkuara, duke ofruar shërbim cilësor ndaj popull-sisë së Belshit. Thertorja do të mbështesë blegtorët vendas në mba-rështimin e kafshëve të imta, në veçanti gjelit të detit, qingjave/deleve dhe keçave/dhive. Thertorja do të ofrojë dhe shërbimin veterinar dhe kontrollin e vazhdueshëm. Ajo do ketë gjithë infrastrukturën e nevojshme, duke nisur nga pajisjet e nevojshme për therjen e bagëtive, maga-zinim, frigorifer dhe ambientin e shitjes dhe të transportimit, të gjitha të ndërtuara në bazë të standarteve.
• Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i projektit është mbështetja e prodhimeve vendase. Thertorja mbështet fermerët vendas. Garantohej cilësia ushqimore.
• Rezultatet e pritshme	Përfitues të hartimit të këtij projekti janë fermerët e zonës dhe rritja e produktivitetit. Aksesueshmëria në tregje më të mëdha për prodhuesit. Bashkia e Belshit është thellësisht e varur nga sektori i bujqësisë, ku rreth 70% e punësimit është në këtë sektor. Thertorja do të sigurojë gjithashtu kontrollin dhe sigurinë e prodhimeve bujqësore.
• Rendi prioritar	7 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Ky projekt është i lidhur me një sërë masash të tjera që Bashkia do të marrë në të ardhmen për incentivimin e zhvillimit ekonomik dhe atij rural. Ndërtimi i thertores pranë qendrës së grumbullimit është një avantazh. Projekti do të mirëmbahet më pas nga Bashkia, si dhe do të krijohen premiset për të vijuar më tej me Partneritete-Publike-Private për mirëmbajtjen dhe menaxhimin.
• Aktivitetet e projektit	Projekti do të ketë një kohëzgjatje prej 12 muajsh dhe përfshin: - Përgatitja e vendit për thertoren; - Përgatitja e projektit teknik; - Aplikim për Fonde (Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave); - Implementim dhe ndërtim i thertores; - Promovim i thertores, krijim marrëdhëniesh me biznese dhe fermerë.

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	<p>Projekti ka nevojë për një miratim nga Komisioni i Sigurisë Ushqimore dhe Instituti i Higjienës në lidhje me standartet e ndërtimit.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim 	<p>Projekti është në fazë koncepti. Disa nga masat paraprake përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekti teknik; - “Networking”; - Promovim; - Aplikim për fonde.
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	<p>N/A</p>

PROJEKT 7	
• Titulli i projektit	Promovimi dhe Brandimi i Bashkisë Belsh
• Tipi i Projektit	Marketim / Zhvillimi Ekonomik
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Belsh
• Buxheti total i projektit	750,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 50% Donacione të tjera të mundshme
• Përshkrimi i projektit	<p>Zona e Belshit ka një produktivitet të madh në duhan, vreshtari dhe ullinj. Gjithashtu ajo zotëron potenciale të mëdha natyrore e peizazhis-tike. Promovimi i këtyre asetëve dhe rritja e vizitorëve do të ndihmojë në qëndrueshmërinë e projektit. Gjithashtu do të ketë dhe një tarifë sim-bolike nga bizneset, të cilat do të përfitojnë reklamim/ promovim.</p> <p>Projekti synon rritjen e vizibilitetit të Bashkisë Belsh dhe promovimit të potencialeve. Ai përbëhet nga disa hallka të lidhura me njëra tjetrën, si krijimi i një “marke” të dedikuar për Belshin. Projekti do të shoqërohet edhe me krijimin e një faqeje interneti për komunikimin me publikun, vizitorët dhe promovimin e potencialeve e aktiviteteve që zhvillohen në Belsh. Gjithashtu do të krijohet edhe një kalendar aktiviteteve me synim promovimin e Belshit, bazuar në vizionin dhe prioritetet e ngritura në Planin Operacional për Zhvillimin Lokal. Do të prodhohen edhe brosh-ura, materiale informative, dhe do të vendosen tabela informuese për potencialet e Bashkisë.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<p>Qëllimi i projektit është promovimi i potencialeve të Bashkisë Belsh. Objektivat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i një brand (markë) për Bashkinë Belsh; - Promovimi i produkteve bujqësore dhe potencialeve për agro-turizëm; - Promovimi i potencialeve natyrore; - Krijimi i një kalendari aktiviteteve me fokus promovimin e potencialeve të Belshit; - Rritjen e numrit të të punësuarve në shërbim të fushave të ndryshme të brandimit, sidomos integrimin e të rinjve dhe grave.
• Rezultatet e pritshme	<p>Rezultatet e pritshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfitues janë të gjithë banorët e Bashkisë; - Rritja e numrit të vizitorëve; - Rritja e vizibilitetit të potencialeve dhe tërheqja e investitorëve ; - Promovimi i Bashkisë në nivel kombëtar e ndërkombëtar; - Punësim dhe integrim më i madh i të rinjve dhe grave.
• Rendi prioritar	6 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Ky projekt është një ndër masat e buta, të cilat duhen marrë për zhvillimin ekonomik të Bashkisë. Ai është i ndërlidhur me projektet e tjera në funksion të bujqësisë, zhvillimit rural e zhvillimit ekonomik të Bashkisë Belsh.

	Gjithashtu, promovimi i potencialeve natyrore, kulturore e historike rrit vetëdijen e banorëve për rëndësinë e tyre si dhe ndihmon në mbrojtjen e tyre nga dëmtimi.
<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e projektit 	<p>Projekti do të ketë një kohëzgjatje prej 6 muajsh dhe përfshin aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i një logoje për brandimin e Bashkisë Belsh; - Krijimi i databazës për potencialet natyrore, kulturore, historike e peizazhistike; - Krijimi i një liste aktivitetesh promovuese si panaire, festivale, konferenca, seminare; - Krijimi i faqes elektronike që ofron informacionin për promo-vimin e Bashkisë; - Inventarizim i Potencialeve Natyrore; - Inventarizim i Aseteve Historiko-Kulturore; - Inventarizim i Fermave; - Inventarizim i Bujtinave dhe Vendeve të Akomodimit; - Kalendar i aktiviteteve si panaire dhe festa lokale; - Ndërtimi i faqes së internetit; - Hartimi i broshurave; - Faqe në rrjetet sociale si facebook, twitter etj.
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	N/A
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim 	Projekti është në fazë koncepti, gjithësesi mund të kalojë në fazë zbatimi shumë shpejt. Disa nga hapat lidhet me krijimin e databazave për sa i përket aktiviteteve, pasurive kulturore e historike si dhe elementëve të fortë natyrorë.
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	N/A

PROJEKT 8	
• Titulli i projektit	Krijimi i Itinerarit Turistik/Natyror të Liqeneve të Belshit
• Tipi i Projektit	Zhvillim ekonomik/ infrastrukture/turizëm
• Vendndodhja e projektit	Belsh
• Buxheti total i projektit	7,500,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- fondi i infrastrukturës vendore, USAID, GIZ, ADA, ADF, SIDA etj.
• Përshkrimi i projektit	<p>Në Bashkinë Belsh janë gjithsej 84 liqene karstike. Një element që ka ulur atraktivitetin përreth këtyre liqeneve, është mungesa e aksesueshërisë së drejtpërdrejtë, mungesa e shërbimeve mbështetëse të turizmit, si dhe mungesa e kujdesit ndaj ndotjes së tyre.</p> <p>Projekti synon që të ndërlihdë liqenet me anë të një itinerari me impakt sa më të ulët në mjedis, kryesisht me rrugëkalimi këmbësore dhe për pedalim. Ndër elementët që duhen për krijimin e itinerarit janë ofrimi i shërbimeve shtesë, siç janë përcaktimi i disa qendrave kamping-u me rulo ose çadër, përcaktimi i disa vendeve me interes turistik, dhe përcaktimi i rrugëve natyrore të kalimit. Ndër të tjera ky projekt përveç se do të lidhë liqenet më njëri-tjetrin, do të krijojë në të njëjtën kohë itinerare për lidhjen e të gjitha nënnjësiteve brenda Bashkisë së Belsit, si dhe do të sjellë zhvillimin e mjaft bizneseve të lidhura më turizmin peizazhistik dhe agro-turizmin. Përgjatë itinerarit do të vendosen 2 kampingje për rulo, makina dhe çadra.</p> <p>Projekti është mjaft i rëndësishëm gjithashtu sepse synon në vetve edhe rritjen e punësimit në zonë, sidomos tek të rinjtë dhe gratë, duke qenë se baza e punësimit përgjatë këtij itinerari do të lidhet ngushtësisht me bujqësinë/blegtorinë dhe turizmin natyror. Të rinjtë dhe gratë mund të jenë aktorët kryesorë për të aktivizuar të gjitha aktivitetet përgjatë këtij itinerari turistik, duke shërbyer në të njëjtën kohë edhe si “ciceronë” dhe shoqërues të tursitëve nëpër atraksionet e ndryshme. Sidomos gjatë sezonit të verës itinerari mund të shndërrohet si një burim punësimi dhe trajnimi për mjaft të rinj dhe gra, nga pjesë të ndryshme të Bashkisë dhe rajonit përreth.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<ul style="list-style-type: none"> - Aksesueshmëri më e mirë me anë të itinerareve natyrore të liqeneve; - Rritja e turizmit natyror dhe liqenor në zonë; - Rritje e punësimit, sidomos tek të rinjtë dhe gratë.
• Rezultatet e pritshme	Përfitues të hartimit të këtij projekti janë banorët e zonës (sidomos të rinjtë dhe gratë që do të kenë prioritet në punësim), bizneset e vogla, dhe shërbimet turistike. Promovimi i Bashkisë në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

• Rendi prioritar	7 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i ndërlidhur me një sërë hapash dhe politikash të ndjekura nga Bashkia për promovimin e turizmit, të tilla si promovimi dhe brandimi, mbështetja e agro-turizmit, trajnimi i guidave turistike dhe ndërtimi i zonave të kampingut.
• Aktivitetet e projektit	Për realizimin e projektit do të duhen 16 muaj. Hapat e realizimit përfshijnë: - Dizenjimin e hartës së itinerarit; - Vendosjen e tabelave dhe sinjalistikës përkatëse; - Zhvillimi i itinerarit me shërbime plotësuese; - Identifikimi i bujtinave dhe shtëpive pritëse; - Zhvillimi i dy zonave të kampingut; - Aplikim për fonde pranë FZHR (Ministria e Zhvillimit Urban).
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Hartimi i projektit do të shoqërohet me hartimin e një VNM-je. Në vetvete krijimi i itinerarit turistik liqenor, synon aktivizimin e të gjitha zonave me atraksion turistik përreth liqeneve, duke rritur në këtë mënyrë aktivitetin në këto zona. Rrjedhimisht duhen marë masa për të siguruar aktivitet të plotë e të sigurtë, por në të njëjtën kohë duke ruajtur qëndrueshmërinë mjedisore, pa dëmtuar habitatet natyrore dhe duke i mbajtur pastër ato. Hartimi i VNM-së që do të shoqërojë hartimin e plotë të projektit, do të japë të gjitha këto detaje në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të këtij itinerari turistik.
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazë koncepti. Është e nevojshme që fillimisht të përgatitet një databazë mbi rrugët e mundshme të kalimit për këmbësorë dhe biçikleta për ndërlidhjen e liqeneve. Më pas të përcaktohet projek-ti/plani i detajuar, ku të parashikohen dhe shërbimet. Në fund të ap-likohet për fonde dhe të promovohet si itinerar turistik natyror. Projekti mund të zhvillohet si një i tërë, ose në faza në varësi të fondeve. Fazat mund të jenë si më poshtë: - Faza 1: Krijimi i infrastrukturës rrugore për këmbësorë dhe biçikleta dhe vendosja e sinjalistikës përkatëse; - Faza 2: Identifikimi i bujtinave dhe zonave kryesore bujqësore/blegatorale, me rëndësi për agro-turizmin; - Faza 3: Ngritja e zonave të kampimit.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

Figura 14: Skema për Krijimin e Fondit të Turizmit (bashkangjitur në Aneks-in 2)

PROJEKT 9	
• Titulli i projektit	Ngritja e Bujtinave Pritëse, shërbyese të Agro-Turizmit
• Tipi i Projektit	Zhvillim ekonomik/ infrastrukturë/turizëm
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Belsh
• Buxheti total i projektit	5,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 5% Familjet, strukturat e të cilave do të përdoren: 5% Donacione të tjera të mundshme: USAID, GIZ, ADA, ADF, SIDA, AKT, ATA etj.
• Përshkrimi i projektit	<p>Projekti konsiston në identifikimin e hapësirave, të cilat do të mund të kthehen në bujtina dhe ambiente në shërbim të agro-turizmit. Bujtinat do të përdorin kryesisht prodhimtarinë bio-vendase, e cila është një aset për t'u vlerësuar. Gjithashtu projekti do jetë pjesë e paketave turistike, të cilat do të krijojnë lehtësira dhe mundësi të mira për zhvillimin e turizmit në zonë.</p> <p>Projekti do të kontribuojë në përmirësimin dhe rritjen e nivelit ekonomik të zonave rurale. Bujtinat do shërbejnë si model për hapjen e bizneseve të ngjashme në pjesë të ndryshme të territorit të Bashkisë Belsh. Fillimisht projekti do të konsistojë në krijimin e 4 bujtinave. Do të trajnohen familjet pritëse, si dhe stafi shtesë, si dhe do të ofrohet ndihmë në përmirësimin e kushteve të banesave për të operuar si bujtina. Ky projekt bazohet në një sërë modelesh të mira të zhvilluara në Shqipëri në zonat malore si Thethi, apo edhe Puka.</p> <p>Përmes këtij projekti synohet të rritet edhe numri i të rinjve dhe grave që do të përfshihen, për të rritur në këtë mënyrë punësimin e këtyre grupeve, si dhe për të rritur gjithëpërfshirjen e tyre në ekonomi dhe jetën sociale.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i turizmit, sidomos në zonat rurale; - Lidhja e zhvillimit të bujqësisë e blegtorisë me agro-turizmin; - Përfshirja e fermerëve në ngritjen dhe menaxhimin e bujtinave; - Ndërtimi i një marrëdhënieje të shëndoshë midis Bashkisë, do-natorëve të mundshëm dhe fermerëve e familjeve pritëse; - Rritje e punësimit, sidomos tek të rinjtë dhe gratë.
• Rezultatet e pritshme	Përfitues të hartimit të këtij projekti janë fillimisht banorët e 4 familjeve, me të cilat do të nisë projekti, Bashkia, si dhe të gjithë turistët që do të akomodohen pranë këtyre bujtinave. Përmes këtij projekti pritet jo vetëm rritje ekonomike e familjeve/fermerëve të përfshirë në projekt, por mbi të gjitha do të kontribuohet në përmirësimin e imazhit të Bashkisë përsa i përket zhvillimit të turizmit. Gjithashtu projekti do të stimulojë përmirësimin e infrastrukturës akomoduese të turizmit, duke nxitur kështu zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Me arritjen e suksesit të 4 rasteve të para, projekti mund të aplikohet edhe në raste të tjera, duke krijuar një kulturë e traditë të bujtinave në Bashkinë e Belshit.

• Rendi prioritar	7 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i ndërlidhur me një sërë hapash dhe politikash të ndjekura nga Bashkia për promovimin e turizmit, të tilla si promovimi dhe brandimi, mbështetja e agro-turizmit, trajnimi i guidave turistike dhe ngritja e bujtinave pritëse.
• Aktivitetet e projektit	Për realizimin e projektit do të duhen 12 muaj. Hapat e realizimit përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhjen e 4 familjeve/ fermerëve; - Dakortësimin me 4 familjet/ fermerët; - Gjetjen e donatorëve të tjerë të mundshëm (përmendur më sipër disa prej tyre); - Incentivimin e familjeve/ fermerëve për të krijuar bujtinat; - Ngritja e kushteve të përshtatshme pranë bujtinave, sigurimi i cilësisë dhe standardeve; - Përfshirja e bujtinave në itineraret turistike, si dhe guidat e Bashkisë së Belshit; - Promovimi i bujtinave; - Ngritja e një sistemi për menaxhimin e bujtinave, që do të bëjë kontrollin e cilësisë dhe kualifikimin e objekteve/ fermave që do të duan të shndërrohen në bujtina në të ardhme.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazë koncepti. Është e nevojshme që fillimisht të përzgjidhen 4 familjet e para ku do të bëhet aplikimi i projektit, dhe të përcaktohen standartet e kushteve dhe hapësirave të nevojshme. Më pas të përcaktohet projekti/plani i detajuar, ku të parashikohen dhe shërbimet. Në fund të shihen mundësitë për gjetjen e donatorëve të mundshëm dhe të promovohet në itineraret dhe potencialet turistike të Bashkisë. Projekti mund të zhvillohet si një i tërë, ose në faza në varësi të fondeve.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

INFRASTRUKTURA RRUGORE

PROJEKT 10	
• Titulli i projektit	Asfaltimi i Rrugës Belsh-Kajan-Dragot
• Tipi i Projektit	Infrastrukturë
• Vendndodhja e projektit	Aksi rrugor Belsh-Kajan-Dragot
• Buxheti total i projektit	35,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore
• Përshkrimi i projektit	Projekti konsiston në asfaltimi e rrugës Belsh-Kajan-Dragot. Është një ndër rrugët lidhëse më të rëndësishme në zonën e Belshit. Rruga kalon në mes të bashkisë dhe është e rëndësishme për rritjen e aksesueshmërisë. Rruga ka filluar dhe ekziston projekti, por nuk është përfunduar. Ka mbaruar shtrimi dhe stabilizimi i saj në disa pjesë, por si rrjedhojë e mos përfundimit ka nevojë të vlerësohet dhe përmirësohet stabilizimi i saj. Në fund më pas do të asfaltohet. Gjithsej do të asfaltohen 12 km rrugë
• Qëllimi dhe objektivat	- Rritja e aksesueshmërisë në Belsh; - Asfaltimi i 12 km rrugë rurale; - Integrimi i zonave rurale me akset kryesore dhe qendrat krye-sore të banuara.
• Rezultatet e pritshme	- Numri i përfituesve nga asfaltimi i këtij segmentin rrugor parashikohet të jetë rreth 10,000 individë, banorë të zonave përreth; - Ky aks gjithashtu shërben për të lidhur më mirë Kajanin si një ndër njësitë administrative kryesore me Belshin.
• Rendi prioritar	8 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i qëndrueshëm sepse synon të rrisë aksesueshmërinë në mënyrë të konsiderueshme. Gjithashtu, është i ndërlidhur dhe i shërben edhe një sërë masave të tjera, të cilat Bashkia do të marrë në lidhje me zhvillimin e turizmit, bujqësisë dhe transportit.
• Aktivitetet e projektit	Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje jo më të madhe se 12 muaj, duke qënë se një pjesë e konsiderueshme e punimeve janë kryer në vitet e mëparshme. Aktivitetet përfshijnë: - Studimin e situatës së rrugës pas investimit fillestar; - Aplikimin për fonde; - Asfaltimin e rrugës.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Projekti duhet të shoqërohet me VNM. Duhet të tregohet kujdes në mën-janimin e zonave sensitive. Segmenti rrugor duhet të ketë në të dy krahët gjelbërim për të evituar zhvillimin e bizneseve dhe shpërhapjen urbane në krahët, si dhe për të ndaluar ndotjet e mundshme të zonave përreth.

<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim 	<p>Projekti është i gatshëm për zbatim. Ekziston një projekt fillestar. Duhet të kryhet një vlerësim paraprak për të parë kushtet aktuale të rrugës pas investimit fillestar.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	<p>Ky projekt është një ndër premtimet elektorale kryesore të Kryetarit të Bashkisë gjatë fushatës për zgjedhjet vendore.</p>

PROJEKT 11	
• Titulli i projektit	Ngritja e vendqëndrimit të mjeteve të transportit të pasagjerëve (autobuza, minibuset, stacioni treni)
• Tipi i Projektit	Infrastrukturë
• Vendndodhja e projektit	Pranë Postës së Qytetit Belsh
• Buxheti total i projektit	5,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 5% Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore
• Përshkrimi i projektit	Projekti konsiston në ndërtimi dhe rregullimin e një vendqëndrimi për mjetet e transportit të pasagjerëve në nivel ndër-qytetas dhe brenda njësive administrative të Bashkisë. Aktualisht janë dy pika në të cilat pozicionohen mjetet e transportit, të cilat shkaktojnë konfuzion dhe trafik të panevojshëm në zonë. Vendqëndrimi do të unifikohet në një të vetëm, pranë Postës së Qytetit të Belshit. Ky vendqëndrim do të pajiset edhe me infrastrukturën e nevojshme për informacionin e nevojshëm në lidhje me oraret e nisjeve dhe biletarinë.
• Qëllimi dhe objektivat	- Rregullim i trafikut dhe i ndërlidhjes në Bashkinë Belsh; - Lehtësi në transportin ndërqytetas; - Sistem i qartë qarkullimi i pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme.
• Rezultatet e pritshme	- Reduktim i trafikut në Belsh; - Informacion i qartë për udhëtarët; - Thjeshtëzim dhe formalizim i transportit ndërqytetas; - Lehtësi në qarkullimin ndërqytetas, dhe rritje e lëvizshmërisë nëpër territorin e Bashkisë; - Përfitues të këtij projekti do të jenë të gjithë banorët e Bashkisë Belsh.
• Rendi prioritar	8 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i qëndrueshëm dhe lidhet me një sërë iniciativash të tjera, të cilat do të ndërmerren nga Bashkia, si në kuadër të Planit Operacional për Zhvillimin Lokal, ashtu edhe në kuadër të zhvillimeve të mëvonshme për Planifikimin e Territorit. Këtu mund të përmendim edhe projekte si ai për rigjenerimin e liqenit të Belshit, përmirësimin e aksesueshmërisë dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe vizitorëve.
• Aktivitetet e projektit	Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 12 muajsh dhe përfshin disa aktivitete: - Përgatitjen e projektit të detajuar; - Aplikimin për fonde; - Implementimin e projektit.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A

<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim 	<p>Projekti është ne fazë koncepti. Për këtë është e nevojshme që të përgatitet projekti i detajuar teknik dhe më pas të aplikohet për fonde.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	<p>N/A</p>

PROJEKT 12	
• Titulli i projektit	Krijimi i Unazës Rrugore të qytetit të Belshit
• Tipi i Projektit	Infrastrukturë
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Belsh / qytet Belsh
• Buxheti total i projektit	28,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore
• Përshkrimi i projektit	<p>Aktualisht të gjitha mjetet që udhëtojnë në drejtim të Belshit me orientim Veri-Jug dhe Lindje-Perëndim kalojnë në mes të qytetit. Kjo gjë shkaton shpesh trafik dhe ndotje të ajrit. Në disa raste ka edhe mjete të tonazhit të rëndë, të cilat janë të detyruara të kalojnë në mes të qendrës urbane në mënyrë që të vazhdojnë më pas për në destinacionin e tyre. Projekti konsiston në ndërtimi e një unaze rrugore në qytetin e Belshit, e cila do të mënjanojë trafikun nga qendra e qytetit në formën e një by-pass-i. Unaza do të ndahet në dy faza:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së pari do të ndërtohet unaza veriore e qytetit të Belshit. Për këtë Bashkia disponon një projekt të detajuar dhe të gatshëm për zbatim; - Së dyti do të ndërtohet pjesa e dytë dhe e fundit e unazës, e cila do të kalojë mbi “Lagjen e Tafaëve” dhe do të ketë një gjatësi prej 2 km. <p>Unaza duhet të ketë në të dy krahët e saj gjelbërim për të evituar zhvillimin e bizneseve dhe shpërhapjen urbane në krahët e saj, si dhe për të ndaluar shpërhapjen e ndotjeve përtej saj drejt zonave të banuara, apo në drejtim të tokave bujqësore.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<ul style="list-style-type: none"> - Plotësimi i Unazave Infrastrukturore të Belshit; - Përmirësimi i sistemit të qarkullimit rrugor; - Evitimi i kalimit të automjeteve të tonzhit të rëndë në qendrën e banuar urbane; - Evitimi i ndotjeve që vijnë nga kalimet e automjeteve të tonazhit të rëndë nëpër zonat e banuara; - Sistem më i mirë infrastrukturor, që lidh zonat ekonomike më shpejt midis tyre, duke efiçentuar qarkullimin dhe evituar segmentet e panevojshme.
• Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> - Përfitues të këtij projekti janë banorët e qytetit të Belshit dhe zonave përreth, dhe bizneset kryesore që operojnë në zonë. Përmes projektit pritet të arrihet: - Një reduktim i trafikut; - Efiçentim i qarkullimit rrugor dhe sistem i plotë infrastrukturor; - Devijim i trafikut të rëndë jashtë qendrës urbane; - Reduktim i ndotjeve urbane, të ajrit dhe akustike.
• Rendi prioritar	7 / 10

<ul style="list-style-type: none"> • Qëndrueshmëria e projektit 	<p>Projekti është i qëndrueshëm, sepse së pari kërkon të plotësojë sistemin e infrastrukturës rugore shërbyese për Bashkinë Belsh, duke evituar futjen e automjeteve të tonazhit të rëndë në qendrën urbane të Bashkisë, dhe së dyti sepse përmes këtij projekti synohet të ulen ndotjet e shkaktuara</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e projektit 	<p>Kohëzgjatja e projektit parashikohet të jetë pre 24 muajsh. Projekti do të ndahet në dy faza dhe parashikon këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faza 1 implmentimi i unazës veriore të qytetit të Belshit; - Faza 2, përgatitja e projektit për unazën lindore; - Aplikimi për fonde; - Implementimi i projektit.
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	<p>Projekti duhet të shoqërohet me VNM. Duhet të tregohet kujdes në mën-janimin e zonave sensitive. Unaza duhet të ketë në të dy krahët e saj gjelbërim për të evituar zhvillimin e bizneseve dhe shpërhapjen urbane në krahët e saj.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim 	<p>Faza e 1- Unaza Veriore është e gatshme dhe Bashkia e disponon si pro-jekt. Faza 2- duhet hartuar projekti i detajuar</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	<p>N/A</p>

PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

PROJEKT 13

• Titulli i projektit	Përmirësimi i cilësisë së Shkollave të mesme
• Tipi i Projektit	Shërbime/ Arsim
• Vendndodhja e projektit	Belsh
• Buxheti total i projektit	9,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve-Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar
• Përshkrimi i projektit	<p>Cilësia e shkollave të mesme në Belsh është e dobët. Ndërtesat janë të amortizuara dhe nuk ofrojnë një ambjent të përshtatshëm për mësim-dhënie. Strukturat janë të vjetëruara dhe kanë mangësi në izolim e ter-mo-izolim, duke rritur mjaft kostot e përdorimit të mjeteve alternative për të siguruar kushtet e përshtatshme gjatë periudhës së pikut në verë dhe dimër.</p> <p>Gjithashtu mungojnë dhe mjetet teknologjike si laboratore apo kompjutera. Për këtë arsye është e rëndësishme që të përmirësohet situ-ata në mënyrë që të rritet interesi i nxënësve për shkollën si dhe për të vijuar më tej me formimin e tyre akademik.</p> <p>Projekti konsiston në përmirësimin e godinave të dy shkollave të mesme në Bashkinë Belsh. Secila prej tyre do të marrë funksione shtesë dhe njëra prej tyre do të shërbejë edhe si qendër komunitare për Njësinë Adminis-trative të Belshit. Qëllimi i kësaj qendre komunitare do të jetë ofrimi i tra-jnimeve dhe konsultimi i grave në zonat rurale. Gjithashtu aty do të ketë edhe kurse dhe trajnime jashtë-shkollore për të rinjtë. Shkollat do të ofrojnë dhe ambiente sportive.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i cilësisë së shkollave të mesme; - Shkollat si qendra komunitare; - Nxitja e arsimit tek fëmijët e këtyre zonave.
• Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit e shkollave të mesme (gjithsej rreth 300 nxënës). - Kushte më të mira dhe performance më e mirë nga nxënësit dhe mësuesit e këtyre shkollave; - Gratë si përfituese të shërbimeve të qendrës komunitare; - Rritje e numrit të nxënësve që ndjekin shkollën e mesme.
• Rendi prioritar	7 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Rikonstruksioni i shkollave të mesme do të shoqërohet me implementi-min dhe preza-timin e teknikave bashkëkohore të efijencës energjitike, qoftë në termoizolim, ashtu edhe në pajisjet e ndriçimit dhe kushtet e kondicionimit. Këto do të rrisin qëndrueshmërinë e projektit në terma afatgjatë, dhe do të bëjnë më efijent investimin.

	Gjithashtu aktivizimi i një shkolle edhe si qendër komunitare do të ketë një ndikim pozitiv dhe në mirëmbajtjen e ambienteve të saj. Ndër të tjera qendra do të shërbejë për sensibilizimin e familjeve për të nxitur fëmijët në vazhdimin e formimit të tyre edukativ.
<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e projektit 	<p>Koha e duhur për realizimin e kërrij projekti është 36 muaj dhe përshin fazat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Faza 1: <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i projektit të detajuar - Rikonstruksion i shkollës dhe konvertim në qendër për komunitetin • Faza 2: <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitje e projektit të detajuar - Rikonstruksion i shkollës së dytë
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	N/A
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim 	Projekti është në fazë ideje. Është e nevojshme që paraprakisht të përzgjidhen dy shkolla të mesme dhe më pas të zhvillohen projektet teknike.
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	N/A

PROJEKT 14	
• Titulli i projektit	Përmirësimi i cilësisë së ambjeteve të ambulancave
• Tipi i Projektit	Shërbime/ Shëndetësi
• Vendndodhja e projektit	Qendra Shëndetësore në Rrasë; Fierzë; Kajan; Grekan; Belsh.
• Buxheti total i projektit	50,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve-Granti konkurrues për shëndetësinë
• Përshkrimi i projektit	<p>SSituata e ndërtesave të qendrave shëndetësore në Bashkinë Belsh është e dobët. Shumë prej tyre janë të amortizuara dhe në nevojë për rikon-struksion. Gjithashtu, edhe përsa i përket pajisjeve, konstatuar edhe nga vizitat në terren, vërehet që ka mjaft mangësi. Projekti konsiston në përmirësimin e godinave të qendrave shëndetësore në Njësitë Administrative kryesore të Bashkisë Belsh.</p> <p>Projekti është i ndarë në disa faza dhe secila fazë konsiston me përmirësimin e cilësisë së një qendre. Përtej përmirësimit të aspektit fizik të ndërtesave e rëndësishme është që të plotësohen edhe me pajisje të specializuara. Një ndër to është evidentuar aparati për mamografinë i cili duhet të vendoset në qendrën shëndetësore në qytetin e Belshit. Ky aparat është tejet i rëndësishëm duke parë rrezikun e lartë të kancerit tek gratë. Përtej aparatit, në qendrën shëndetësore duhet të ngrihen dhe strukturat për të këshilluar në lidhje me rreziqet e sëmundjeve dhe kuj-desin shëndetësor veçanërisht tek nënat e reja.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit shëndetësor; - Plotësimi me pajisje për kontrollin shëndetësor; - Përmirësim i kushteve të ndërtesave të qendrave shëndetësore; - Plotësimi me staf të specializuar në fusha të ndryshme.
• Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> - Përfitues të projektit janë të gjithë banorët e Belshit - Kushte të përshatshme dhe ftuese sidomos për të rinjtë dhe gratë (në veçanti nënat e reja, apo ato me probleme); - Kujdes dedikuar edhe të moshuarve.
• Rendi prioritar	9 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i qëndrueshëm dhe lidhet me një sërë masash të tjera në terma afatgjatë, të cilat do të ndërmarrë Bashkia më tej në implementimin e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal, por edhe me nisjen e iniciativës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor. Gjithashtu, Bashkia do të sigurojë masat e nevojshme dhe të përshtatshme për mirëmbajtjen e këtyre infrastrukturave.
• Aktivitetet e projektit	Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 36 muajsh. Ai mund të aplikohet në faza, çdo ndërhyrje hap pas hapi, ose si një i tërë.

• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazën e konceptit. Është e nevojshme që të hartohet projekti i detajuar, si përsa i përket rikonstruksionit të ndërtesave, ashtu dhe përsa i përket nevojës për plotësim me materiale dhe staf të kualifikuar.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

MIRËQËNIA SOCIALE DHE EKONOMIKE

PROJEKT 15

• Titulli i projektit	Ngritja e Zyrës së Punës në Belsh
• Tipi i Projektit	Social
• Vendndodhja e projektit	Qëndër Belsh, Pronë Shtetërore, brenda strukturës së Bashkisë Belsh
• Buxheti total i projektit	700,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 100%
• Përshkrimi i projektit	<p>Bashkia Belsh ka një përqindje të lartë papunësie, veçanërisht tek të rinjtë (...%) dhe tek grate (...%). Kjo vjen deri diku si rrjedhojë e mbështetjes së ekonomisë vendase, kryesisht në sektorin bujqësor ndërkohë që sektorët e tjerë të shërbimeve dhe industrisë janë shumë të vegjël për të gjeneruar punësim për të gjithë.</p> <p>Për këtë arsye, ky projekt konsiston në hapjen e zyrës së punës në Bashkinë Belsh. Zyra e punës do të jetë brenda ndërtesës së Bashkisë. Fondi i parashikuar shërben për përgatitjen e ambjenteve të zyrës dhe bazën materiale për funksionimin e saj. Zyra duhet të ketë një staf prej 3-5 veta dhe përtej regjistrimit të të papunëve duhet të shërbejë si urë lidhëse midis biznesit dhe qytetarit.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<p>Qëllimi i përgjithshëm i projektit është hapja e një zyre pune në Bashkinë Belsh. Ky projekt ka si objektiva:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Uljen e nr. të papunësisë tek të rinjtë; - Uljen e nr. të papunësisë tek grate; - Ndërlidhjen midis punëdhënësve dhe punëmarrësve; - Rritjen e aftësive/trajnimin e qytetarëve në bazë të kërkesave të tregut; - Ofrimin e kurseve profesionale për grupe në nevojë si të rinj, të reja dhe gra të papuna.
• Rezultatet e pritshme	<p>Rezultatet e pritshme të aplikimit do të përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10,000 përfutues të drejtëpërdrejtë dhe jo të drejtëpërdrejtë, të ndarë sipas gjinisë; - Këshillim karriere për mbi 1,000 nxënës të shkollave të mesme të ndarë sipas gjinisë; - Këshillim karriere dhe trajnim për të rinj të papunë, të ndarë si-pas gjinisë; - Këshillim dhe trajnim për grate e papuna.
• Rendi prioritar	8 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	<p>Projekti lidhet me një sërë masash të tjera nga pikëpamja sociale si dhe për përmirësimin e shërbimeve publike. Ky projekt do të jetë i qëndrueshëm në momentin që aktivitetet lidhen ngushtësisht edhe me Qendrën Kulturore. Projekti synon jo vetëm gjetjen e mundësive për punësim nga zyra e punës, por dhe kurse të trajnimit profesional të të papunëve me qëllim aftësimin e tyre për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut. Ofrimi i kurseve profesionale do të afrojë më shumë qytetarët e papunë (të ndarë sipas gjinisë) me punëdhënësit potencialë.</p>

<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e projektit 	<p>Projekti ka një kohëzgjatje prej 12 muajsh dhe përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi në vendit të zyrës; - Rregullimin e ambienteve të punës dhe plotësimin me material; - Gjetjen dhe trajnimin e stafit; - Krijimin e lidhjeve strategjike me Bizneset lokale; - Organizimin e eventeve trajnuese dhe “networking” midis punëdhënës-punëmarrës; - Organizimin e trajnimeve në bazë të nevojave lokale.
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	<p>N/A</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim 	<p>Projekti është ende në fazën e konceptit. Duhet që bashkia të përcaktojë vendin për zyrën, (Brenda në Bashki), plotësimin e zyrës me staf, plotësimin e zyrës me materiale pune dhe ambiente pritjeje të qytetarëve.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	<p>N/A</p>

PROJEKT 16	
• Titulli i projektit	Zhvillimi i Qendrës Multifunkionale Belsh
• Tipi i Projektit	Shërbime/ Sociale
• Vendndodhja e projektit	Ish-Mapo në qytetin Belsh
• Buxheti total i projektit	25,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar
• Përshkrimi i projektit	<p>Gjatë vizitave në terren dhe intervistave me banorë të ndryshëm të Belshit, dallohet qartë që në zonë ka një mungesë të theksuar të aktiviteteve. Kjo gjë vjen si rrjedhojë e ambienteve jo të përshtatshme të Qendrës Kulturore dhe mangësive organizative të aktiviteteve. Ndërkohë, ka një numër të lartë të papunësisë tek të rinjtë, dhe një segregim të lartë të grave nga aktivitetet social-kulturore.</p> <p>Për këtë arsye, projekti synon zhvillimin e një Qendre Multifunkionale Kulturore në qytetin e Belshit, e cila do t'i shërbejë të gjithë qytetarëve, por me një fokus të vecantë tek tek të rinjtë dhe gjinia femërore. Për këtë projekt do të përdoret ndërtesa e ish-Mapos, e cila duhet fillimisht të rikonstruktohet dhe më pas të zgjerohet sipërfaqja, në mënyrë që të akomodojë të gjitha aktivitetet e parashikuara.</p> <p>Qendra Multifunkionale Kulturore duhet të ketë ambiente të ndryshme për të akomoduar një sërë aktiviteteve, Aty mund të krijohen kushtet që të zhvillohen lojëra të ndryshme si: shah, volejball, basketboll, balet; si dhe kurse gjuhësh të huaja, kinema në sallë të vogël, sallë për shfaqje, sallë biblioteke, sallë për muze, salla/klasa të një madhësie më të vogël për trajnime dhe kurse të tilla si muzikë, vizatim/pikturë, IT, zhvillim biznesi etj.</p> <p>Mund të shfrytëzohen shumë mirë si ambientet e brendshme, ashtu dhe ato të jashtme për gjenerimin e këtyre aktiviteteve shumë socializuese për të rinjtë, duke nxitur njëkohësisht edhe aktivizimin dhe integrimin më të madh të gjinisë femërore.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e aktiviteteve social-kulturore në Bashkinë Belsh; - Përmirësim i kushteve për zhvillimin e aktiviteteve social-kulturore në Belsh.
• Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> - Përfituesit kryesorë janë banorët e Bashkisë Belsh, por edhe të njësive të tjera administrative; - Rritja e angazhimit të të rinjve në jetën social-kulturore; - Integrim më i madh i gjinisë femërore në jetën social-kulturore; - Trajnime dhe mundësi për zhvillimin e kapitalit social; - Gjenerim idesh dhe “start-up”;

	- Zhvillim aktiviteteve social kulturore.
• Rendi prioritar	7 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i ndërlidhur me një sërë masash që ndërmerr bashkia. Gjithashtu, projektet e parashikuara në POZHL ndërtojnë mbi njëri tjetrin dhe janë të ndërlidhur edhe me Qendrën Multifunksionale Kulturore. Bashkia do të ngrejë strukturat administrative për drejtimin e kësaj qendre, si dhe do të akordojë fondet për mirëmbajtjen e saj.
• Aktivitetet e projektit	Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 20 muajsh. Në të para-shikohen: - Përgatitja e projektit teknik; - Rikonstruksioni dhe krijimi i hapësirave të përshtatshme në ambientet e ish-Mapos; - Plotësimi me bazën materiale; - Promovimi dhe zhvillimi i aktiviteteve gjithë-vjetorë.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N/A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti është në fazë koncepti. Është e nevojshme që të përgatitet një projekt i detajuar për implementim dhe më pas të gjenden fondet. Gjithashtu, duhen krijuar marrëdhënie me OJF, programe ndërkombëtare, ministri, agjenci në mënyrë që të ngrihen disa marrëveshje, të cilat do të ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve për drejtimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në qendër.
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

PROJEKT 17	
• Titulli i projektit	Qendra Rinore Dëshiran
• Tipi i Projektit	Shërbime/ Sociale
• Vendndodhja e projektit	Ish-Mapo në qytetin Belsh
• Buxheti total i projektit	15,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 10% Donacione të tjera të mundshme: FZHR- Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar
• Përshkrimi i projektit	<p>Projekti konsiston në hapjen një Qendre Rinore në fshatin Dëshiran. Ky është një ndër fshatrat më të mëdhenj të Bashkisë, me një numër të kon-siderueshëm banorësh. Momentalisht në këtë fshat ka një ndërtesë ekzistuese, e cila nuk është në përdorim dhe ndodhet në kushte shumë të këqija. Me anë të ndërhyr-jeve rikonstruktuese kjo ndërtesë mund të shndërrohet në një pol të rëndësishëm kulturor me fokus të rinjtë e kësaj Njësie Administrative.</p> <p>Si në të gjithë Bashkinë, edhe në këtë Njësi të rinjtë kanë shumë pak ak-tivitete, me të cilat mund të merren jashtë aktiviteteve shkollore. Për këto arsye shpesh ato përfundojnë duke u marrë me bujqësi, ose me aktivite-te të tjera jo-edukative.</p> <p>Krijimi i Qendrës Rinore në këtë Njësi synon ofrimin e mundësive për të rinjtë në zona rurale, për t'u marrë me aktivitete të ndryshme. Qendra mund të përfshijë kurse për muzikë, art, gjuhë të huaja, IT, aktrim etj. Aktivizimi i kësaj Qendre ka si synim edhe ngritjen e kapitalit shoqëror dhe rritjen e interesit të të rinjve edhe në fusha të tjera. Kjo gjë do të shtojë dhe dëshirën më pas për të vijuar me studime të larta.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e aktiviteteve social-kulturore në Belsh; - Përmirësim i mbështetjes ndaj të rinjve; - Ngritja e kapitalit social dhe aktivizimi i tij.
• Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i përfituesve është rreth 500 të rinj nxënës të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare (të ndarë sipas gjinive); - Përfitim në një edukim më të mirë dhe sensibilizim ndaj tij; - Shtim të aktiviteteve jashtë-shkollore; - Shtim të aktiviteteve social-kulturore.
• Rendi prioritar	6 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është pjesë e programit për zhvillimin social-ekonomik. Ai është i ndërlidhur dhe me projekte të tjera, të cilat synojnë rritjen e aftësive dhe ofrimin e trajnimeve për banorët.

<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e projektit 	<p>Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 12 muajsh. Parashiko-het që të zhvillohen aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekti i detajuar teknik; - Gjetje e fondeve; - Implementim i projektit; - Promovim i Qendrës Rinore.
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	<p>N/A</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim 	<p>Projekti është ende në fazën e konceptit. Është e nevojshme që fillimisht të hartohet projekti i detajuar e më pas të gjenden fondet.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	<p>N/A</p>

PROJEKT 18	
• Titulli i projektit	Ngritja e Qendrës Trajnuese / Trajnimi i Udhëheqësve të Guidave Turistike
• Tipi i Projektit	Zhvillim ekonomik/ Ngritje Kapacitetesh / Turizëm
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Belsh
• Buxheti total i projektit	500,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 50% Donacione të tjera të mundshme: USAID, GIZ, ADA, ADF, SIDA, NGO që meren me përkrahjen dhe zhvillimin e turizmit, etj.
• Përshkrimi i projektit	<p>Projekti synon që të rrisë kapacitetet vendase për të përkrahur dhe zhvilluar më tej të gjitha format e turizmit, brenda Bashkisë Belsh. Bashkia është e pasur me potenciale dhe peizazhe të rralla natyrore, objekte historike, si dhe ofron mundësi të shkëlqyera për zhvillimin e turizmit bazuar tek bujqësia, blegtoaria dhe artizanati, si në produkte artistike, ashtu edhe në ato ushqimore vendase.</p> <p>Krijimi i një strukture që merret me ngritjen e kapacitetit dhe trajnimin e të rinjve/rejave vendase për të mirëpritur zhvillimin e turizmit, është me mjaft rëndësi për Bashkinë e Belshit. Në kuadër të kësaj strukture do të dizajnohet një program i posaçëm, i cili do të lidhë (i) personat vendas që kanë të gjithë informacionin mbi territorin e Bashkisë, fermerët dhe artizanët, me (2) trajnuesit (që mund të jenë NGO, apo grupe të posaçme, që meren me ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin me qëllim zhvillimin e turizmit), dhe me (3) të rinjtë/rejat dhe të gjithë persoat e interesuar për të qenë pjesë e këtij programi.</p> <p>Krahas zhvillimit ekonomik si një qëllim parësor, Bashkia mund ta përdorë këtë strukturë dhe këtë program veçanërisht për të rritur gjithë-përfshirjen sociale dhe integrimin në shoqëri, sidomos tek grupet vul-nerabël: (1) të rinjtë / të rejat që nuk preferojnë të ndjekin shkollën; (2) gratë dhe vajzat, sidomos ato të prekura nga dhuna, apo probleme të tje- ra të ngjashme; (3) grupet Rome dhe Egjiptiane, të cilat në të shumtë e rasteve bëhen pre e segregimeve shoqërore. Duke i aftësuar këto grupe, Bashkia do t'u ketë mundësinë t'i integrojë ato në zhvillimin ekonomik të Bashkisë, duke i krijuar atyre mundësi për punësim dhe aftësim.</p> <p>Fillimisht struktura e ngritur me anë të këtij programi do të synojë të trajnojë dhe më pas integrojë 30 individë. Më tej do të synohet të rritet numri i tyre, si dhe specializimi sipas fushave të ndryshme të zhvillimit të turizmit.</p> <p>Struktura do të ketë një zyrë qendrore dhe ambiente trajnuese pranë Qendrës Rinore të Bashkisë Belsh. Kontakti me administratën e Bashkisë do të jetë i vazhdueshëm për të koordinuar dhe lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë programe të tjera dhe nevojat</p>

	emergjente, me ato që kjo qendër ofron. Qendra Multifunkionale do të jetë një bashkëpunëtoare e mirë gjithashtu.
• Qëllimi dhe objektivat	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi ekonomik duke u bazuar tek asetet humane të vetë Bashkisë; - Integrimi i të gjitha grupeve sociale në zhvillimin ekonomik; - Rritja e aksesueshmërisë së grupeve të ndryshme në aftësim për punësim dhe punësim; - Rritja e përkrahjes sidomos për grupet në nevojë: të rinjtë/rejat; gratë dhe individët e dhunuar, popullsia Rome dhe Egjiptiane;
• Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> - Përfitues të hartimit të këtij projekti janë banorët e zonës (të rinjtë/rejat; sidomos grupet në nevojë: gratë dhe vajzat e dhunuara; grupet Rome dhe Egjiptiane), bizneset e vogla, dhe shërbimet turistike; - Projekti synon të rrisë eficientimin e investimit në zhvillimin ekonomik, duke integruar kapitalin human vendas; - Aftësim të kapitalit human vendas, duke rritur interesin për të qëndruar në Bashkinë Belsh, duke ulur kështu popullsinë emigruese/migruese;
• Rendi prioritar	7 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i ndërlidhur me një sërë hapash dhe politikash të ndjekura nga Bashkia për ngritjen e kapacitetit të popullsisë vendase dhe admin-istratës, dhe promovimin e turizmit, si një nga fushat kryesore të zhvillimit ekonomik në Bashkinë Belsh.
• Aktivitetet e projektit	<p>Për realizimin e projektit do të duhen 10 muaj. Hapat e realizimit përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përpilimin e Strukturës dhe Programit Trajnues; - Gjetja e partnerëve trajnues (NGO, etj.); - Gjetja e partnerëve të tjerë vendas që do të ndihmojnë në njohjen e potencialeve dhe pasurive kryesore për zhvillimin e Turizmit në Bashkinë Belsh; - Ngritja e infrastrukturës bazë pranë Qendrës Rinore; - Pajisja me të gjitha mjetet e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit trajnues; - Promovimi i Strukturës dhe Programit trajnues në të gjithë Bashkinë Belsh; - Identifikimi i 30 personave të parë që do të bëhen pjesë e trajnimit; - Planifikimi i hapave të mëtejshme të Strukturës dhe Qendrës Trajnuese.
• Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	N / A
• Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim.	<p>Projekti është në fazë koncepti. Është e nevojshme që të përgatiten në mënyrë të detajuar Struktura dhe Programi për trajnimin, dhe më pas të përpilohet (1) një plan kohor për zhvillimin e aktivitetit, dhe (2) një plan për gjithëpërfshirjen e të gjitha grupeve të interesit të veçantë, shpjeguar edhe më sipër.</p> <p>Ambientet, në të cilat do të bëhen trajnimet janë planifikuar në kuadër të një tjetër Projekt Fiche (Qendra Rinore). Me krijimin e kësaj qendreje, ky projekt do të mund të vihet në zbatim menjëherë.</p>
• Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	N/A

MJEDISI

PROJEKT 19

• Titulli i projektit	Rehabilitimi i Liqenit të Belshit dhe krijimi i Parku përreth Liqenit
• Tipi i Projektit	Infrastrukturë/ Zhvillim urban/ Mjedis
• Vendndodhja e projektit	Liqeni i Belshit në qytetin e Belshit
• Buxheti total i projektit	96,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 0% Donacione të tjera të mundshme: FZHR: - Granti konkurrues për infrastrukturën vendore; dhe Granti konkurrues për pyllëzimin.

• Përshkrimi i projektit

Bashkia e Belshit njihet për prezencën e 84 liqeneve karstike, të cilat janë të shpërndara nëpër territor. Këto liqene shihen qoftë si potenciale turistike, po ashtu edhe si burime të rëndësishme ujore për zhvillimin e bujqësisë. Por ndonëse kanë këto karakteristika, shumica prej tyre rrezikohen nga ndotjet e vazhdueshme që vijnë nga zonat e banuara dhe mbetjet e bujqësisë. Një ndër liqenet më të ndotura është dhe ai i Belshit që ndodhet në qendër të qytetit të Belshit. Edhe pse ky liqen konsiderohet si një potencial i rëndësishëm, momentalisht është në nivele të larta të ndotjes dhe nuk përdoret si nga qytetarët për arsye rekreacioni.

Në fazën e parë të tij, projekti konsiston në rehabilitimin e liqenit të Belshit, duke e pas-truar atë nga të gjithë ndotësit, për ta kthyer në gjendje normale. Do të bëhet evidentimi i ndotësve dhe do të meren masa për ndalimin e ndotjeve, duke i atakuar ato që në burim (kontrolli i mbetjeve të ngurta urbane, mos-derdhja e ujërave të zeza në liqen, kontrollimi i mbetjeve bujqësore dhe largimi i tyre nga liqeni). Gjithashtu, do të meren masa që të bëhet rehabilitimi natyror i habitat të liqenit, duke përdorur vegjetacionin dhe praktika të qëndrueshme natyrore për pastrimin e tij.

Me pastrimin e liqenit, do të kalohet në fazën e dytë të projektit që konsiston në krijimin e shëtitorës dhe parkut të liqenit të Belshit. Shëtitorja sëbashku me parkun do të rrethojnë liqenin, duke krijuar një hapësirë kualitative rekreacionale për banorët e qytetit. Kjo hapësirë do të sigurojë në të njëjtën kohë një fashë mbrojtëse përreth liqenit, për të ndaluar ndotjet e mundshme. Parku do të pajiset me stola, kosha për hedhjen e mbetjeve dhe elemente ndriçimi. Mbjellja me pemë dhe shtimi i vegjetacionit do të ndikojnë edhe në cilësinë e ajrit të qytetit dhe klimën lokale.

Krijimi i kësaj hapësire adreson aktivitetet social-kulturore dhe rekreacionale të banorëve të qytetit të Belshit, me fokus të veçantë të rinjtë, fëmijët, të moshuarit dhe sidomos gratë dhe nënat me fëmijë. Duke krijuar hapësira kualitative, të pastra dhe mbi të gjitha të sig-urta, do të rritet më tej edhe prezenca dhe përfshirja e këtyre grupeve në jetën sociale dhe aktivitetet e ndryshme në qytet.

	<p>Ky projekt mund të kontribuojë në krijimin e një landmark-u, jo vetëm për qytetin e Belshit, por për të gjithë Bashkinë e Belshit. Gjithashtu ai mund të shërbejë si një praktikë e parë, nën shembullin e së cilës mund të zhvillohen projekte të tjera pasuese në hapësira të tjera të ngjashme në Bashkinë e Belshit.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi dhe objektivat 	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësim i imazhit të qytetit të Belshit; - Rehabilitimi mjedisor dhe pastrimi i liqenit të Belshit; - Shtimi i hapësirave natyrore dhe rekreacionale; - Krijimi i hapësirave kualitative urbane; - Mundësi për integrim më të madh të banorëve në jetën sociale dhe aktivitetet e ndryshme në ambiente të hapura.
<ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e pritshme 	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësim i imazhit të qytetit; - Përmirësim i performancës mjedisore; - Reduktim i reziqeve të sëmundjeve si rrjedhojë e ndotjes së liqenit; - Më shumë hapësira kualitative për aktivitete rekreacionale për banorët; - Më tepër mundësi për gjithëpërfshirjen e grupeve të ndryshme (të rinjtë, fëmijët, gratë dhe nënat, të moshuarit etj.) në jetën so-ciale dhe aktivitetet e ndryshme; - Edukim i brezave të rinj për të mbrojtur natyrën dhe bashkëjetuar me të.
<ul style="list-style-type: none"> • Rendi prioritar 	<p>9 / 10</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Qëndrueshmëria e projektit 	<p>Projekti synon të ndryshojë imazhin e qytetit të Belshit, duke i dhënë atij një mundësi për të rigjeneruar hapësirën natyrore. Përtej këtij aspekti ai do të ndikojë dhe në rritjen e cilësisë dhe performancës mjedisore, duke qenë se synohet të bëhet rehabilitimi i liqenit dhe zonës përreth, duke përdorur teknika ambientale dhe miqësore ndaj mjedisit (rigjenerimi përmes shtimit të vegjetacionit dhe bimësisë që pastron habitatin nat-yror).</p> <p>Gjithashtu projekti synon krijimin e hapësirave rekreacionale dhe të sig-urta për qytetarët, duke mundësuar gjithëpërfshirjen e tyre në jetën so-ciale dhe aktivitetet e ndryshme.</p> <p>Në terma afatgjatë projekti synon të demonstrojë një praktikë të qëndrueshme për rigjenerimin natyror dhe rritjen e kualitetit të zonës, duke e kthyer këtë rast në një shembull nga i cili mund të mësojnë edhe raste të tjera të ngjashme në territorin e Bashkisë së Belshit.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e projektit 	<ul style="list-style-type: none"> - Së pari duhet të evidentohen të gjithë ndotësit e zonës; - Të atakohen burimet e ndotjeve kryesore (ndotje të ngurta, ndotje të kanalizimeve të ujërave të zeza, ndotje nga bujqësia etj.); - Të realizohet rigjenerimi dhe patrimi i habitatit natyror të liqenit me anë të vegjetacionit dhe teknikave miqësore ndaj mjedisit; - Krijimi i parkut përreth liqenit të Belshit (shtimi i vegjetacionit, stolave, koshave për mbetjet, elementëve të ndriçimit); - Krijimi i shëtitorës që lidh qendrën e qytetit me liqenin dhe parkun përreth liqenit.

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	<p>Projekti ka nevojë për një VNM. Gjithësesi ai ka karakter rehabilitues dhe përmirësues ndaj mjedisit. Disa ndër masat përfshijnë edhe ndalimin e derdhjes së ujërave të zeza dhe mbetjeve në liqen. Synohet rehabilitimi natyror i habitati të liqenit dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, duke shtuar vegjetacionin dhe duke marrë masa parandaluese ndaj ndotjeve.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim. 	<p>Bashkia ka një projekt paraprak për rehabilitimin dhe pastrimin e liqenit, i cili ka nevojë për t'u rishikuar dhe pasuruar më tej me detaje. Gjithashtu duhet të përgatitet projekti i detajuar për krijimin e parkut të liqenit dhe shëtitores.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	<p>Ky projekt është pjesë e programit elektoral të kryetarit të Bashkisë.</p>

PROJEKT 20	
• Titulli i projektit	Studim mbi ndotjen e liqeneve të Belshit
• Tipi i Projektit	Mjedis
• Vendndodhja e projektit	Bashkia Belsh
• Buxheti total i projektit	1,000,000 Lekë
• Kontributi në rastin e bashkëncimit nga Qeveria Vendore	Kontributi nga Qeveria Vendore: 20% Donacione të tjera të mundshme
• Përshkrimi i projektit	<p>Bashkia e Belshit është e njohur për prezencën e 84 liqeneve karstike, të cilat përbëjnë një burim të rëndësishëm ekonomik për zonën, qoftë në përdorimin e tyre për peshkim, ashtu edhe për sa i përket rëndësisë që kanë në zhvillimin e bujqësisë dhe rezervave ujore që ato ofrojnë. Liqe-net përbëjnë gjithashtu një potencial të madh edhe për sa i përket zhvillimit të turizmit dhe aktiviteteve rekreative, edhe pse momentalisht ky potencial nuk është shfrytëzuar plotësisht.</p> <p>Një ndër problematikat kryesore që prek liqenet e Belshit është ndotja që i është bërë, dhe këtu përmendim si mbetjet urbane, ujërat e zeza dhe mbetjet bujqësore, të cilat derdhen të tëra në liqen. Për këtë arsye është e nevojshme të bëhet një studim i thelluar mbi ndotjen e liqeneve, faktorëve ndotës, masat parandaluese të ndotjeve dhe teknikat e rigjenerimit të liqeneve të ndotur. Masat do të kenë një fokus drejt zgjidhjeve me kosto të ulët, duke përdorur ndërhyrje natyrore dhe miqësore ndaj habitateve.</p>
• Qëllimi dhe objektivat	<ul style="list-style-type: none"> - Kryerja e studimit mbi ndotësit e liqeneve të Bashkisë së Belshit; - Marja e masave mbi parandalimin e këtyre ndotësve; - Marja e masave për rigjenerimin e zonave të ndotura; - Sensibilizim për uljen e ndotjeve.
• Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim i nivelit të ndotjeve; - Gjetjen e masave mjedisore dhe inxhinierike për rehabilitimin e liqeneve të ndotura; - Sensibilizimin e qytetarëve për të mirëmbajtur asetet natyrore; - Përmirësim të performancës natyrore të liqeneve dhe habitate-ve të tyre përkatëse; - Mundësi më të mëdha për përfshirjen e liqeneve në programe të veçanta, dedikuar zhvillimit të turizmit.
• Rendi prioritar	9 / 10
• Qëndrueshmëria e projektit	Projekti është i qëndrueshëm pasi synon që rezultatet e tij të përkthehen në projekte dhe masa konkrete, të cilat do të merren nga Bashkia për re-habilitimin dhe pastrimin e liqeneve. Në terma afatgjatë projekti synon të sensibilizojë qytetarët për pasojat e aktiviteteve të tyre, dhe rëndësinë e mirëmbajtjes së aseteve natyrore.
• Aktivitetet e projektit	Kohëzgjatja e projektit varion nga 6-8 muaj, dhe disa nga aktivitetet përfshijnë:

	<ul style="list-style-type: none"> - Marrjen e kampionëve të ujit nga liqenet; - Kryerjen e analizave; - Identifikimin e burimeve të ndotjeve; - Rekomandime dhe masa për rehabilitimin e liqeneve dhe habitateve të tyre.
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 	<p>Projekti në thelb është një studim i mjedisit, kështu që edhe ndikimi i tij do të jetë pozitiv, gjithëpërfshirës, komplementar dhe kontribues në një sërë masash, projektesh dhe iniciativash të tjera që Bashkia do të ndër-marrë në kuadër të Planit Operacional për Zhvillimin Lokal, dhe më tej me hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim. 	<p>Projekti është në fazë koncepti. Për realizimin e tij duhet të hartohen termat e referencës, të lidhen marrëveshje me universitete, qendra kërkimore, apo laboratore për kryerjen e studimit.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar 	N/A



ANIMIME

(ILUSTRIME MBI PROJEKT FISHAT / PARA-PAS NDËRHYRJEVE)

FISHA 6: KRIJIMI I THERTORES, BELSH



FISHA 6: KRIJIMI I THERTORES, BELSH



FISHA 17: QËNDRA RINORE DËSHIRAN



FISHA 17: QËNDRA RINORE DËSHIRAN



FISHA 13: PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË SHKOLLAVE TË MESME







ANEKSI 2

(GRAFIKË DHE HARTA PLOTËSUESE)

FIGURA 6: INSTITUCIONET ARSIMORE - HARTA E SHPËRNDARJES DHE MBULIMIT ME SHËRBIM (9-VJEÇARE)




FIGURA 6: INSTITUCIONET ARSIMORE - HARTA E SHPËRNDARJES DHE MBULIMIT ME SHËRBIM (SHKOLLAT E MESME)




FIGURA 7: INSTITUCIONET SHËNDETËSORE - HARTA E SHPËRNDARJES DHE MBULIMIT ME SHËRBIM




FIGURA 8: HARTA E FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM




FIGURA 9: HARTA E KANALIZIMEVE TË UJËRAVE TË ZEZA




FIGURA 10: HARTA E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE





FIGURA 11: HARTA E INFRASTRUKTURËS KRYESORE RRUGORE



LEGJENDA

- RRUGË E ASFALTUAR / CILËSI E MIRË
- RRUGË E ASFALTUAR / CILËSI JO E MIRË
- RRUGË E PASHTRUAR

REF. ALBINFO (2009)

FIGURA 13: SKEMA E FUNKSIONIMIT TË CLUSTER-IT TË BUJQËSISË





FIGURA 14: SKEMA PËR KRIJIMIN E FONDIT TË TURIZMIT



PEMA E PROBLEMATIKAVE:

